

KOMISIONI EUROPIAN

Bruksel, më 10.10.2012
SWD (2012) 334

DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT

PROGRES RAPORTI 2012 PËR SHQIPËRINË

që shoqëron

**KOMUNIKATËN E KOMISIONIT PËR PARLAMENTIN EUROPIAN
DHE KËSHILLIN**

Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore për periudhën 2012-2013

{COM(2012) 600}

PASQYRA E LËNDËS

1.	HYRJE.....	5
1.1.	Parathënie.....	5
1.2.	Konteksti.....	5
1.3.	Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë.....	6
2.	KRITERI POLITIK.....	7
2.1.	Demokracia dhe shteti i së drejtës.....	7
2.2.	Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve.....	17
2.3.	Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare.....	24
3.	KRITERI EKONOMIK.....	25
3.1.	Ekzistenca e ekonomisë së tregut funksionale.....	26
3.2.	Aftësia për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së.....	30
4.	AFTËSIA PER TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT.....	33
4.1.	Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave.....	33
4.2.	Kapitulli 2: Liria e lëvizjes e punëtorëve.....	34
4.3.	Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime.....	35
4.4.	Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit.....	35
4.5.	Kapitulli 5: Prokurimi publik.....	36
4.6.	Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare.....	37
4.7.	Kapitulli 7: Legjislacioni për pronësinë intelektuale.....	37
4.8.	Kapitulli 8: Politika e konkurrencës.....	38
4.9.	Kapitulli 9: Shërbimet financiare.....	Error! Bookmark not defined.
4.10.	Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe media.....	41
4.11.	Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural.....	42
4.12.	Kapitulli 12: Politika e sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare.....	43
4.13.	Kapitulli 13: Peshkimi.....	Error! Bookmark not defined.
4.14.	Kapitulli 14: Politikat e transportit.....	Error! Bookmark not defined.
4.15.	Kapitulli 15: Energjia.....	Error! Bookmark not defined.

__4.16. Kapitulli 16: Tatimet	Error! Bookmark not defined.
__4.17. Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare	48
__4.18. Kapitulli 18: Statistikat	Error! Bookmark not defined.
__4.19. Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi.....	50
__4.20. Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale.....	52
__4.21. Kapitulli 21 : Rrjetet trans-europiane	52
__4.22. Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore	53
__4.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore (shih edhe kriterin politik).....	54
__4.24. Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria.....	58
__4.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi	60
__4.26. Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura	61
__4.27. Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimet klimatike	61
__4.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit.....	63
__4.29. Kapitulli 29: Bashkimi doganor.....	64
__4.30. Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë	65
__4.31. Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes.....	66
__4.32. Kapitulli 32: Kontrolli financiar	67
__4.33. Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore	67

1. **HYRJE**

1.1. **Parathënie**

Që në mars të vitit 2002, Komisioni i ka raportuar rregullisht Këshillit dhe Parlamentit për progresin e bërë nga vendet e rajonit të Ballkanit perëndimor. Ky është raporti i dytë për progresin e Shqipërisë pas publikimit të Opinionit të Komisionit për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në BE, i nxjerrë në nëntor të vitit 2010.

Ky raport, për progresin e bërë nga Shqipëria në përgatitjet për anëtarësim në BE:

- përshkruan shkurt marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së;
- analizon gjendjen në Shqipëri për sa i përket kriterit politik për anëtarësim;
- analizon gjendjen në Shqipëri mbi bazën e kriterit ekonomik për anëtarësim;
- shqyrton zhvillimet për sa i përket aftësisë së Shqipërisë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, domethënë *acquis* e shprehur në traktate, legjislacionin dytësor dhe politikat e Bashkimit European.

Ky raport mbulon periudhën nga tetori i 2011-ës deri në shtator të 2012-ës. Progresi matet mbi bazën e vendimeve të marra, legjislacionit të miratuar dhe masave të zbatuara. Si rregull, legjislacioni apo masat që janë në fazat e përgatitjes ose që presin miratimin e parlamentit, nuk merren parasysh. Kjo përjasje garanton trajtim të barabartë në të gjitha raportet dhe mundëson vlerësim objektiv.

Raporti bazohet në informacionet e mbledhura dhe të analizuar nga Komisioni. Janë përdorur shumë burime, përfshi kontributet e qeverisë së Shqipërisë, të Shteteve Anëtare të BE-së, raportet¹ e Parlamentit European dhe informacionet e organizatave të ndryshme ndërkombëtare e joqeveritare.

Bazuar në analizën teknike që përmban ky raport, Komisioni ka përpiluar përfundime të detajuara për Shqipërinë në komunikatën e zgjerimit².

1.2. **Konteksti**

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë u nënshkrua në qershor 2006 dhe hyri në fuqi në prill 2009.

Më 28 prill 2009, Shqipëria dorëzoi aplikimin për anëtarësim në BE. Me kërkesë të Këshillit, Komisioni dorëzoi Opinionin për aplikimin e Shqipërisë në nëntor të vitit 2010. Në dhjetor të 2010-ës, Këshilli miratoi rekomandimet e Opinionit të Komisionit. Në përfundimet e tij, Këshilli vëren se hapja e negociatave të anëtarësimit do të shqyrtohet nga Këshilli European, sipas praktikës së vendosur, pasi Komisioni të vlerësojë se Shqipëria ka realizuar kriteret e anëtarësimit në masën e duhur dhe se ka plotësuar prioritetet³ kyçe që parashtron Opinionin i Komisionit. Progresraporti i 2012-ës i Komisionit, ashtu si i vitit 2011, përqendrohet në zbatimin e këtyre prioriteteve kyçe.

¹ Raportues për Shqipërinë është z. Nikolaos Chountis.

² Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore për periudhën 2012-2013. (COM (2012) 600).

³ Prioritetet kyç përfshijnë këto fusha: funksionimi i duhur i parlamentit; miratimi i ligjeve me shumicë të cilësuar; procedurat e emërimit dhe emërimit në institucione kyçe; reforma zgjedhore; mbajtja e zgjedhjeve; reforma në administratën publike, shteti i së drejtës dhe reforma në drejtësi; lufta kundër korrupsionit; lufta kundër krimit të organizuar adresimi i çështjeve të pronësisë; forcimi i të drejtave të njeriut dhe zbatimi i politika anti-diskriminim; përmirësimi i trajtimit të të ndaluarve dhe zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Për tekstin e plotë të prioriteteve kyçe, mund të shihni Vendimin (2010)680.

1.3. Marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë

Shqipëria merr pjesë në **Procesin e Stabilizim-Asociimit**.

Në tërësi, Shqipëria i ka zbatuar mirë detyrimet e saj në kuadrin e **Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA)**. Shqipëria mori pjesë në dialogun periodik politik dhe ekonomik me BE-në përmes strukturave të MSA-së dhe kontribuoi në funksionimin normal të strukturave të përbashkëta. Mbledhjet e Komitetit dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit u mbajtën përkatësisht në mars dhe maj të vitit 2012. Gjatë periudhës së raportimit u zhvilluan mbledhjet e gjashtë nënkomiteteve. Për më tepër, Këshilli SA pranoi të ngrejë një grup të posaçëm për Reformën e Administratës Publike në kuadrin e strukturave të MSA-së. Dialogu ekonomik shumëpalësh ndërmjet Komisionit, Shteteve Anëtare të BE-së dhe vendeve candidate potenciale, në kontekstin e mbikëqyrjes fiskale të para-anëtarësimit, u zhvillua në një takim ekspertësh në maj të vitit 2012.

Liberalizimi i vizave për qytetarët shqiptarë që udhëtojnë në zonën Shengen është në fuqi që në 15 dhjetor 2010. Liberalizimi vlen për zotëruesit e personave biometrike që udhëtojnë në zonën Schengen. Komisioni krijoi një mekanizëm monitorimi pas liberalizimit të vizave për të vlerësuar nëse zbatimi i reformave të Shqipërisë është konsistent me udhërrëfyesin dhe i qëndrueshëm. Kjo masë u plotësua me një mekanizëm alarmi për të parandaluar abuzimet. Në dhjetor të 2011-ës, Komisioni i paraqiti raportin e dytë monitorues Parlamentit Europian dhe Këshillit, ndërsa raportin e tretë e miratoi në gusht të vitit 2012. **Marrëveshja e ripranimit** ndërmjet Bashkimit Europian dhe Shqipërisë është në fuqi që në vitin 2006.

Asistenca financiare e para-anëtarësimit i jepet Shqipërisë përmes Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA). Në kuadrin e Komponentit I të IPA-s, Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional, BE-ja i ka akorduar Shqipërisë gjithsej rreth 530 milion euro për periudhën 2007-2013. Buxheti vjetor i Programit Kombëtar në kuadrin e këtij komponenti ofron 82 milion euro për 2011-ën dhe 86.9 milion për 2012-ën. Dokumenti i Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar (MIPD) për periudhën 2011-2013 parashikon një përfaqje sektoriale me fokus te Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme, Reforma e Administratës Publike, Transporti, Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike, Zhvillimi Social, Bujqësia dhe Zhvillimi Rural. Asistenca IPA në kuadrin e këtij komponenti zbatohet nën mbikëqyrjen e Delegacionit të BE-së në Tiranë.

Në kuadrin e komponentit II të IPA-s, Bashkëpunimi Ndërkufitar, Shqipëria merr pjesë në menaxhimin dhe zbatimin e tre programeve në hapësirën e Ballkanit Perëndimor (me Malin e Zi, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovën⁴), në një program dypalësh bashkëpunimi ndërkufitar me një Shtet Anëtar të BE-së (Greqinë), në tre programe shumëpalëshe (përfshi Shtete Anëtare të BE-së), d.m.th. në programet transkombëtare europiane ERDF që quhen “Europa Juglindore” dhe “MED”, si edhe në programin rajonal Adriatik.

Shoqëria civile ka marrë mbështetje financiare nga BE-ja në kuadrin e Instrumentit të Shoqërisë Civile IPA për periudhën (2011-2012) dhe përmes Instrumentit Europian për Demokraci dhe Të drejtat e Njeriut. IPA iu dha mbështetja organizatave të shoqërisë civile në këto fusha: drejtësia (aksesi në drejtësi, lufta kundër korrupsionit dhe monitorimi/përmirësimi i kushteve të punës në sistemin e vuajtjes së dënimit), mbrojtja e grupeve të cënueshme (gratë pa përkrahje, fëmijët dhe të moshuarit, si dhe grupet minoritare) si dhe mbrojtja e mjedisit. Ndër objektivat e kësaj asistence është përfshirja më e gjerë e shoqërisë civile në vendimmarrje, forcimi i menaxhimit dhe kapaciteteve organizative të organizatave të shoqërisë civile si edhe përmirësimi i kuadrit të tyre ligjor dhe fiskal.

⁴ pa paragjykuar qëndrimet e shteteve mbi statusin dhe në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së si dhe me Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

BE-ja ka bashkëfinancuar pjesëmarrjen e Shqipërisë në këto programe të BE-së: “Programi i Shtatë Kuadër (FP7) për Kërkimin Shkencor”, “Programi për Sipërmarrjen dhe Novacionin” (EIP) i “Programit Kuadër për Konkurrueshmërinë dhe Novacionin”, “Europa në Veprim”, “Europa për Qytetarët” dhe “Kultura”.

2. KRITERI POLITIK

Kjo pjesë shqyrton përparimin që ka bërë Shqipëria në përmbushjen e kriterit politik të Kopenhagen-it që kërkon stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut si dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve. Gjithashtu, këtu vlerësohet përparimi në adresimin e 12 prioriteteve kyçe të evidentuara në Opinionin e Komisionit Europian për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian. Në këtë kontekst, në mars të vitit 2012, Shqipëria miratoi Planin e Veprimit për plotësimin e rekomandimeve të Opinionit.

Në këtë pjesë gjithashtu monitorohet zbatimimi i detyrimeve ndërkombëtare, bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e zgjerimit dhe me Shtetet Anëtare.

Kjo pjesë analizon kryesisht përmbushjen e prioriteteve kyçe të Opinionit të vitit 2010.

2.1. Demokracia dhe shteti i së drejtës

Shumica qeverisëse dhe opozita arritën një marrëveshje politike në nëntor të 2011-ës, e cila shënoi fundin e ngërçit politik që lindi nga zgjedhjet parlamentare të 2009-ës. Në këtë marrëveshje u miratua një plan dhe një kalendar për realizimin e reformës zgjedhore, për përmirësimin e Rregullores së Kuvendit dhe për miratimin e ligjeve pezull që kërkonin shumicë të cilësuar.

Shumica qeverisëse dhe opozita ruajtën përgjithësisht angazhimin ndaj reformave politike kryesore që burojnë nga kjo marrëveshje politike, dhe dialogu politik është përmirësuar në masë të konsiderueshme që atëherë. Procesi i punës për zbatimin e 12 prioriteteve kyçe ka qenë përfshirës në përgjithësi. Sidoqoftë, ka pasur periudha të shkurtra retorike konfrontuese ndërmjet qeverisë, opozitës dhe institucioneve të tjera shtetërore, kryesisht në lidhje me hetimin e ngjarjeve të 21 janarit 2011 dhe emërimin nga Parlamenti të një anëtari të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Që në nëntor të 2011-ës është bërë përparim i konsiderueshëm me miratimin e ligjeve pezull me shumicë të cilësuar, emërimin e Avokatit të Popullit, miratimin e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor dhe me rishikimin e Rregullores së Kuvendit. Kjo krijoi një klimë bashkëpunimi ndërpartiak, që mundësoi përparimin e reformave edhe në fusha të tjera të kriterit politik.

Zgjedhja e presidentit në qershor të 2012-ës² u zhvillua në përputhje me Kushtetutën, por procesi politik që shoqëroi nuk konsolidoi dialogun pozitiv ndërpartiak të promovuar në nëntor. Sidoqoftë, dialogu konstruktiv rifilloi pak kohë më vonë, siç u demonstrua kryesisht me finalizimin e reformës zgjedhore, një element kyç ky i marrëveshjes politike të nëntorit.

Parlamenti

Pas nëntorit të 2011-ës, në vijim të marrëveshjes politike, pati një përmirësim të ndjeshëm të dialogut dhe retorikës në Parlament, si dhe u krijua një atmosferë konstruktive, sidomos gjatë mbledhjeve të komisioneve dhe atyre plenare. Kjo mundësoi përparimin në një sërë fushash.

U miratuan të gjithë ligjet pezull që kërkonin shumicën e cilësuar prej 3/5, përfshi sidomos ndryshimet në Kodin Penal dhe Kodin Civil, si edhe ligjin “Për gjykatat administrative” që qëndronte pezull prej një kohe të gjatë. Avokati i Popullit u emërua në vijim të një procesi përzgjedhjeje transparent dhe bazuar në meritë, me dëgjesa publike, i pasuar nga votimi konsensual në Parlament.

Për kandidatin presidencial për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, u realizua procesi i dëgjimit dhe i votimit në Parlament. Këto janë prioritete kyçe të Opinionit.

Grupi i punës për përmirësimin e Rregullores së Kuvendit i ngritur në nëntor të 2011-ës, arriti konsensus mbi një numër të madh projektndryshimesh të rregullores (përfshi dy ndryshime për rolin e Komisionit për Integrimin European) dhe përgatiti ndryshimet e ligjit “Për statusin e deputetit”. Ndryshimet e rregullores presin të miratohen nga Kuvendi. Grupi i punës nuk ra dakord mbi dy çështje të ngritura nga opozita, e cila kërkoi konkretisht rifutjen e votimit të fshehtë për dekretet presidenciale si dhe kohë të barabartë për deputetët e opozitës kur marrin fjalën për t’iu kundërpërgjigjur Kryeministrit.

Përparim është bërë në funksionimin e procedurave parlamentare (prioritet kyç i Opinionit), me miratimin e një numri të konsiderueshëm aktesh, përfshi ligje, vendime, rezoluta dhe deklarata. Një numër i madh i tyre është miratuar me konsensus. Përparim është vërejtur edhe në përmirësimin e konsultimit publik gjatë procesit legjislativ. Gjatë mandatit të kryetarit të ri, Komisioni për Integrimin European është përfshirë në mënyrë aktive me Ministrinë e Integritimit për hartimin dhe monitorimin e pjesëve relevante të Planit të Veprimit për Plotësimin e Rekomandimeve të Opinionit. Komisioni për Integrimin European përfshi shoqërinë civile kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rishikimin e Planit të Veprimit. Kryetari i këtij Komisioni mori pjesë në takimin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit të zhvilluar në maj të 2012-ës, dhe për herë të dytë u bë e mundur të dilej me një deklaratë të përbashkët të Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit në korrik, për të cilën ishin dakord të dy partitë.

Megjithatë, duhet të vazhdojë puna për të përmirësuar funksionimin e parlamentit. Kalendari i punës i Parlamentit jo gjithmonë u jep komisioneve të përhershme kohën e mjaftueshme për shqyrtimin e projektligjeve dhe për dëgjiesat publike, gjë që sjell shpesh miratimin e nxituar potencialisht në dëm të cilësisë. Projektligjet shpesh nuk janë të arritshme nga publiku. Duke u bazuar në përvojën me miratimin e ligjeve pezull me shumicë të cilësuar, Parlamenti duhet të krijojë një qasje dhe metodologji efektive të shënjestruar për përgatitjen dhe negociimin e këtyre ligjeve. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për forcimin e funksionit mbikëqyrës të Parlamentit, përfshi përdorimin më të mirë të interpelancave me anëtarët e qeverisë dhe pyetje-përgjigjeve me shkrim. Duhet punuar për analizimin dhe modifikimin e kuadrit ligjor në funksion të forcimit të nevojshëm të rolit të Komisionit për Integrimin European. Në këtë kontekst, duhet të përmirësohen marrëdhëniet ndërmjet këtij Komisioni dhe komisioneve të tjera parlamentare.

Disa përparime janë bërë në forcimin e kapaciteteve administrative të Sekretariatit të Parlamentit, përmes trajnimit të stafit dhe ekspertizës, përfshi ekspertë ndërkombëtarë. Në maj të 2012-ës u miratua Strategjia shumëvjeçare e Trajnimit për stafin e Parlamentit. Njësia e Përafrimit të Legjislacionit në Parlament është forcuar me punësimin e një këshilltari shtesë. Janë bërë përpjekje për rritjen e transparencës në funksionimin e administratës së Parlamentit. Kjo vlen sidomos për aspektet buxhetore, përmes publikimit, në faqen e internetit të Parlamentit, të relacioneve të shpenzimeve për 6-mujorin e parë të 2012-ës. Megjithatë, kapacitetet administrative të Parlamentit kanë nevojë për forcim substancial, sidomos për sa i përket agjendës së integritimit european.

Në korrik të 2012-ës, Parlamenti zhvilloi një seancë dëgjimore dhe miratoi kandidatin e presidentit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë (prioritet kyç i Opinionit), që kishte mbetur vakant. Gjatë periudhës raportuese, nuk ka pasur procese të dëgjimit dhe votimit në Parlament për kandidatët e presidentit për emërimet në Gjykatën e Lartë

Më 11 qershor të 2012-ës, Parlamenti zgjodhi z. Bujar Nishani President të Republikës në raundin e katërt të zgjedhjeve, me 73 vota pro nga 76. Deputetët e opozitës morën pjesë në seancë, por nuk votuan. Zgjedhja e presidentit ishte në përputhje me Kushtetutën, por nuk u përmbush pritshmëria për një kandidat konsensual. Në tre raundet e para ku kërkohesh shumicë e cilësuar me 3/5 nuk u prezantua asnjë kandidat zyrtar, pasi konsultimet mes shumicës në pushtet dhe opozitës nuk arritën të gjejnë një kandidat të përbashkët me mbështetje të gjerë.

Në lidhje me reformën zgjedhore, prioritet kyç i Opinionit, përfaqësuesit e qeverisë dhe të opozitës në Komitetin e Posaçëm Parlamentar të ngritur në nëntor të 2011-ës, punuan në një frymë të përgjithshme bashkëpunimi konstruktiv. Komisioni arriti rezultate të mira dhe konsensus për ndryshimet në kuadrin zgjedhor legjislativ, të cilat adresonin shumicën e rekomandimeve të misioneve vëzhguese të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e 2009-ës dhe 2011-ës. Këto ndryshime përfshijnë dispozita për regjistrimin e subjekteve, zgjedhore, kuotat gjinore, financimin e fushatave zgjedhore dhe mekanizmat e ankimit dhe apelimit. U rishikua edhe përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe sistemi i emërimit të anëtarëve, me qëllim rritjen e pavarësisë dhe paanshmërisë së KQZ-së. Më 19 korrik, Parlamenti miratoi me konsensus Kodin Zgjedhur të ndryshuar.

Në tërësi, funksionimi i Parlamentit dhe dialogu politik janë përmirësuar në masë të konsiderueshme, si rezultat i marrëveshjes politike të nëntorit të 2011-ës. Kjo bëri të mundur përparim të ndjeshëm, si miratimi i ligjeve pezull që kërkonin shumicë të cilësuar, emërimin e Avokatit të Popullit, mbajtjen e dëgjesës dhe procesit të votimit për kandidatin e presidentit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, si dhe miratimin e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor. Tashmë, thelbësore është miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit.

Presidenti i ri u zgjodh, më 11 qershor 2012, në raundin e katërt, vetëm me votat e shumicës. Edhe pse në përputhje me Kushtetutën, zgjedhja e presidentit nuk arriti të përmbushte pritshmërinë për gjithëpërfshirje, si dhe tendosi konsolidimin e dialogut dhe bashkëpunimit politik. Kjo solli ngadalësimin e përkohshëm të përpjekjeve për reformat në fusha kyçe ku nevojitet konsensus politik, por pak kohë më vonë kjo situatë u tejkalua.

Qeveria

Qeveria dhe koalicioni qeverisës i përbërë nga Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim qëndruan në pushtet dhe në pozita stabil gjatë periudhës së raportimit. Në mars dhe qershor të 2012-ës u realizua një ristrukturim i kabinetit qeverisës.

Ministria e Integritimit, në bashkëpunim me Komisionin për Integrimin Europian, lajti rol kyç në rishikimin e Planit të Veprimit për Plotësimin e Rekomandimeve të Opinionit. Procesi i rishikimit ishte transparent dhe pjesëmarrës, duke përfshirë konsultimet me aktorët joqeveritarë. Plani i Veprimit është përmirësuar, duke qartësuar përmbajtjen e masave dhe duke specifikuar rezultatet konkrete. Mekanizmi i monitorimit të përmuajshëm është zbatuar rregullisht. Bashkëpunimi i mirë ndërmjet kryetarit të Komisionit për Integrimin Europian dhe Ministrin të Integritimit në lidhje me sfidat e integritit europian të Shqipërisë vazhdoi edhe përtej punës për Planin e Veprimit, siç ishte pjesëmarrja e përbashkët në takimin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit të zhvilluar në maj të 2012-ës.

Është bërë përparim me përditësimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA). PKZMSA-ja e përditësuar u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave në korrik të 2012-ës, vendim i cili ndër të tjera specifikon përgjegjësitë për zbatimin si edhe kriteret e monitorimit dhe raportimit. Vendimi ngarkon institucionet e linjës që të vendosin bashkërisht për shpërndarjen e përgjegjësiave institucionale, në lidhje me transpozimin dhe zbatimin e akteve normative të së drejtës së BE-së, brenda tre muajsh nga hyrja në fuqi e vendimit. Me zbatimin e tij, kjo shpërndarje do të jetë një hap i rëndësishëm përpara për të siguruar rishikim tërësor dhe planifikim më realist të PKZMSA-së.

Janë bërë disa përparime në koordinimin e proceseve për përafrimin e legjislacionit me *acquis*. Ministria e Integritimit vazhdoi punën për analizën e mangësive legjislative. Është instaluar një sistem TI për përafrimin ligjor (IMS), si pjesë e “e-cabinet” që është sistemi i përgjithshëm TI i qeverisë. Sistemi përmban informacion për masat e përafrimit ligjor me *acquis*. Futja e IMS-së rrit transparencën dhe efijencën e sistemit për planifikimin dhe monitorimin e procesit të përafrimit, megjithëse faktori kohë dhe cilësia e mekanizmave përkatës kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm.

Politikëbërja dhe hartimi i legjislacionit nga ministritë e linjës vazhdojnë të kenë mangësi për sa i përket punës analitike paraprake; gjithashtu, nuk ka transparencë apo konsultime të mjaftueshme me grupet e interesit. Lëvizjet e stafit dhe dobësitë e kapaciteteve analitike kanë pasur ndikim në cilësinë e legjislacionit të hartuar. Më shumë vëmendje i duhet kushtuar përgatitjes dhe zbatimit të legjislacionit.

Ka pasur vetëm përparim të moderuar për sa i përket procesit të koordinimit të integritimit europian. Nevojitet zhvillimi i kapaciteteve tërësore dhe të qëndrueshme të 35 grupeve ndër-institucionale të punës, si edhe përmirësim i mëtejshëm i koordinimit të politikave ndërmjet institucioneve.

Në lidhje me qeverisjen vendore, nuk është bërë përparim në reformën administrative territoriale. Njësitë e vogla të pushtetit vendor janë shpesh ekonomikisht të paqëndrueshme. Ligji “Për planifikimin e territorit” u miratua në 2009-ën, por zbatimi është i ngadaltë.

Nuk ka pasur përmirësim në mbledhjen e të ardhurave nga pushteti vendor gjatë 2011-ës. Nevojiten përpjekje substanciale për të forcuar si efijencën administrative, edhe qëndrueshmërinë financiare të bashkive. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar fushave si planifikimi strategjik, menaxhimi i burimeve njerëzore dhe kontrolli financiar. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të garantuar transparencë dhe një qasje strategjike në financimin qendror për projektet vendore, sidomos për projektet e infrastrukturës. Vendimmarrjes së pushtetit vendor i mungon transparenca dhe konsultimet me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e tjera të interesit.

Debatet e tejzgjatuara dhe të tejpolitizuara në lidhje me përbërjen e organeve të pushtetit vendor kanë penguar në disa raste funksionimin efektiv të tyre, si edhe konsolidimin e demokracisë përfaqësuese në nivel vendor. Ekzistenca e dy shoqatave të pushtetit vendor, me anëtarë të ndarë sipas dy partive politike kryesore, ka penguar bashkëpunimin në nivel bashkiak dhe ka dobësuar pozitat e autoriteteve vendore në raport me qeverisjen qendrore. Për shkak të mosmarrëveshjeve politike mes dy shoqatave, Shqipëria nuk ka arritur të zgjedhë dhe rrjedhimisht as të përfaqësohet me një delegacion në Kongresin e Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës të zhvilluar në maj të 2011-ës.

Autoritetet vendore kanë filluar ngadalë të zbatojnë Vendimin e Këshillit të Ministrave të qershorit 2011 “Për strukturën dhe organizimin e institucioneve publike”. Mbetet e lartë përqindja e nëpunësve civilë me kontrata të përkohshme pune në autoritetet vendore.

Në tërësi, janë bërë disa përpertime në lidhje me punën e qeverisë. Këtu përfshihet përpertime i mirë në koordinimin e procesit të integritit evropian përmes rishikimit të Planit të Veprimit për plotësimin e prioriteteve kyçe të Opinionit, proces që është zhvilluar në mënyrë transparente dhe pjesëmarrëse. Ka vazhduar bashkëpunimi i mirë ndërmjet Kryetarit të Komisionit për Integritin Evropian dhe Ministrin të Integritit për sfidat e reformave të integritit evropian, përfshi pjesëmarrjen e përbashkët në takimin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit të zhvilluar në maj 2012. Kapacitetet e hartimit të legjislacionit dhe procesi i planifikimit për përafrimin ligjor me *acquis* duhet të përmirësohen më tej, kryesisht përmes zbatimit efikas të Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për PKZMSA-në”. Për sa i përket pushtetit vendor, decentralizimi i përgjegjësive shtetërore nuk është shoqëruar me transferimin e burimeve të përshtatshme administrative dhe financiare, nga niveli qendror te ai vendor.

Ekzistenca e dy shoqatave të ndara të pushtetit vendor nuk i shërben përmirësimit të marrëdhënieve institucionale ndërmjet pushtetit qendror dhe vendor, në funksion të një procesi decentralizimi të suksesshëm dhe transparent.

Administrata Publike

Janë bërë përpertime në fushën e reformës së administratës publike, që është prioritet kyç i Opinionit. Në maj, Parlamenti miratoi me shumicë të cilësuar ligjin “Për gjykatat administrative”. Ligji është hap i rëndësishëm në kuadrin e reformimit të sistemit gjyqësor, pasi garanton shqyrtim juridik të vendimeve administrative nga ana e gjykatave të pavarura, gjë që forcon transparencën dhe luftën kundër korrupsionit në shërbimin civil. Është miratuar ligji “Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike”, si një ligj integral që synon të eliminojë fragmentimet dhe mangësitë në koordinim, si edhe të krijojë një kuadër të përgjithshëm ligjor për organizimin e administratës publike. Projektligji “Për shërbimin civil” u miratua nga qeveria në gusht të 2012-ës dhe aktualisht është në procedurë parlamentare ku kërkohet shumicë e cilësuar për miratim. Projektligji “Për procedurën e përgjithshme administrative” nuk është finalizuar.

Janë bërë disa përpertime në lidhje me zbatimin e legjislacionit dhe akteve administrative. Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e strukturës dhe organizimin e institucioneve publike” e kanë zbatuar 13 nga 4 ministri. Zbatimi i ligjit “Për inspektimin” po ecën shumë ngadalë. Inspektori i Përgjithshëm u emërua vetëm në fund të vitit 2011. Aktet nëligjore të nevojshme për zbatim ende nuk janë miratuar. Urdhri i Kryeministrit “Për vendosjen e kufirit maksimal prej 2.5% të kontratave të përkohshme”, është zbatuar në masë të konsiderueshme. Në mjaft raste, institucionet e pushtetit qendror nuk kanë kërkuar miratimin e Departamentit të Administratës Publike (DAP) për rekrutimin me kontrata të përkohshme, ose e kanë shpërfillur refuzimin e DAP-it.

Ende DAP-it i mungon autoriteti për të luajtur rol efektiv në monitorimin e institucioneve publike sipas sferës së saj të veprimit dhe për të ekzekutuar vendimet. DAP-i e ka përmirësuar grumbullimin e të dhënave. Megjithatë, vazhdon të ketë probleme me grumbullimin dhe ruajtjen e të dhënave në aspektin e besueshmërisë dhe rregullave të qarta administrative. Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (HRMIS) nuk është plotësisht funksional. Faza e parë pilot, për bërjen funksionale të modulit të pagave, është realizuar me sukses në pesë institucione deri në prill.

Instituti i Trajnimit të Administratës Publike (ITAP) ka zhvilluar trajnimet në përputhje me planin e trajnimeve për periudhën 2012-2015, pavarësisht mungesës së ambienteve dhe burimeve. Në gusht u ngrit grupi i punës për hartimin e raportit përfundimtar në lidhje me hapjen e Shkollës shqiptare të Administratës Publike.

Komisioni i Shërbimit Civil (KSHC) vazhdon të ketë vetëm katër nga pesë anëtarët e kërkuar që në shtator të 2011-ës, gjë që pengon vendimmarrjen e institucionit. Buxheti vjetor i KSHC-së është reduktuar gradualisht dhe mbështetja politike për rolin e tij ka ardhur në rënie. Pavarësisht, KSHC e intensifikoi punën dhe kreu disa inspektime në institucione publike. Norma e ekzekutimit të vendimeve të KSHC-së nga institucionet shtetërore mbetet shumë e ulët, edhe kur vendimet konfirmohen nga gjykata dhe bëhen juridikisht të detyrueshme. KSHC mbetet një organ i rëndësishëm i mbikëqyrjes së pavarur të institucioneve publike, si dhe një instrument me rëndësi thelbësore për Parlamentin që të monitorojë përdorimin e shërbimit civil nga ekzekutivi.

Shërbimi civil vazhdon të vuajë nga mangësitë që lidhen me politizimin dhe mungesën e meritokracisë në rekrutim, ngritje në detyrë dhe largim të nëpunësve civilë. Në sektorë kyçë, administrata publike përballet me sfida të mëdha në realizimin e detyrave të veta, përfshi menaxhimin dhe ndjekjen e programeve të asistencës si dhe zbatimin e legjislacionit që synon përafrimin me *acquis* të BE-së

Pak përparim është bërë në fushën e auditivit. Në dhjetor të 2011-ës u emërua Kryetari i ri i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) dhe është prezantuar plani i veprimit për forcimin e institucionit. Gjatë vitit 2011, KLSH kreu 152 audite, kryesisht mbi aspektet e ligshmërisë, rregullsisë dhe vlerësimit. Janë të qarta vështirësitë në zbatimin e strukturës së auditëve të programuara, sidomos në auditet e sistemeve. Numri i rekomandimeve të KLSH-së për autoritetet shtetërore është rritur, ndërsa numri i rekomandimeve të pazbatuar pothuaj është dyfishuar krahasuar me vitin 2011. Parlamenti miratoi raportin e KLSH-së në maj të 2012ës. Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të forcuar kapacitetet dhe performancën e KLSH-së.

Përparim është bërë me **emërimin e Avokatit të Popullit** në dhjetor, një prioritet kyç i Opinionit, që kërkonte shumicë të cilësuar në Parlament. Procesi i hapur dhe transparent u finalizua me një vendim konsensual në Parlament. Është ngritur një zyrë rajonale në Fier. Ky institucion ka nevojë për burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore, si edhe për mbështetje politike të vazhdueshme, në mënyrë që të jetë në gjendje të zbatojë plotësisht detyrat kryesore.

Në tërësi, ka pasur përparim në reformën e Administratës Publike, prioritet kyç i Opinionit, kryesisht me miratimin e ligjit “Për gjykatat administrative”, ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike”, dhe me emërimin e Avokatit të Popullit. Tashmë është thelbësore miratimi i ndryshimeve në ligjin “Për shërbimin civil”. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për zbatimin e legjislacionit të miratuar dhe të akteve administrative. Kuadri legjislativ dhe institucional i Administratës Publike vazhdon të ketë mangësi që duhen adresuar në funksion të forcimit të profesionalizmit, depolitizimit, meritokracisë, transparencës dhe llogaridhënies.

Sistemi gjyqësor (shih edhe Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore)

Përparim i moderuar është arritur në reformën në gjyqësor, që është prioritet kyç i Opinionit. Ka filluar zbatimi i Strategjisë për reformën në sistemin e drejtësisë miratuar në korrik të 2011-ës dhe i planit të veprimit të rishikuar në mars të 2012-ës. Ekzistojnë shqetësime për bashkëpunimin ndërinstucional, akordimin e fondeve buxhetore, planifikimin buxhetor dhe nivelin e burimeve njerëzore në këtë sektor. Shqipëria duhet të përshpejtojë zbatimin e strategjisë për reformën në drejtësi, me synim që të garantojë pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore.

Në Ministrinë e Drejtësisë (MD) janë ngritur disa grupe pune për të shqyrtuar legjislacionin kryesor të sektorit të drejtësisë. Miratimi i këtyre ligjeve kërkon shumicë të cilësuar në Parlament. Ligji “Për gjykatat administrative” u miratua në maj që të zbatohet vitin që vjen, ndërsa ligji “Për konferencën kombëtare gjyqësore” dhe ligji “Për

avokatinë” u miratuan përkatësisht në korrik dhe shtator. Ligji “Për gjykatat administrative” parashikon ngritjen e gjykatave administrative të shkallës së parë në nivel qendror dhe rajonal, si dhe ngritjen e një gjykate apeli dhe një seksioni të posaçëm pranë Gjykatës së Lartë. Kjo pritet të lehtësojë barrën e gjykatave të tjera dhe t’iu mundësojnë gjyqtarëve të specializuar të merren me çështjet administrative, nëse akordohen burimet e nevojshme.

Disa përparime janë bërë në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Në shtator të 2012-ës u miratuan një komplet masash që dispijlojnë transferimin e gjyqtarëve mbi bazën e meritave dhe kriterëve objektive. Reformimi i ligjit “Për gjykatën e lartë” dhe i ligjit “Për gjykatën kushtetuese” ka mbetur pezull. Procesi i emërimit të gjyqtarëve në këto gjykata mbetet një çështje shqetësuese për shkak të politizimit të mundshëm. Neutraliteti dhe pavarësisë e këtyre institucioneve ende nuk janë garantuar plotësisht.

Aktualisht po realizohet vlerësimi i gjyqtarëve në mbarë vendin. Megjithatë, sistemi i ri i harmonizuar i vlerësimit ende nuk është zbatuar plotësisht. Kjo pati ndikim në punën e Komisionit në lidhje me transferimet, ngritjet në detyrë dhe emërimet e gjyqtarëve, pasi mbetet ende për t’u demonstruar që ato janë bërë mbi bazë meritash dhe që janë objekt llogaridhënieje.

Zëvendëskryetari i ri i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) u emërua në gusht. Nisur nga rëndësia e KLD-së, struktura e saj administrative dhe organizative duhet të rishikohet urgjentisht, me qëllim që të rritet eficaenca, llogaridhënia dhe transparenca.

Shkolla e Magjistraturës po ofron programe mësimore të cilësisë së mirë, përfshi kurset e trajnimit mbi çështjet e etikës. Megjithatë, buxheti i saj mbetet i pamjaftueshëm për të përballuar aktivitetet e planifikuara.

Nevojiten përpjekje të mëtejshme që sistemi informatik i menaxhimit dhe caktimit të rastësishëm të çështjeve gjyqësore të shtrihet në të gjitha gjykatat, sidomos në Tiranë, me qëllim që të arrihet një sistem uniform dhe i harmonizuar. Ky hap do të promovonte edhe grumbullimin e statistikave të sakta. Gjykatave u mungon mbështetja TI, si edhe një qasje strategjike për zhvillimin e mëtejshëm të alternativave TI në sektorin e gjyqësorit. Sistemi i regjistrimit audio për seancat gjyqësore po instalohet gradualisht.

Publikimi i vendimeve gjyqësore ende nuk bëhet sistematikisht. Vendimet botohen me vonesa, në një mënyrë jokonsistente mes gjykatave dhe, në disa raste, nuk garanton mbrojtje të mjaftueshme të të dhënave personale. Megjithatë, në korrik hynë në fuqi disa dispozita për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale brenda sistemit gjyqësor. Përveç kësaj, në korrik u finalizua portali i ri i gjyqësorit. Përditësimi teknik i databazës elektronike të Qendrës së Dokumentacionit Gjyqësor mbetet problematik për shkak të mungesës së stafit.

Në lidhje me **llogaridhënien** në gjyqësor, janë bërë hapa për të adresuar mbivendosjen e kompetencave të inspektimit ndërmjet inspektorateve të KLD-së dhe Ministrisë së Drejtësisë, përmes zbatimit të Memorandumit të Bashkëpunimit për inspektimet; sidoqoftë, rreziku i mbivendosjes vazhdon të ekzistojë. Çështje shqetësuese mbetet hartimi i dobët i vendimeve gjyqësore, sidomos me arsyetime të pamjaftueshme.

Përparim i mirë është arritur në **luftën kundër korrupsionit në gjyqësor**, përmes miratimit të ndryshimeve kushtetuese që kufizojnë imunitetin e gjyqtarëve. Reforma mundëson hetimin dhe ndjekjen penale të gjyqtarëve pa nevojën e një autorizimi paraprak. Zbatimi i këtyre dispozitave duhet të monitorohet me kujdes dhe të pasqyrohen ndryshimet përkatëse në Kodin e Procedurës Penale. Faktorët kryesorë të korrupsionit në gjyqësor vazhdojnë të jenë: kushtet e këqija të punës, mungesa e sigurisë adekuate në gjykata dhe për gjyqtarët, pagat e

ulëta, bashkë me mungesën e kontrolleve adekuate dhe sistemit opak të emërimeve, ngritjeve në detyrë dhe transferimeve.

Është miratuar kodi i etikës për gjyqtarët, por zbatimi efektiv i tij vazhdon të jetë sfidë. Edhe pse janë kryer inspektime, janë thelbësore trajnimet e mëtejshme dhe një mekanizëm zbatimi korrekt. Në maj është finalizuar një procedurë *online* që u mundëson qytetarëve të paraqesin ankesa ndaj gjyqtarëve dhe procedimeve gjyqësore.

Përparim i kufizuar është bërë në lidhje me **efiçencën e gjyqësorit**. Edhe pse është realizuar një studim për riorganizimin territorial dhe rishpërndarjen e gjyqtarëve në gjykata, zbatimi i përfundimeve të këtij studimi po vonon. Efiçenca e gjykatave pengohet edhe nga mungesa e një regjistri civil të saktë dhe një sistemi adresash të përshtatshëm.

Mungesa e një kuadri ligjor tërësor për administratën gjyqësore në përputhje me standardet europiane, me organizim të qartë të gjykatave dhe stafit gjyqësor, e pengon transparencën dhe efiçencën e veprimtarisë së gjykatave. Seancat dëgjimore shpesh vazhdojnë të zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve dhe pak përparim është bërë në përmirësimin e kushteve të punës në gjykata. Kjo mund të sjellë efekt negativ të paanshmëria e procedimeve gjyqësore. Disa përparime janë bërë në lidhje me trajnimin e kancelarëve, oficerëve gjyqësorë dhe administratorëve gjyqësorë, si dhe është akorduar një buxhet për trajnimin e vazhdueshëm të tyre. Megjithatë, buxheti i përgjithshëm i akorduar për gjykatat dhe stafin gjyqësor duhet të shtohet për t'i bërë trajnimet të qëndrueshme.

Administrimi i gjykatave vazhdon të jetë i dobët për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare. Buxheti vjetor për gjyqësorin është rritur fare pak. Në 2012-ën ishte 69,8 milion EUR, që përbën 0.71% të PBB-së.

Burimet e kufizuara ndikojnë edhe në ngarkesën e madhe të gjykatave, përfshi Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë; të dyja këto gjykata kanë një numër të konsiderueshëm çështjesh të akumuluar. Në rastin e Gjykatës së Lartë, numri i lartë i çështjeve të akumuluar pasqyron edhe fushën shumë të gjerë të kompetencës të kësaj gjykate.

Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurës Penale duhet të ndryshohen për të rritur efiçencën e procedimeve gjyqësore. Të dy kodet janë aktualisht nën shqyrtim. Ligji i ri “Për avokatinë” forcon procedurat kundër avokatëve nëse shkelin rregullat profesionale. Nevojiten ndryshime të mëtejshme për të adresuar me efektivitet problemin e vonësive të paarsyeshme të çështjeve gjyqësore, të shkaktuara nga shtyrja e procedimeve. Kjo ndodh shpesh për shkak të mungesës së avokatëve dhe/ose prokurorëve në çështjet penale, ose nga mungesa e avokatëve dhe/ose dëshmitarëve në çështjet penale. Akumulimi i çështjeve gjyqësore dhe zvarritja e procedimeve minojnë efiçencën e sistemit gjyqësor. Dhomës së Avokatisë i mungojnë kapacitetet efektive mbikëqyrëse dhe trajnuese.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore mbetet i dobët, sidomos për çështjet ku institucionet shtetërore janë palë e paditur. Shqipëria ende nuk i ka paraqitur Këshillit të Europës të dhëna të qarta për ekzekutimin e vendimeve në lidhje me kthimin/kompensimin e pronave të shtetëzuara gjatë regjimit komunist. Nevojitet miratimi i një mekanizmi efektiv ndreqës për rastet e moszekutimit të vendimeve të formës së prerë.

Sistemi i ri përmbartimor privat është krijuar dhe për herë të parë është akorduar buxheti për Dhomën Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë.

Në lidhje me ligjin “Për ndërmjetësimin”, janë miratuar aktet normative për veprimtarinë e ndërmjetësve dhe janë lëshuar licencat e para. Megjithatë, Dhoma e Ndërmjetësve ende nuk është ngritur. Ndryshimet në ligjin “Për arbitrazhin” ende nuk janë finalizuar dhe duhet të miratohen.

Verdikti i të ashtuquajturës çështje Gërdeci (shpërthimi në 2008-ën që shkaktoi 26 viktima) u dha në mars. Pesë nga 29 të akuzuarit u dënuan me burg nga 6 në 18 vjet; pjesa tjetër morën dënime më të buta ose u shpallën të pafajshëm. Procedurat e apelimit vazhdojnë. Një ngjarje paralele ishte rrëzimi në maj nga Gjykata Kushtetuese e vendimit të Gjykatës së Lartë për tërheqjen e akuzave ndaj ish-Ministrit të Mbrojtjes në lidhje me rolin e pretenduar të tij në çështjen Gërdeci; kjo çështje tashme do të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë.

Në lidhje me vdekjen e katër demonstruesve gjatë ngjarjeve të 21 janarit të vitit 2011, procedimet penale deri tani kanë rezultuar në arrest shtëpie për një ish-komandant të Gardës Kombëtare dhe në paraburgim për një oficer të Gardës, për shkak të përfshirjes së dyshuar të tyre në hapjen e zjarrit. Një tjetër person është në arrest shtëpie, ndërsa janë tërhequr akuzat ndaj një tjetri i akuzuar për pengim të drejtësisë me prishje të provave. Hetimet për përfshirjen e dyshuar të deputetëve të opozitës në nxitjen e ngjarjeve vazhdojnë. Këto procedime duhet të ndiqen nga organi i akuzës dhe gjykatat pa ndërhyrje të paligjshme.

Në tërësi, është arritur përparim i kufizuar në adresimin e reformës gjyqësore, që është prioritet kyç i Opinionit. Strategjia e sistemit të drejtësisë dhe plani i veprimit i marsit të 2012-ës kanë nisur të zbatohen. Janë miratuar ligji “Për gjykatat administrative”, ligji “Për konferencën kombëtare gjyqësore” dhe ligji “Për avokatinë”. Sistemi i ri i përmbartimit gjyqësor privat është funksional. Megjithatë, legjislacioni i rëndësishëm që forcon më tej pavarësinë, llogaridhënien dhe efikasitetin e gjyqësorit ende pritet të finalizohet, të miratohet dhe të zbatohet. Në këtë drejtim, është thelbësor miratimi i ndryshimeve në ligjin “Për gjykatën e lartë”. Organizimi i gjykatave, transparencja, akumulimi i çështjeve dhe norma e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore vazhdojnë të jenë shqetësuese për efikasitetin e gjyqësorit, ashtu siç është edhe buxheti i akorduar. Procedimet gjyqësore për të hedhur dritë mbi ngjarjet e 21 janarit 2011 duhet të përfundohen përmes një procesi gjyqësor të besueshëm. Përparim i mirë është bërë në luftën kundër korrupsionit në gjyqësor, përmes kufizimit të imunitetit të gjyqtarëve. Shqipëria duhet të përshpejtojë zbatimin e strategjisë së reformës në drejtësi, me qëllim që të garantojë pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore.

Politika anti-korrupsion (shih dhe Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore)

Përparim i moderuar është bërë në lidhje me **politikat e luftës kundër korrupsionit**, që është prioritet kyç i Opinionit. Zbatimi i strategjisë anti-korrupsion dhe i masave specifike në sektorë dhe fusha të ndryshme në kuadrin e Planit të Veprimit për periudhën 2011-2013 vazhdon, edhe pse me ngadalë. Raportet për zbatimin e Planit të Veprimit, përfshi këtu edhe nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera relevante, nuk po publikohen akoma rregullisht.

Ka pasur përparim të moderuar në forcimin e kuadrit ligjor. Këtu përfshihet zbatimi i rekomandimeve të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) që kanë të bëjnë me kriminalizimin dhe financimin e partive politike. Në mars 2012 u miratuan ndryshimet në Kodin Penal në lidhje me aktet e korrupsionit të zyrtarëve të huaj dhe me miratimin e dënimeve të rënda për korrupsionin në sektorin privat. Për sa i përket financimit të partive politike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi një vendim në janar të 2012-ës që përmbush rekomandimin më të fundit të GRECO-s.

Janë miratuar ndryshimet në ligjin “Për noterinë”, që parashikon digjitalizimin e veprimtarisë së noterëve. Mbetet të finalizohen aktet nënligjore dhe hyrja e tyre në fuqi.

Janë bërë disa përparime përmes ndryshimeve kushtetuese për të kufizuar imunitetin e zyrtarëve të lartë publikë dhe të gjyqtarëve, që është jo vetëm një pengesë thelbësore për hetimin e duhur të rasteve të korrupsionit në Shqipëri, por kontribuon edhe në perceptimin e gjerë publik për mosndëshkimin e vazhdueshëm të disa pjesëtarëve të shoqërisë në këtë fushë.

Departamenti i Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit (DKBA) nuk ka mjaftueshëm pavarësi institucionale, autoritet dhe kapacitete administrative për të realizuar detyrat. Dobësitë e bashkëpunimit ndërmjet DKBA-së dhe institucioneve të tjera pasqyrohen në mungesën e përparimit në raportim, koordinim dhe monitorim të aktiviteteve. Stafi i kufizuar, sidomos i specialistëve të specializuar në parandalim dhe ndjekje penale, si edhe mungesa e burimeve financiare, përbëjnë një pengesë serioze në punën e DKBA-së.

Janë bërë përpjekje për të përmirësuar bashkëpunimin ndërinstitucional. U ngritën dy grupe pune ndërinstitucionale për shkëmbimin e informacionit dhe përpilimin e një formati standard për sistemin e konsoliduar të të dhënave mbi veprat penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë (ILDKP) nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Kontrollin e Lartë të Shtetit, me objekt ngritjen e një databaze për korrupsionin e dyshuar në administratën publike. Një memorandum mirëkuptimi është nënshkruar edhe me Avokatin e Popullit. ILDKP-ja ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi edhe me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) dhe Ministrinë e Drejtësisë, me objekt lehtësimin e shkëmbimit të informacionit mbi pasuritë e paluajtshme. Memorandumet ndërmjet ILDKP-së dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Gjykatës së Lartë nuk janë hartuar ende. Nevojitet të kryhet një analizë e zbatimit dhe efektivitetit të marrëveshjeve ekzistuese. Vendimi i Këshillit të Ministrave i 6 qershorit të 2012-ës përcakton se të gjitha noteritë dhe Prokuroria e Përgjithshme do të kenë akses në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Janë miratuar ndryshimet në ligjin "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", si edhe në ligjin "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve civilë". Këto ndryshime synojnë të forcojnë kompetencat dhe autoritetin e ILDKP-së në këtë fushë, si dhe të sjellin përmirësime ligjore që lehtësojnë hetimet.

Njësia e Hetimit Financiar nënshkroi marrëveshje për shkëmbim informacioni me Doganat, Agjencinë e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrën e regjistrimit të automjeteve. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje dhe shkalla e aksesit në informacion duhet të verifikohet. Digjitalizimi i informacionit relevant mbetet sfida. Nuk është bërë asnjë përparim në krijimin e regjistrit qendror të llogarive bankare.

Njësitë e Përbashkëta Hetimore (NJPH) vazhdojnë të jenë instrumente të mira për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit. ILDKP-ja ka bërë përparim në zbulimin e deklarimeve të dyshimta; janë realizuar disa hetime policore të rasteve të korrupsionit, ndërsa ndjekja penale e zyrtarëve të nivelit të ulët dhe të mesëm është rritur. Megjithatë, dënimet në çështjet e korrupsionit mbeten të rralla. Ende nuk ka një vijimësi bindëse të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve për korrupsion në të gjitha nivelet, përfshi zyrtarët e lartë. Mungesa e ekspertizës në hetimet financiare dhe e pajisjeve teknike për masat speciale të hetimit, pengon efektivitetin e hetimeve në çështjet e korrupsionit. Veçanërisht shqetësuese është kultura e përgjithshme e hetimeve të rasteve të korrupsionit mbi bazë denoncimi, dhe pothuajse mungesa e plotë e hetimeve proaktive. Informacioni i shërbimeve sekrete nga burime të ndryshme nuk është ndjekur sistematikisht; po ashtu, vlerësimi i riskut nuk bëhet sistematikisht.

Burimet e kufizuara njerëzore dhe financiare përbëjnë pengesë për Njësitë e Përbashkëta Hetimore, ILDKP-në, Prokurorinë dhe strukturat e ndryshme që merren me masat antikorrupsion. Departamenteve të kontrollit të brendshëm shpesh u mungon ekspertiza e specializua si edhe fokusimi i duhur te lufta kundër korrupsionit. Shkalla e bashkëpunimit ndërmjet agjencive ligjzbatuese, sidomos ndërmjet policisë dhe prokurorëve, mbetet e pamjaftueshme. Institucionet përgjegjëse për hetimet, inspektimet dhe dhënien e dënimeve, mbeten të cenueshme përballë presionit politik dhe influencave të paligjshme. Shoqëria civile vazhdon të luajë rol të kufizuar në luftën kundër korrupsionit. Statistikat penale dhe statistikat mbi rastet e konfliktit të interesit duhet të forcohen.

Kodi i ri i etikës i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve është publikuar dhe është shpërndarë. Megjithatë, korrupsioni në shërbimet tatimore, sidomos në inspektimin tatimor, është një çështje shumë shqetësuese që cenon seriozisht mjedisin e biznesit. Janë instaluar kamera në disa pika doganore kufitare. Efektiviteti i këtyre sistemeve duhet të verifikohet, në mungesë të masave më të shënjestruara për të luftuar korrupsionin doganor. Kontrollat e pasurive të nëpunësve tatimorë dhe doganorë ende nuk janë të mjaftueshme.

Planifikimi dhe zbatimi i përgjithshëm i masave antikorrupsion në sistemin e drejtësisë mbetet i pamjaftueshëm. Ende nuk ka vijimësi solide të masave disiplinore ndaj gjyqtarëve apo auditim i shëndoshë i pasurisë së tyre. Korrupsioni në gjyqësor mbetet problem veçanërisht serioz, pasi gjyqësori duhet të jetë një nga institucionet kyçe në luftën kundër korrupsionit.

Në programin shkollor është përfshirë një manual për mësuesit, i përgatitur për të rritur ndërgjegjësimin ndaj rreziqeve relevante të korrupsionit. Megjithatë, korrupsioni në sistemin arsimor mbetet një çështje shqetësuese, sidomos në institucionet e arsimit të lartë, të cilat nuk inspektohen mjaftueshëm. Në sektorin e shëndetësisë, efektiviteti i masave antikorrupsion vihet në diskutim nga monitorimi i pamjaftueshëm i kritereve të raportimit, si p.sh. kriteret për përdorimin e ilaçeve nëpër spitale. Dhënia e mitës për personelin mjekësor nuk po ndiqet mjaftueshëm.

Është bërë përparim i kufizuar në lidhje me masat specifike parandaluese, siç janë nismat ndërgjegjësuese. Numrat “e gjelbër” dhe formatet standard elektronike për denoncimin e rasteve nuk janë të fokusuara sa duhet në luftën kundër korrupsionit dhe ende nuk kanë sjellë rezultate të qenësishme.

Në tërësi, është bërë përparim i moderuar në luftën kundër korrupsionit, që është prioritet kyç i Opinionit. Duhet të bëhen hapa për të kufizuar imunitetin e pakufizuar të zyrtarëve të lartë dhe gjyqtarëve. Janë bërë disa përpjekje për të përmirësuar bashkëpunimin ndër-institucional, si dhe shkëmbimin e informacionit dhe ndjekjes penale në raste zyrtarësh përgjithësisht të nivelit të ulët dhe të mesëm. Megjithatë, hetimet efektive vazhdojnë të pengohen nga mungesa e një qasjeje proaktive si dhe mungesa e burimeve dhe pajisjeve. Nuk ka vijimësi adekuate hetimesh, ndjekjesh penale dhe dënimesh në të gjitha nivelet. Korrupsioni është prevalent në shumë fusha dhe vazhdon të jetë problem veçanërisht serioz

2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve (*shih edhe Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore*)

Respektimi i të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Shqipëria ka bërë përparim për sa i përket aderimit në **instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut**, me nënshkrimin e Konventës së Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje në dhjetor të vitit 2011. Pritet ratifikimi i saj dhe i Konventës së OKB-së për të Drejtat e

Personave me Aftësi të Kufizuar, e nënshkruar në dhjetor të 2009-ës. Vonesat në zbatimin dhe mosrespektimi i vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), sidomos në lidhje me të drejtat e pronësisë dhe të drejtën për gjykim të drejtë, vazhdojnë të jenë çështje shqetësuese. Gjatë periudhës raportuese, GJEDNJ-ja dha vendime për tetë kërkesa, duke vendosur që Shqipëria ka shkelur të drejtat e garantuara nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Që në shtator të 2011-ës, janë dorëzuar 98 kërkesa, duke e çuar në 379 numrin e kërkesave në pritje të vendimit.

Për sa i përket **promovimit dhe zbatimit të të drejtave të njeriut**, Avokati i Popullit ka ndjekur rol proaktiv që në momentin e emërimit. Megjithatë, Zyra e Avokatit të Popullit ende ka vështirësi me sigurimin e fondeve të mjaftueshme për të realizuar detyrimet e veta ligjore, kryesisht për vizitat monitoruese. Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) e ka fokusuar veprimtarinë në ndërgjegjësim dhe forcim kapacitetesh të stafit. Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me ministrinë e linjës dhe Komisioneri ka filluar të sistematizojë administrimin e çështjeve. Sidoqoftë, numri i çështjeve që trajton Komisioneri mbetet relativisht i ulët. Respektimi i të drejtave të njeriut në Shqipëri vazhdon të monitorohet nga organizmat ndërkombëtarë.

Të drejtat civile dhe politike

Është bërë përparim në **parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit**, si dhe në **luftën kundër mosndëshkimit**, që është pjesë e një prioriteti kyç të Opinionit. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit kanë kryer inspektime dhe kurse trajnimi tematike. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ngriti një grup pune për të adresuar rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe ka filluar bashkëpunimin me dy OJF për ofrimin e trajnimeve dhe monitorimin e ambienteve policore. Janë miratuar ndryshime në manualin për rregullat dhe trajnimin e personave të arrestuar dhe të ndaluar në komisariatet e policisë, si dhe është miratuar një databazë e re elektronike për personat e shoqëruar dhe të arrestuar. Po përdoret një formular i ri mjekësor, bazuar në Protokollin e Stambollit, ku dokumentohen rastet e keqtrajtimit në sistemin e burgjeve, si dhe është miratuar një formular tip për regjistrimin e ankesave të personave të shoqëruar dhe të arrestuar në komisariatet e policisë. Janë nxjerrë nga përdorimi disa qeli paraburgimi në komisariatet e policisë, të cilat ishin në gjendje shumë të keqe. Megjithatë, vazhdojnë të raportohen raste keqtrajtimi dhe përdorimi të tepërt të dhunës, dhe kushtet në disa burgje dhe qeli paraburgimi ende nuk plotësojnë standardet. Pavarësisht prirjes pozitive në këtë fushë, ende raportohet se procedurat për përpunimin e personave të shoqëruar apo të arrestuar nuk ndiqen sistematikisht. Rastet e keqtrajtimit vazhdojnë të trajtohen përmes procedimit administrativ dhe jo me procedim gjyqësor. Policia e Shtetit ka adresuar shumicën e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Është përmirësuar ndjekja e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, por një numër rekomandimesh mbeten të pazbatuara ose pjesërisht të zbatuara.

Puna e përbashkët e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë rezultoi në një vendim për ngritjen e një institucioni mjekësor të posaçëm për trajtimin e të dënuarve me sëmundje mendore, përfshi ata nën trajtim të detyrueshëm. Megjithatë, do të duhet kohë që ky institucion të konsolidohet, dhe mbetet shqetësim pamjaftueshmëria e kujdesit të specializuar dhe trajtimit për këtë kategori pacientësh. Ligji “Për shëndetin mendor” u miratua në prill të 2012-ës.

Në qershor të 2012-ës, Policia e Shtetit prezantoi databazën e personave të përfshirë drejtpërdrejt në gjakmarrje. Kjo mund të ndihmojë në adresimin e mungesës së të dhënave të besueshme në këtë fushë. Nevojiten masa më të vendosura të autoriteteve për adresimin e këtij probleme. Në fund të 2011-ës, ka pasur shqetësime në lidhje me certifikatat e rreme të gjakmarrjes të lëshuara nga një organizatë e shoqërisë civile, të cilat mundësonin aplikimin për azil në disa Shtete Anëtare të BE-së.

Përparim është bërë në **sistemin e burgjeve**, me zbatimin e vazhdueshëm të programeve të trajnimit, shtimin e aktiviteteve që u ofrohen të burgosurve si edhe përmirësimin e përgjithshëm të standardeve të trajtimit të tyre. Përmirësimi i ndjekjes së rekomandimeve të Avokatit të Popullit ka pasur impakt pozitiv në kushtet e të burgosurve. Vitet e fundit janë ndërtuar disa godina të vuajtjes së dënimit, të cilat duhet të mbështeten me buxhet adekuat për mirëmbajtjen. Pritet të miratohet rregullorja për planifikimin e infrastrukturës së sistemit të vuajtjes së dënimit. Kushtet e jetesës të të burgosurve vazhdojnë të ndryshojnë sipas ushqimit dhe pajisjeve që i sigurojnë nga familjarët. Instalimi i dollapëve me kyç ka përmirësuar konfidencialitetin e të dhënave personale mjekësore, që duhet të konsolidohet përmes trajnimit të vazhdueshëm të personelit të burgjeve për mbrojtjen e të drejtës së privatësisë dhe konfidencialitetit të të burgosurve. Përparimi në zëvendësimin e drynave me sisteme më moderne vazhdon të jetë i ngadaltë.

Ngritja e Shërbimit të Provës ka pasur impakt pozitiv në uljen e mbipopullimit në burgje dhe parandalimin e përsëritjes së veprave penale. Në janar të 2012-ës u hapën katër zyra të reja rajonale, si dhe janë miratuar plane për zhvillimin e Shërbimit, përfshi punësimin e specialistëve shtesë. Kjo do të ndihmojë në uljen e ngarkesës së punës për specialistët dhe do të përmirësojë funksionimin e Shërbimit. Ligji “Për monitorimin elektronik të të dënuarve” hyri në fuqi në prill të 2012-ës, si dhe është shpallur tenderi për përzgjedhjen e ofruesit të monitorimit elektronik. Mbetet shqetësim përdorimi i tepërt i paraburgosjes për autorët e veprave të lehta dhe i të miturve.

Pak përparim është bërë në lidhje me **aksesin në drejtësi**. Zbatimi i ligjit “Për ndihmë juridike falas” ka qenë i ngadaltë për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm dhe mungesës së koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Gjithashtu, nuk zbatohen me efektivitet as aktet nënligjore për rekrutimin e avokatëve të ndihmës juridike falas dhe as procedurat për kërkimin e ndihmës juridike falas. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike ka trajtuar disa çështje, por ndërgjegjësimi për ligjin dhe shërbimet e Komisionit mbeten të pamjaftueshme, përfshi edhe rangun e nëpunësve shtetërorë që merren me kategoritë e cënueshme. Aksesi në drejtësi për kategoritë e cënueshme nuk është i garantuar, kryesisht për shkak të tarifave të larta të administrimit gjyqësor. Tezgjatja e procedimeve gjyqësore vazhdon të jetë shqetësuese.

Liria e shprehjes është përgjithësisht e garantuar në Shqipëri. Përparim i mirë është bërë në lidhje me shpifjen, përmes miratimit në mars të 2012-ës të ndryshimeve në Kodin Penal dhe Kodin Civil, të cilat hoqën dënimet me burg dhe mbrojtjen e posaçme për zyrtarët publikë. Megjithatë, shpifja mbetet vepër penale, duke i ekspozuar gazetarët ndaj gjobave potencialisht të larta. Moratoriumi që ndalon zyrtarët qeveritarë të ngrënë padi për shpifje ndaj medias vazhdon përgjithësisht të zbatohet. Nga ana tjetër, është shqetësues numri i procedimeve ndërmjet politikanëve për shpifje, kryesisht ndërmjet deputetëve. Miratimi i ligjit “Për mediat audiovizive” është vonuar edhe më shumë. Pavarësia editoriale e transmetuesit publik nga qeveria nuk është forcuar. Qeveria ende ndërhyr drejtpërdrejt në emërimet në postet drejtuese. Tarifa mujore e transmetuesit publik është rritur, por sistemi i arkëtimit të tarifave ende nuk është i qëndrueshëm dhe duhet të rishikohet.

Është rritur presioni ekonomik mbi tregun mediatik, duke rënduar më tej pasigurinë në kushtet e punës së gazetarëve. Një numër i lartë gazetarësh punojnë pa kontrata formale pune, gjë që ka impakt të drejtpërdrejt në vetëcensurim. Ende nuk ka një organ vetërregullator dhe kapacitetet e sindikatave të gazetarëve mbeten të dobëta. Në lidhje me tregun e medias audiovizive dhe të shkruar, është përmirësuar transparenca për pronësinë, por burimet e financimit mbeten opake. Pavarësia editoriale vazhdon të pengohet nga interesat politike dhe ekonomike private. Ekzistojnë shqetësime se reklamat publike u shkojnë kanaleve televizive që mbështetin qeverinë.

Liria e tubimit dhe e organizimit është respektuar në përgjithësi. Gjatë periudhës raportuese ka pasur disa demonstrata të qytetarëve (ish-të burgosur politikë, ish-pronarë, organizata të aftësisë së kufizuar) dhe mitingje të

partive politike. Për sa i përket organizatave të shoqërisë civile, aksesit i vështirë në burimet e financimit, sidomos i OJF-ve të vogla që vepronë në zona rurale, vazhdon të kufizojë kapacitetet e shoqërisë civile për avokatin dhe formimin e rrjeteve. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile publikoi ftesën e tretë për projektpropozime në nëntor të 2011-ës, me një afat relativisht të shkurtër për alikantët që të mund të tërhiqnin dhe të përgatitnin dokumentacionin e nevojshëm. Nuk është bërë përparim në lehtësimin e kushteve për aktivitetet vullnetare në OJF, apo në përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm fiskal për OJF-të. Asistenca sociale dhe shërbimet bazuar në komunitet, që ofrohen nga OJF-të shqiptare, vuajnë nga mungesa e financimeve publike. Për sa i përket bashkëpunimit të institucioneve me shoqërinë civile, dialogu duhet të forcohet më tej në nivel qendror dhe vendor. Shoqëria civile përfshihet rregullisht në procesin e bërjes së politikave dhe në hartimin e legjislacionit, por konsultimi është shpesh proces formalist pa bashkëpunim të vërtetë.

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit vazhdon të respektohet. Të pesë besimet zyrtare vazhduan të marrin mbështetje nga buxheti i shtetit. Diskutimet mbi planet urbanistike për godinat e reja fetare në qytet kanë vazhduar.

Të drejtat ekonomike dhe sociale (shih edhe Kapitullin 19 - Politika sociale dhe punësimi)

Disa përparime janë bërë në lidhje me **të drejtat e grave dhe barazinë gjinore**, që është pjesë e një prioriteti kyç të Opinionit. Shqipëria filloi zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, për shembull duke hartuar një plan veprimi që përfshin kosto dhe kurse trajnimi për nëpunësit e barazisë gjinore nëpër ministri. Në korrik të 2012-ës, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin “Për futjen e dimensionit gjinor në programin buxhetor afatmesëm” të të gjitha ministrive të linjës. Duhet të përmirësohet koordinimi ndërmjet pushtetit qendror dhe vendor si edhe ndërgjegjësimi mbi kërkesat e strategjisë. Rrjeti i nëpunësve me kohë të plotë të barazisë gjinore përbëhet nga 17 persona në bashki dhe 2 në ministri linje. Gratë vazhdojnë të mos përfaqësohen sa duhet në politikëbërje dhe politikë. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor të miratuara në gusht të 2012-ës përfshinin rritje të penaliteteve për partitë në rast mosrespektimi të kuotës gjinore, por nuk parashikojnë dispozita për refuzimin e listave që nuk respektojnë kuotat. Është i nevojshëm aplikimi më strikt i kuotës gjinore në prag të përgatitjeve për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Zbatimi i legjislacionit dhe politikave ekzistuese për të drejtat e grave duhet të përshpejtohet.

Ndryshimet në Kodin Penal që parashikojnë sanksione deri në pesë vjet burg për veprën penale të dhunës në familje u miratuan në mars të 2012-ës. Ndërgjegjësimi ka çuar në shtimin e rasteve të dhunës në familje që denoncohen në polici. Procesi i forcimit të rrjetit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat e dhunës në familje po vazhdon, pavarësisht se me ritëm relativisht të ngadaltë. Megjithatë, sistemi i asistencës për viktimat nuk është plotësisht profesional, ku stafi shpesh nuk është i specializuar sa duhet dhe nuk i njih disa prej politikave të zbatuara nga pushteti qendror. Streha kombëtare për viktimat e dhunës në familje është funksionale, por ka ende varësi të konsiderueshme nga financimet e jashtme. Shqetësimet serioze në lidhje me drejtimin e strehës çuan në ndryshime në nivelet drejtuese, gjë që ka pasur impakt pozitiv në mbrojtjen e viktimave. Dhuna në familje është ende e përhapur dhe duhet të forcohet mbrojtja e grave kundër të gjitha formave të dhunës. Shqipëria mbetet burim i trafikimit të qenieve njerëzore dhe përmirësimet e fundit duhet të plotësohen me një qasje që ka në qendër viktimën, përfshi shërbimet e ri-integrimit dhe mbrojtjen e dëshmitarëve.

Ka pasur përparim jo të njëtrajtshëm në fushën e **të drejtave të fëmijëve**, që është pjesë e një prioriteti kyç të Opinionit, ku politikat ekzistojnë por zbatimi mbetet i ngradaltë dhe gjerësisht i varur nga asistenca e jashtme. Në prill të 2012-ës u miratua Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës për periudhën 2012-2015, si dhe u miratuan akte nënligjore të ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

Nënshkrimi i urdhrat të përbashkët të ministrave të Drejtësisë dhe të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në gusht të 2012-ës synon të rritë koordinimin për menaxhimin efektiv të rasteve të fëmijëve në rrezik abuzimi. Aktualisht funksionojnë 11 njësi të drejtave të fëmijës në nivel qarku dhe 62 njësi të mbrojtjes së fëmijëve (NJPM) në nivel bashkie dhe komune. Është prezantuar programi për adresimin e ndëshkimit fizik dhe dhunës psikologjike në shkolla. Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës deri tani ka zhvilluar vetëm një mbledhje. Ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor ka varësi sistematike nga organizatat e shoqërisë civile. Varësia nga donatorët vë në diskutim qëndrueshmërinë e këtyre strukturave dhe është e nevojshme që menaxhimi i decentralizuar i politikave të shoqërohet me burime adekuata në nivel vendor. Koordinimi ndërmjet strukturave të pushtetit qendror dhe vendor duhet të forcohet. Nuk janë bërë përpertime në lidhje me monitorimin dhe mbështetjen e fëmijëve që largohen nga institucionet rezidenciale të kujdesit në moshën 15 vjeçare. Vendimi i Këshillit të Ministrave i miratuar në gusht të 2012-ës synon të rritë numrin e fëmijëve nën kujdestari dhe parashikon që shteti të mbulojë të gjitha kostot e kujdestarisë për të gjithë fëmijët që përfitojnë, duke filluar nga shtatori i 2012-ës. Strategjia dhe plani i veprimit i drejtësisë për të miturit ende nuk janë miratuar. Përdorimi i tepërt i masës së arrestit me burg për të miturit është një shqetësim serioz, ku shumica e të miturve e kryejnë të gjithë pjesën e dënimit në paraburgim. Nevojitet miratimi i dispozitave ligjore për fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale dhe për të miturit dëshmitarë dhe viktime të krimit. Trafikimi i brendshëm i qenieve njerëzore, lypja e fëmijëve dhe puna informate e fëmijëve mbeten çështje shqetësuese dhe duhen adresuar në mënyrë konsistente.

Përpitim i kufizuar është bërë në zbatimin e politikave që shënjestrojnë **personat e cenueshëm** nga ana sociale dhe/ose me aftësi të kufizuara, që është pjesë e prioritetit kyç për antidiskriminimin. Grupi ndërministror i punës hartoi dhe organizoi konsultime mbi një ligj kuadër për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, por që ende nuk është miratuar. Vazhdon të ketë akses jo të njëtrajtshëm në gëzimin e të drejtave, për shkak të statusit të diferencuar të disa kategorive të caktuara dhe mungesës së statusit zyrtar për disa aftësi të kufizuara. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara vazhdon të jetë joadekuat dhe kuotat e punësimit që imponon ligji “Për nxitjen e punësimit” nuk zbatohen. Ligji “Për statusin e personave të verbër” dhe ligji “Për statusin e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë” u ndryshuan në mars të 2012-ës. Disa shoqata të personave me aftësi të kufizuara kanë protestuar kundër futjes së kriterëve dhe procedurave të reja për të fituar lehtësira në lidhje me energjinë, transportin publik dhe tarifën telefonike, të cilat morën shkak nga abuzimet e mëparshme me skemën. Ndryshimet në ligjin “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” bënë që në shkurt të 2012-ës të rishikohej vendimi që përcakton kriteret, procedurat dhe shumën e pagesave të përgjithshme të ndihmës sociale, duke përjashtuar personat me aftësi të kufizuara nga përfitimi njëkohësisht i ndihmës ekonomike dhe i pagesës për aftësinë e kufizuar. Ligji “Për arsimin parauniversitar” i miratuar në qershor, parashikon që klasat me fëmijë me aftësi të kufizuara duhet të kenë mësues ndihmës. Deri tani, shumë fëmijë me aftësi të kufizuara nuk janë integruar në sistemin arsimor publik.

Përpitim i moderuar është bërë në lidhje me zbatimin e **politikave antidiskriminim**, që është pjesë e një prioriteti kyç të Opinionit. Në prill të 2012-ës, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) prezantoi planin strategjik 2012-2015 dhe planin strategjik 2012. KMD-ja është fokusuar në forcim kapacitetesh dhe ndërgjegjësim, si dhe është konsultuar për hartimin e legjislacionit. Njohuritë e publikut për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” si dhe ndërgjegjësimi për të drejtën e ankimit pranë KMD-së mbeten në nivele të ulëta. Rastet potenciale të diskriminimit nuk raportohen sa duhet. Në periudhën raportuese, KMD-ja trajtoi 41 raste, përfshi 11 hetime *ex officio*. KMD-ja mori masë administrative në një rast. Nevojitet krijimi i një vijimësie solide rastesh që finalizohen, me qëllim të inkurajohen viktimat potenciale të denoncojnë rastet e tyre pranë Komisionerit.

Grupi ndërministror i punës, ku merr pjesë edhe shoqëria civile, hartoi një plan masash për periudhën 2012-2014 për mosdiskriminimin mbi baza orientimi seksual apo identiteti gjinor. OJF-të organizuan një kurs trajnimi mbi të drejtat e personave lesbike, homoseksualë, biseksualë dhe transeksualë (LGBT) për administratën publike. Më 17 maj 2012, me rastin e Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë, shoqëria civile me financimin e donatorëve organizoi një festival diversiteti ku ishin të pranishëm edhe autoritete shtetërore. Në prag të këtij evenimenti, janë bërë deklaratat homofobe denigruese nga një anëtar i qeverisë dhe një përfaqësues partie politike. Kryeministri i dënoi këto deklaratat dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi hetoi rastet dhe dha rekomandimet përkatëse. Komuniteti LGBT, sidomos personat transgjinorë, vazhdojnë të vuajnë nga diskriminimi dhe të kenë vështirësi për të aksesuar në shërbimet sociale dhe shëndetësore,

Të drejtat e punës dhe e bashkimit në sindikata janë respektuar në përgjithësi. Ka pasur dialog me sindikatat për kriteret e anëtarësimit në Këshillin Kombëtar të Punës. Sindikatat raportojnë se organeve shtetërore u mungon vullneti për të nënshkruar kontrata kolektive në sektorin publik. Bisedimet për kontrata kolektive në sektorin privat ende nuk janë të zhvilluara sa duhet. Vazhdon të ketë boshllëqe në zbatimin e legjislacionit për punën e fëmijëve.

Për sa i përket reformimit të kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e **të drejtave të pronësisë**, prioritet kyç i Opinioneve, është miratuar një ligj i ri për regjistrimin e pronave të paluajtshme që riorganizon Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) si institucion vetëfinancues dhe që përmban dispozita për digjitalizimin e regjistrimit të pronës. Janë miratuar ndryshime në ligjin “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, ku përcaktohen kriteret e reja për vlerësimin e tokës dhe shtyhet afati për kthimin dhe kompensimin e pronës deri në vitin 2014. Pranë Ministrisë së Drejtësisë është ngritur një drejtori e re për koordinimin.

Strategjia ndërsektoriale dhe plani i veprimit për reformën në fushën e të drejtave të pronës janë miratuar pas diskutimeve teknike me komunitetin e donatorëve dhe prezantimin e draftit nga disa grupe interesi. Strategjia synon që të përfundohet regjistrimi fillestar dhe të konsolidohet një regjistër publik elektronik i pasurive të paluajtshme, të përfundohen proceset e kthimit, kompensimit dhe legalizimit, të krijohet një skemë kompensimi efçente si edhe një fond fizik dhe financiar për personat e shpronësuar, të kontribuojë në luftën kundër korrupsionit në këtë sektor, si edhe të modernizojë sistemin e informacionit në lidhje me të drejtat e pronësisë. Legjislacioni në fuqi dhe nismat e ardhshme në këtë sektor duhet të jenë plotësisht të akorduara me objektivat e strategjisë. Planifikimi territorial, koordinimi dhe ndërveprimi institucional, si edhe krijimi i strukturave të zbatimit dhe monitorimit efçent, mbeten sfida të qenësishme në këtë drejtim. Për të garantuar qëndrueshmëri në zbatimin e strategjisë nevojiten konsultime më të gjera me grupet e interesit, të shoqëruar me masa më të vendosura.

Regjistri i territorit ende nuk është përfunduar dhe databazat e tokës dhe pronës vazhdojnë të mbeten nën kontrollin e agjencive të ndryshme pa koordinim të mjaftueshëm. Regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme duhet të përfundohet për të garantuar sigurinë e pronësisë. Pengesat ligjore duhet të eliminohen për të lehtësuar regjistrimin, duke u dhënë pronarëve titull të qartë dhe të padiskutueshëm mbi pronën. Pretendimet e ish-pronarëve për kompensim dhe kthim të pronës së konfiskuar gjatë regjimit komunist po trajtohen me ritëm shumë të ngadaltë. Qeveria ende nuk ka komunikuar një kalendar të qartë për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së në lidhje me të drejtën e pronës.

Respektimi dhe mbrojtja e minoriteteve, të drejtat kulturore

Marrëdhëniet ndërtnike kanë qëndruar të mira, pavarësisht përparimit të kufizuar në forcimin e kuadrit legjislativ dhe politikave për mbrojtjen e **minoriteteve**. Opinioni i Tretë i Komitetit Këshillues të Konventës

Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare (KKMMK) u publikua në qershor të 2012-ës. Opinioni rekomandon miratimin e një legjislacioni gjithëpërfshirës për minoritetet. Kjo do të ndihmojë në identifikimin e hapësirave ligjore, fragmentizimit ligjor në këtë sektor dhe qartësimin e politikave shtetërore kundrejt minoriteteve, duke përfshirë krijimin e kriterëve të duhura ligjore për njohjen e minoriteteve dhe sigurimin e aksesit ekektiv të të drejtave për të gjitha minoritetet. Nuk është rishikuar mandati dhe kapaciteti i Komitetit Shtetëror për Minoritetet.

Censusi për popullsinë dhe banesat, i cili përfshiu pyetje fakultative mbi origjinën etnike dhe lidhjet fetare, u zhvillua në tetor të 2011-ës. Rezultat e plota nuk janë publikuar ende dhe është e rëndësishme që përpunimi i të dhënave të kryhet në përputhje me standardet e BE-së. Pamjaftueshmëria në qartësinë e qëllimit të aplikimit të gjobave për refuzimin e deklaramit apo deklarimeve të rreme, të përfshira në ligjin për censusin, rezultuan në thirrje për bojkot nga ana e disa organizatave minoritare, çka sipas të dhënave paraprake nuk u ndoqën në masë të gjerë. Në dhjetor të 2011-ës, Gjykata Kushtetuese nxori një raport shpjegues mbi vendimin e saj rreth antikushtetueshmërisë së përfshirjes së “kombësisë” (etnisë) në regjistrin civil, duke u fokusuar në parimet kushtetuese të mosdetyrimit për të deklaruar etninë dhe ruajtjen e të dhënave delikate. Ky vendim u kritikua nga përfaqësuesit e minoritetit grek të cilët kërkuan një respektim të plotë të parimit të vetidentifikimit. Mbetet për t’u parë sesi do të garantohet aksesit për të drejta të veçanta lidhur me regjistrin civil. Për sa i përket **të drejtave kulturore**, arsimi publik në gjuhët e minoritetit nuk është ende i disponueshëm për të gjitha grupet minoritare dhe Shqipëria nuk e ka adoptuar Kartën Europiane për gjuhët rajonale dhe minoritare.

Përparim shumë i kufizuar është bërë për përfshirjen e **romëve**, që është pjesë e një prioriteti kyç të Opinioni. Qeveria ka miratuar vendime administrative për të lehtësuar procedurat e regjistrimit të lindjes; gjithsesi, vazhdon të mbetet koordinim i pamjaftueshëm mes institucioneve të ndryshme të përfshira në regjistrimin e lindjeve. Romët kanë përfutuar nga shpërndarja pa pagesë e teksteve shkollore për edukimin e detyrueshëm por vështirësitë financiare kanë çuar në vazhdimin e niveleve të larta të braktisjes së shkollës dhe regjistrimin e ulët të fëmijëve Roma në arsimin parashkollor.

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Romëve, Plani Kombëtar i Veprimit për Dekadën e Romëve dhe përfundimet operationale të seminarit të dhjetorit të 2011-ës mbi përfshirjen e komuniteteve rome dhe egjiptiane në kuadrin e integritit të Shqipërisë në BE, vazhdon të jetë shumë i ngadaltë për shkak të burimeve të papërshtatshme dhe koordinimit të pamjaftueshëm të institucioneve të përfshira në nivel qendror. Ekziston domosdoshmëria për të përmirësuar statusin e Sekretariatit Teknik të romëve në mënyrë që të rritet kapaciteti i tij për të imponuar dhe koordinuar efektivisht zbatimin e politikave. Janë krijuar grupe pune për romët në 10 qarqe për të monitoruar, vlerësuar dhe bërë plane për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve. Gjithsesi, njësitë e qeverisjes vendore nuk janë ende mjaftueshëm të përfshirë dhe të ndërgjegjësuar dhe duke lënë një numër të madh shërbimesh kritike për romët që ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile dhe të financuara nga donatorët ndërkombëtarë, çka mund të verë në pikëpyetje qëndrueshmërinë e tyre afatmesme.

Romët ende përballen me kushte shumë të vështira jetese dhe diskriminim të shpeshtë, veçanërisht për sa i përket aksesit në punësim dhe banimet në kushte të përshtatshme, gjë e cila çon në marginalizimin e tyre. Me gjithë kujdesin e madh të komunitetit ndërkombëtar, shoqërisë civile, Avokatit të Popullit dhe disa përpjekjeve të kufizuara nga qeveria, përgjigjja e autoriteteve qendrore dhe lokale kundrejt rivendosjes dhe asistimit të familjeve të mbetura rome, nga ato që u zhvendosen forcërisht nga vendbanimet e tyre pranë stacionit të trenit në shkurt të 2011-ës, ka qenë e pamjaftueshme në një masë të madhe. Përgatitjet për projektet infrastrukturore po rrisin rrezikun e këtyre zhvendosjeve. Qeverisjet qendrore dhe lokale duhet të hartojnë plane ndërhyrjeje për të trajtuar zhvendosjet e detyruara dhe të sigurojnë vendbanim alternativ për familjet në kushte të dobëta jetese.

Në tërësi, ka pasur përparim të moderuar në fushën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve.

Ka pasur përparim për arritjen e prioritetit kyç lidhur me **përmirësimin e trajtimit të të dënuarve**, për forcimin e ndjekjes gjyqësore të rasteve të trajtimit mjekësor dhe zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Janë marrë masa për të përmirësuar kushtet e burgimit dhe forcuar bashkëpunimin me Avokatin e Popullit. Janë raportuar disa raste të trajtimit mjekësor dhe policia nuk ndjek sistematikisht procedurat e duhura për arrestimin dhe mbikëqyrjen. Kushtet e jetesës në burgje janë ende të ndryshme. Ekzistojnë plane për krijimin e një institucioni mjekësor të posaçëm për të burgosurit me sëmundje mendore, por mbetet nevoja për të shtuar kujdesin e specializuar dhe përmirësimin e trajtimit. Vonesat në proceset gjyqësore dhe burimet ende të pamjaftueshme të Shërbimit të Proves vazhdojnë të çojnë në mbipërdorimin e masës së arrestit me burg.

Përparim jo i njëtrajshëm është bërë për sa i përket plotësimit të prioritetit kyç që kërkon forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke theksuar gratë, fëmijët dhe romët dhe zbatimit efektiv të politikave antidiskriminuese. Ndryshimet në Kodin Penal për dhunën në familje kanë qenë një hap pozitiv. Duhet të forcohet zbatimi i politikave për mbrojtjen e fëmijëve. Ekziston nevoja për adoptimin e masave legjislative për personat me aftësi të kufizuar dhe për të rishikuar legjislacionin me qëllim adresimin e masave potencialisht diskriminuese kundrejt personave LGBT. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka punuar mbi rritjen e ndërgjegjësimit, por nevojiten përpjekje të tjera për të krijuar një regjistër të rasteve që marrin zgjidhje. Ka ende diskriminim ndaj grupeve të caktuara të dobëta siç janë LGBT dhe romët. Marrëdhëniet ndëretnike mbeten të mira, por nuk janë marrë masa për të adresuar dobësitë në legjislacionin e përgjithshëm dhe kuadrin institucional në fushën e minoriteteve. Zbatimi i mekanizmave politike për përfshirjen e romëve dhe aksesit të këtij komuniteti në mbrojtjen dhe shërbimet sociale është ende i pamjaftueshëm duke çuar në marginalizim. Politikat në fushën e të drejtave të njeriut mbështeten në masë të madhe nga shoqëria civile dhe donatorët. Është e rëndësishme për Shqipërinë të prioritetizojë politikat në këto fusha për të siguruar një qëndrueshmëri.

Disa përparime janë bërë në fushën e të drejtave të pronësisë, veçanërisht me miratimin e ligjit të ri “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të Strategjisë Ndërsëktoriale dhe Planit të Veprimit për Reformën në Fushën e të Drejtës së Pronës, një prioritet kyç i Opinionit. Ka nevojë për koordinim dhe monitorim efikas për të siguruar zbatimin e strategjisë dhe lidhje ndërmjet legjislacionit në fuqi dhe nismave të ardhshme. Konsultimet me grupet e interesuara në këtë drejtim duhet të vazhdojnë. Nuk është përfunduar ende regjistrimi i parë i pronave. Pretendimet e ish-pronarëve për kompensimin dhe rikthimin e pronës janë trajtuar me një ritëm shumë të ngadaltë.

2.3 Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

Këshilli i Europës (KE) ka vazhduar të monitorojë nivelin e detyrimeve që Shqipëria po përmbush për anëtarësim, dhe ka ndjekur nga afër zhvillimit politike në vend përmes institucioneve të specializuara të KE-së dhe përmes zyrës së jashtme të përhershme në Tiranë, e drejtuar nga një përfaqësues i Sekretarit të Përgjithshëm. Në maj të 2012-ës, Shqipëria mori kryesimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës.

Shqipëria ka bashkëpunuar plotësisht me EULEX-in për të lejuar hetimin e dyshimeve të ngritura në rezolutën e adoptuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës. Në maj të 2012-ës Parlamenti miratoi unanimisht një ligj të posaçëm që lejonte hetuesit e EULEX-it të vijonin hetimet në territorin e Shqipërisë.

Shqipëria ka një marrëveshje dypalëshe imuniteti të vitit 2003 me Shtetet e Bashkuara që lejon përjashtime nga juridiksioni i **Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve**. Kjo nuk është në përputhje me Qëndrimin e Përbashkët

të BE-së mbi integritetit e Statutit të Romës apo me parimet udhëheqëse të BE-së për marrëveshjet dypalëshe të imunitetit. Është e nevojshme që qëndrimi i Shqipërisë të vihet në një linjë me qëndrimin e BE-së.

Bashkëpunimi rajonal dhe fqinjësia e mirë janë një pjesë e rëndësishme e procesit të Shqipërisë drejt Bashkimit Europian. Shqipëria ka vijuar të marrë pjesë aktive në iniciativat rajonale duke përfshirë Procesin e Bashkëpunimit të Europës Juglindore, Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (KBR), Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe Marrëveshjen për Hapësirën e Përbashkët Europiane të Aviacionit. Shqipëria në vitin 2012 mban kryesimin e Marrëveshjes për Tregtinë e Lirë në Europën Qendrore (MTLEQ) dhe kryesimin e Grupit Këshillues Shumëkombësh të Qendrës për Siguri dhe Bashkëpunim (RACVIAC). Si rezultat i një iniciative të nisur nga Shqipëria në kuadër të presidencës së saj për IRMARR (Iniciativa Rajonale për Migrimin, Azilin dhe Refugjatët), mes Shqipërisë, Malit të Zi dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë u miratua një marrëveshje për të lehtësuar marrëveshjet ndërkuftare mes këtyre vendeve. Shtetasit e këtyre vendeve tashmë e kanë të mundur të udhëtojnë mes tyre me kartat biometrike të identitetit për një periudhë deri në tre muaj.

Shqipëria ka vazhduar të luajë rolin e saj si një partner konstruktiv në rajon duke zhvilluar më tej **marrëdhëniet dypalëshe me shtetet e tjera të zgjerimit dhe Shtetet fqinje Anëtare të BE-së.**

Marrëdhëniet me *Bosnjë-Hercegovinën* kanë mbetur të mira. Është në proces përgatitjeje një marrëveshje dypalëshe për lejimin reciprok të udhëtimit të shtetasve vetëm me kartat biometrike të identitetit.

Vazhdojnë të zhvillohen marrëdhëniet me *ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë* me hyrjen në fuqi të marrëveshjeve për udhëtimin e qytetarëve në dy shtetet dhe bashkëpunimit si një pjesë e procesit të pranimit në BE. U firmos një marrëveshje lidhur me një qendër të përbashkët për shkëmbimin e informacionit mes trupave respektive policore kufitare dhe emigracionit.

Është rritur bashkëpunimi me *Malin e Zi* në marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare. Dy vendet iniciuan një marrëveshje për bashkëpunimin në arsim dhe firmosën një marrëveshje për rikuperimin e borxhit të Shqipërisë ndaj Malit të Zi, një marrëveshje për hapjen e një pike të përbashkët të kalimit kufitar dhe një plan bashkëpunimi për mbrojtjen.

Marrëdhëniet me *Serbinë* kanë mbetur të mira. Janë zhvilluar disa takime dypalëshe të nivelit të lartë. Në prill të 2012-ës u firmos një marrëveshje për bashkëpunimin veterinar. Është firmosur një marrëveshje ripranimi dhe një marrëveshje për lëvizjen reciproke të shtetasve.

Shqipëria vazhdon marrëdhëniet e saj shumë të mira me *Kosovën*, me të cilën ka nënshkruar protokolle rreth bashkëpunimit kufitar policor duke përfshirë patrullimin e përbashkët.

Shqipëria vazhdon të ketë marrëdhënie të mira me *Kroacinë* dhe *Turqinë*.

Marrëdhëniet me vendet fqinje anëtare të BE-së, *Greqinë* dhe *Italinë* kanë mbetur të mira. Nuk ka zhvillime për të raportuar për sa i përket marrëveshjes së kufijve detarë me Greqinë.

Në tërësi, Shqipëria ka vazhduar të luajë rolin e saj konstruktiv duke kontribuar në stabilitetin e rajonit. Në këtë kuadër, Shqipëria ka vazhduar të zbatojë kushtet e Procesit të Stabilizim-Asociimit.

3. KRITERI EKONOMIK

Për shqyrtimin e zhvillimeve ekonomike në Shqipëri, Komisioni është orientuar nga përfundimet e Këshillit Europian në Kopenhagen në qershor të 1993-it, sipas të cilave anëtarësimi në BE kërkon ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale dhe aftësinë për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcave të tregut të përbashkët europian.

3.1. Ekzistenca e ekonomisë së tregut funksionale

Bazat e politikës ekonomike

Pavarësisht skenës politike, përgjithësisht të polarizuar, partitë kryesore janë dakord për bazat e ekonomisë së tregut. Gjithsesi, situata politike e bën më sfidues miratimin dhe zbatimin e reformave strukturore. Objektivi kryesor i politikës ekonomike të qeverisë mbetet ruajtja e stabilitetit makroekonomik, gjë që është arritur gjerësisht. Megjithatë, rritja e deficitit fiskal në vitin 2011 çoi në rritje të mëtejshme të borxhit publik relativisht të lartë, duke e rënduar cenimin mikrofinanciar të Shqipërisë. Përparimi i reformës strukturore mbetet i pamjaftueshëm. Në veçanti, programi i privatizimeve praktikisht ka ndalur dhe kuadri institucional për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë dhe sundimin e shtetit të së drejtës është i dobët. Në shkurt të 2012-ës, Shqipëria dorëzoi Programin e Gjashtë Ekonomik dhe Fiskal për periudhën 2012-2014. Skenari makroekonomik afatmesëm i paraqitur në program është optimist. Trajtimi i risqeve të perspektivës buxhetore dhe i pengesave strukturore është ende i pamjaftueshëm. Në tërësi, është ruajtur konsensusi për bazat e ekonomisë së orientuar drejt tregut.

Stabiliteti makroekonomik

Sipas të dhënave paraprake, rritja ekonomike ngadalësoi në 3.1% në 2011-ën, nga 3.8% në 2010-ën. Kërkesa e brendshme ishte shtytja kryesore e rritjes së PBB-së, e nxitur nga formimi bruto i kapitalit fiks që u rrit me 3.6%. Rritja e konsumit privat ngadalësoi në 2.6%, duke ndier rëndesën e kreditimit të dobët familjar dhe rënien e mëtejshme të remitancave të punëtorëve. Kontributi i eksportit neto në rritjen e PBB-së ishte i papërfillshëm. Në tremujorin e parë të 2012-ës, ekonomia u tkurr me 0.2% me bazë vjetore, kryesisht nga rënia e fortë e prodhimit të industrisë dhe ndërtimit, pjesërisht si pasojë e kushteve të vështira të motit. Për pasojë, prodhimi i energjisë pësoi rënie duke sjellë ndërprerje në sektorin minerar. Prodhimi bujqësor dhe shërbime të tjera shënuan rritje. Shpenzimet për konsum dhe investimet mbeten të dobëta, duke pasqyruar pjesërisht situatën e paqartë ekonomike botërore. PBB-ja për frymë sipas paritetit të fuqisë blerëse ishte sa 31% e mesatares së BE-27 në vitin 2011, duke shënuar rritje nga 28% në 2010-ën. Në tërësi, ekonomia shqiptare vazhdoi të rritet në 2011-ën, e shtyrë nga kërkesa e brendshme, por aktiviteti ekonomik praktikisht kaloi në stanjacion në tremujorin e parë të 2012-ës.

Norma vjetore e inflacionit në 2011-ën ishte mesatarisht 3.5%, duke qendruar brenda objektivit prej 2-4% të Bankës së Shqipërisë (BSH). Faktorët kryesorë që kontribuan në inflacion ishin çmimet ndërkombëtare të artikujve ushqimorë dhe karburanteve. Rënia e çmimeve të artikujve ushqimorë të importuar dhe shtendosja e efekteve bazë, çuan në ngadalësimin e inflacionit në vitin 2012, që në shkurt zbriti deri në 0.6%. Inflacioni u përshpejtua në muajt në vijim, duke arritur në 2.8% në gusht. Duke filluar nga shtatori i 2011-ës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë uli normën bazë të interesit pesë herë me nivele të barabarta duke e zbritur në 4% me efekt total 1.25 pikë, dhe duke shënuar normën më të ulët prej shumë vitesh.

Pavarësisht disa masave të miratuara nga autoritetet monetare, niveli i euroizimit në Shqipëri mbetet i lartë. Për vitin 2011, kreditë në valutë të huaj përbëjnë 68% të totalit të kredive të këqija, prej të cilave më shumë se gjysma përbëhet nga kredi të pambrojtura; ndërsa depozitat në valutë përbëjnë 50%. Euroizimi i lartë ngushton

hapësirat e manovrimit të politikës monetare dhe mund të jetë burim potencial destabiliteti në sistemin financiar, për shkak se mund t'i ekspozojë bankat ndaj rrezikut të mospërputhjes valutore dhe rrezikut të tërthortë të kreditit.

Shqipëria vazhdoi të ndjekë regjimin fleksibël të kursit të këmbimit. Leku ishte më i qendrueshëm në vitin 2011, krahasuar me vitin pararendës, duke u zhvlerësuar me rreth 2% kundrejt euros. Gjatë tetë muajve të parë të 2012-ës, monedha shqiptare pati zhvlerësim të lehtë duke arritur në gusht vlerën 1.8% me bazë vjetore. *Në tërësi*, politika monetare mbetet e shëndetshme, inflacioni është mbajtur brenda objektivit dhe stabiliteti i normës së këmbimit është ruajtur gjerësisht.

Kushtet e tregut të punës u përmirësuan disi në 2011-ën, por papunësia mbetet përsëri e lartë me 13.3%, me një rënie të lehtë nga 13.7% në 2011-ën. Papunësia u rrit në kurriz të krijimit të vendeve të punës në sektorin privat jobujqësor. Punësimi vazhdoi rritjen gjatë gjysmës së parë të 2012-ës, edhe pse me ngadalësim prej rreth 1%. Papunësia vazhdon të jetë e lartë, ndërsa papunësia afatgjatë përbën rreth 3/4 e të gjithë punëkërkuessve, duke pasqyruar natyrën e vet strukturore. Statistikat e tregut të punës vazhdojnë të jenë të dobëta dhe të shtrembëruara për shkak të sektorit të gjerë joformal. *Në tërësi*, rezultatet e tregut të punës kanë pasur përmirësim të lehtë. Papunësia vazhdon të qendrojë e lartë edhe pse në rënie.

Deficiti i llogarisë korrente u thellua në 12.2% të PBB-së në 2011-ën, nga 11.3% vitin pararendës, duke pasqyruar kryesisht rritjen e hendekut tregtar dhe rënien e suficitit të llogarisë së shërbimeve. Deficiti i lartë tregtar u rrit në 23.8% të PBB-së në 2011-ën, nga 23% në 2010-ën, për shkak të ngadalësimit të eksporteve dhe rritjes së importeve. Kushtet e pafavorshme të motit në gjysmën e dytë të 2011-ës cenuan prodhimin e hidrocentraleve në Shqipëri, duke sjellë importimin dhe jo më eksportimin e energjisë elektrike, gjë që solli ndërprerje në industritë nxjerrëse që zgjatën deri në tremujorin e parë të 2012-ës. Deficiti i llogarisë korrente u përmirësua në gjysmën e parë të 2012-ës, pasi prodhimi i energjisë u rrit në prill dhe eksporti i mallrave u bë pozitiv, ndodhi që bashkë me rënien e importeve, çuan në ngushtimin e deficitit tregtar. Gjithashtu, llogaria e shërbimeve shënoi suficit në gjysmën e parë të 2012-ës, e ndihmuar kryesisht nga turizmi i fuqishëm që e tejkaloi rënien e remitançave.

Gjatë 2011-ës, fluksi i IHD-së neto ra me 10%, duke pasqyruar kushtet e vështira ekonomike globale, vështirësitë e ekonomive fqinje dhe riatdhësimin e kapitalit që përkoji me klimën e brishtë politike në vend në fillim të vitit. Si rezultat, fluksi IHD mbuloi rreth 65% të deficitit të llogarisë korrente, duke shënuar rënie nga 78% që ishte vitin pararendës. IHD-ja neto u rrit me rreth 30% në gjysmën e parë të 2012-ës, duke pasqyruar pjesërisht efektin bazë të favorshëm të shkaktuar nga tkurrja e investimeve të brendshme gjatë të njëjtës periudhë të 2010-ës. Është rritur IHD-ja në sektorin e nxjerrjes së naftës dhe në sektorin bankar; ky i fundit për shkak të rikapitalizimit të bankave. Shqipëria ka ruajtur një nivel relativisht të kënaqshëm rezerve valutore që mbulon rreth 4.4 muaj importe, edhe pse në rënie që nga viti 2010. *Në tërësi*, deficiti i lartë i llogarisë korrente mbetet burim cenimi, sidomos përballë ndikimit negativ që situata e brishtë ekonomike globale dhe rajonale shkakton mbi IHD-në dhe rënies së remitançave të punëtorëve.

Borxhi publik u rrit nga 3.1% e PBB-së në vitin 2010, në 3.5% në vitin 2011, ashtu siç ishte planifikuar, por vetëm pas rebalancimit të buxhetit në mes të vitit. Rritja e të ardhurave totale u ngadalësua në 1.8% dhe përbënte 25.1% të PBB-së, duke reflektuar të ardhura më të ulëta në kontekstin e dobësimit të shpenzimeve për konsum dhe rënies së fortë të të ardhurave jotatimore. Pas një tkurrje në vitin 2010, shpenzimet totale u rritën me 3.7% duke arritur në 28.6% të PBB-së në vitin 2011, si rezultat i rritjes së shpenzimeve kapitale dhe transfertave sociale. Buxheti i 2012 parashikon një deficit fiskal prej 3% të PBB-së, bazuar në supozimin se rritja reale e PBB-së do të jetë 4.3%. Në periudhën janar-korrik 2012, të ardhurat totale të buxhetit u rritën me 4%, krahasuar me

të njëjtën periudhë të vitit pararendës, por mbetën 5.4% më pak sesa plani, duke reflektuar pjesërisht parashikimet optimiste. Shpenzimet ishin gjerësisht në përputhje me planet, edhe pse pagesat e prapambetura përbëjnë shkak për shqetësim. Në korrik të 2012-ës, qeveria miratoi programin buxhetor afatmesëm (PBA) 2013-2015 bazuar në një normë të rishikuar me ulje të PBB-së në 3% për vitin 2012. PBA-ja synon ruajtjen e borxhit publik në 60% të PBB-së dhe moskapërcimin e huamarrjes neto mbi 3% të PBB-së në vitin 2012. Huamarrja e brendshme mbetet burimi kryesor i financimit të deficitit. *Në tërësi*, kuadri buxhetor mbetet i dobët në fazën e planifikimit, duke pasqyruar parashikime optimiste për të ardhurat, si dhe në fazën e ekzekutimit.

Borxhi publik është rritur nga 58.5% në 2010-ën në 58.8% në vitin 2011, përfshi 3.7% të PBB-së në borxhin e garantuar qeveritar. Në gjysmën e parë të 2012-ës, borxhi publik vazhdoi të rritet, duke arritur 59.4% të PBB-së. Borxhi publik relativisht i lartë dhe në rritje vazhdon të demonstrojë bazën afatshkurtër (50% e borxhit ka maturim njëvjeçar ose më pak), gjë që kërkon rifinancim të shpeshtë, edhe pse rreth tre të pestat e borxhit është huamarrje e brendshme. Po ashtu, pjesa më e madhe e borxhit të brendshëm mbahet nga bankat, gjë që përbën rrezik nëse bankat vendosin të reduktojnë ekspozimin e tyre ndaj borxhit publik si mënyrë për të rregulluar bilancet e tyre. Çdo rritje në normat e interesit do të kufizonte më tej hapësirën fiskale. Niveli kaq i lartë i borxhit publik është burim cenueshmërie mikrofinanciare. *Në tërësi*, borxhi publik relativisht i lartë dhe në rritje përbën shqetësim. Nevojitet konsolidim i mëtejshëm financiar për të adresuar këtë burim cenueshmërie mikrofinanciar.

Disa përpertime janë bërë për përmirësimin e administrimit të taksave. Skema e amnistisë fiskale, e cila ka për qëllim legalizimin e pasurive dhe të të ardhurave të padeklaruar, filloi të përdoret në gjysmën e dytë të 2011-ës dhe vazhdoi deri në fund të gushtit të 2012-ës. Bazuar në rezultatet paraprake të publikuara në shkurt, si rezultat i skemës janë mbledhur rreth 10,7 milion euro (0.1% e PBB-së). Për herë të parë, administrata tatimore miratoi një deklaratë të ardhurash që tatimpaguesit duhet ta dorëzojnë pranë zyrave të tatim-taksave brenda vitit 2012. Ligji për akcizat u përafhua më tej me *acquis*, ndërsa përgatitjet për përafrimin e ligjit “Për TVSH-në” kanë avancuar. Pagat e referencës të miratuara në 2007-ën si masë për të ulur evazionin fiskal do të hiqen, ndërsa frekuenca e pagimit të tatim-fitimit nga bizneset është rralluar nga një herë në muaj në çdo tre muaj. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, ende ka boshllëqe në mbledhjen e të ardhurave dhe kapacitete administrative. Ende mungon një sistem tatimor i plotë shtrengues dhe zbatimi i ligjit vazhdon të jetë i dobët, ashtu si dhe mbledhja e të ardhurave në nivel qendror e veçanërisht në nivel vendor. Janë bërë disa përpertime me procedurën e rimbursimit të TVSH-së gjatë gjysmës së parë të 2012-ës; megjithëse, vazhdojnë vonesat, duke u bërë një barrë shtesë për bizneset. *Në tërësi*, janë bërë disa përpertime në administrimin e taksave, por vazhdon të ketë mangësi strukturore.

Në tërësi, Shqipëria ka ruajtur stabilitetin makroekonomik, pasi u prek më pak nga kushtet e vështira ekonomike në rajon dhe përtej. Politika monetare ka kontribuar me sukses për të mbajtur inflacionin të qendrueshëm qëndrueshëm dhe për të ankoruar pritshmëritë inflacioniste. Niveli i lartë i euroizimit vazhdon të kufizojë efektivitetin e kanaleve të transmetimit monetar. Borxhi publik relativisht i lartë dhe në rritje kufizon hapësirën fiskale dhe mbetet burim cenimi mikrofinanciar. Ende mungojnë reformat thelbësore strukturore.

Ndërveprimi i forcave të tregut

Sipas të dhënave zyrtare, sektori privat vazhdon të përbëjë 80% të PPB-së dhe punëson rreth 82% të fuqisë punëtore. Në 2011-ën nuk ka pasur privatizime të mëdha. Në dhjetor, Parlamenti miratoi ligjin që autorizon privatizimin e ndërmarrjes shtetërore të naftës “Albpetrol”, ndërsa afati i paraqitjes së ofertave u caktua në shtator të 2012-ës. Përgatitjet për privatizimin e aksioneve shtetërore të Albtelecom-it (16.75%) kanë filluar, edhe pse afati i paraqitjes së ofertave u shty për në dhjetor. Privatizimi i INSIG-ut, një kompani shtetërore sigurimesh, mbetet një objektivi për vitin 2012, së bashku me privatizimin e tre hidrocentraleve në pronësi të KESH-it që është ndërmarrje shtetërore që prodhon energjinë elektrike. Çmimet e rregulluara janë vlerësuar se përbëjnë 8%

të indeksit të çmimeve të konsumit (CPI). Janë arritur disa përparime me miratimin e strukturës tarifore për ujin, e cila ndër të tjera synon balancimin e tarifave për të siguruar mbulimin e kostove. Në tërësi, përfshirja e shtetit në ekonomi mbetet e kufizuar dhe është e përqendruar në energjetikë, transport dhe furnizimin me ujë.

Hyrja dhe dalja nga tregu

Regjistrimi dhe licencimi i biznesit vazhdoi të kryhet mirë nëpërmjet rrjetit të krijuar *one-stop-shop*. Disa përmirësime janë bërë në **sistemin e regjistrimit të biznesit**, përmes zbatimit të Regjistrimit Tregtar Elektronik për bashkimet dhe përqendrimit e shoqërive tregtare, si dhe për ndarjet dhe shndërrimet. Ka pasur reduktim të mëtejshëm të kohës dhe hapave të nevojshme për hapjen e biznesit. Prokurimi elektronik dhe deklarimi elektronik i taksave janë instaluar dhe funksionojnë tashmë. Megjithatë, procedura për dhënien e lejeve të ndërtimit mbetet e gjatë, duke vonuar ringjalljen e sektorit të ndërtimit në vështirësi. Reforma e inspektorateve që merren me biznesin dhe aktivitetet ekonomike është në fazë të hershme. Nuk është bërë përparim në fushën e nënshkrimit elektronik dhe nuk ka ndonjë zhvillim të veçantë në lidhje me zbatimin e ndryshimit në ligjin “Për mbrojtjen e investitorëve të huaj”, që ka të bëjë me pronësinë e paluajtshme.

Nuk është bërë përparim në reduktimin e kohës dhe procedurave për daljen nga tregu, që mbeten të ngadalta. Gjatë vitit 2011, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) u dorëzuan rreth 3 900 kërkesa për mbylljen vullnetare të biznesit. Struktura e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit u miratua në janar të 2012-ës. Performanca e Agjencisë mbetet për t’u vlerësuar.

Në tërësi, Shqipëria ka bërë përparim të mirë në lehtësimin e hyrjes së biznesit në treg. Procedurat për daljen nga tregu mbeten të ngadalta dhe të joefektive.

Sistemi juridik

Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit për të drejtat e pronësisë u miratua në qershor. Është bërë pak përparim me **regjistrimin e tokës dhe kthimin e pronave tek ish-pronarët**. Procesi i regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme nuk ka përfunduar ende. Në tërësi, mungesa e të drejtave të sigurta mbi pronën dhe institucionet e dobëta mbeten shkak për shqetësim dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme për të adresuar këto çështje.

Bizneset ende përballen me vonesa në procedurat gjyqësore dhe vazhdon perceptimi se korrupsioni në sistemin e drejtësisë është i përhapur. Me fillimin e aktivitetit të zyrave private të përmbartimit, janë arritur disa përmirësime në ekzekutimin e kolateralit. Megjithatë, ekzekutimi i dobët i kontratave dhe kolateralit mbetet pengesë e madhe për bizneset. Janë ende të përhapura metodat joformale të ekzekutimit të kontratave, që anashkalojnë sistemin e drejtësisë. Ligji “Për krijimin e gjykatave administrative” u miratua në Parlament në maj të 2012-ës. Në tërësi, dobësitë në sundimin e ligjit, reforma e paplotë e të drejtave të pronësisë dhe korrupsioni, vazhdojnë të ndikojnë negativisht në mjedisin e biznesit.

Zhvillimi i sektorit financiar

Sistemi financiar mbetet i dominuar nga sektori bankar që kontribuon me rreth 85% të PBB-së dhe përbëhet nga 16 banka tregtare të gjitha me pronësi private. 90% e aktiveve totale ka pronësi të huaj. Pavarësisht mbizotërimit të bankave, huadhënia bankare qëndroi në rreth 43% të PBB-së, gjë që tregon se ka hapësirë të madhe për ndërmjetësim financiar. Kreditimi u rrit me 11.7% në 2011-ën, nga 8.6% vitin pararendës. Në korrik të 2012-ës, rritja e kreditimit u ngadalësua në 7% me bazë vjetore. Kreditë e këqija të institucioneve jofinanciare, që përbëjnë

përqindjen më të lartë të totalit të huave bankare, u rritën në dhjetor me 15.4% me bazë vjetore, por u ngadalësuan në gjysmën e parë të 2012-ës duke arritur 9.7% në korrik. Huadhënia për familjarët u dobësua në 2011-ën, duke u tkurrur gjithnjë e më shumë në shtatë muajt e parë të 2012-ës, kryesisht për shkak të rënies së huadhënies në valutë. Huadhënia në lek e tejkaloi huadhënien në valutë gjatë 2011-ës. Kjo prirje vazhdoi deri në korrik të 2012-ës, duke pasqyruar kërkesën e moderuar për kredi si edhe politikat huadhënëse më konservatore të bankave. Megjithatë, rreth 68% e huave të këqija është në valutë, nga të cilat më tepër se gjysma përbëhet nga kredi të pambrojtura, gjë që tregon se sistemi bankar mbetet i cenueshëm në rast luhatjesh të pafavorshme të kursit të këmbimit. Rritja e depozitave ngadalësoi në 14.5% në 2011-ën, nga 15.5% vitin pararendës, si dhe në korrik të 2012-ës ngadalësoi edhe më shumë në 10.6% me bazë vjetore. Huamarrja e jashtme e sektorit bankar si përqindje e pasiveve totale, shfaq prirje në rritje në 2011-ën, duke shkuar nga 4.9% në 2010-ën në 6.8% në fund të 2011-ës dhe më pas u stabilizua në 7% gjatë gjysmës së parë të 2012-ës.

Në përgjithësi, sektori bankar mbetet i mirëkapitalizuar dhe likuid. Pas një rënieje në gjysmën e parë të 2011-ës, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit u stabilizua në 15.6% në fund të vitit, ndjeshëm më lart se minimumi i kërkuar. Megjithatë, kreditë me probleme vazhduan të shtohen gjatë 2011-ës dhe në qershor të 2012-ës përbënin 21.21% të huave totale. Si kundërpërgjigje, sektori bankar rriti provigjionet nga 10.8% të totalit të huave në fund të 2011-ës në 12.2% në fund të tremujorit të 2012-ës, e cila pati ndikim negativ të përfitueshmëria. Procesi i ekzekutimit të kolateralit ka qenë i ngadaltë, duke pasqyruar pjesërisht procesin e dobët gjyqësor, gjë që vonon rikuperimin e bilanceve të bankave.

Gjatë vitit 2011 u miratuan disa masa parandaluese për të forcuar stabilitetin e sektorit bankar. Ligji “Për bankat” u ndryshua në nëntor të 2011-ës, duke u dhënë Bankës së Shqipërisë kompetenca të reja për t’u kërkuar degëve të bankave të huaja që të shndërrohen në filiale. Në qershor të 2011-ës, Banka e Shqipërisë miratoi rregullore për krijimin e “bankës urë” që lehtësojnë gjetjen e zgjidhjes në rast se një bankë has në vështirësi. Përveç kësaj, kuadri rregullator dhe mbikëqyrës është forcuar me kufij rregullatorë më të shtrënguar, të diferencuar sipas monedhës, sipas treguesve të likuiditetit të bankës dhe udhëzimeve për detyrimin e bankave tregtare për të respektuar kriteret e rezervës minimale valutore. Në korrik të 2012-ës, Parlamenti miratoi disa ndryshime në ligjin “Për sigurimin e depozitave”. Në tërësi, sektori bankar vazhdon të jetë i mirëkapitalizuar dhe likuid. Megjithatë, niveli i lartë i kredive me probleme është çështje shqetësuese.

3.2. Aftësia për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së

Ekzistenca e një ekonomie funksionale të tregut

Shqipëria e ka ruajtur stabilitetin makroekonomik, pasi është prekur më pak nga kushtet e vështira ekonomike rajonale dhe globale. Rritja e PBB-së edhe pse pozitive, ngadalësoi dhe qëndroi nën mesataret historike. Me gjithë rritjen e lehtë të punësimit, mosbalancimet strukturore të tregut të punës dhe borxhit publik mbeten të larta. Deficiti buxhetor u përkeqësua me dobësimin e të ardhurave dhe rritjen e shpenzimeve; si rezultat, borxhi publik u rrit. Niveli relativisht i lartë i borxhit publik i kombinuar me strukturën afatshkurtër të tij mbeten një burim cenimi makrofinanciar. Programi i privatizimeve të planifikuara ka ngecur. Janë realizuar disa reforma që lehtësojnë hyrjen në treg, por kanë ngadalësuar përpjekjet për të garantuar daljen e rregullt nga tregu për bizneset. Vërehen dobësi në sundimin e ligjit, sidomos në ekzekutimin e kontratave dhe të drejtave të pronësisë. Në tërësi, dhe pse janë bërë disa përparime në krijimin e një ekonomie tregu funksionale, Shqipëria duhet të konsolidojë financat publike dhe të ulë borxhin publik relativisht të lartë, duke forcuar qeverisjen dhe performancën e tregut të punës, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave të pronësisë si dhe forcimin e sundimit të ligjit.

Shpenzimet publike në arsim vlerësohet të kenë arritur 3% të PBB-së në 2011-ën, ndërsa akordimi buxhetor i planifikuar për 2012-ën është pothuaj 2.8 %. Shpenzimet për arsimin synojnë të përmirësojnë cilësinë e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve në të gjitha nivelet, me fokus të veçantë arritjen e standardeve të OECD-së për raportin mësues/nxënës , duke shtuar 400 mësues dhe duke rritur numrin e laboratorëve shkencorë. Ka filluar një fushatë për modernizimin e teksteve dhe programeve shkollore, për t'i sjellë ato në linjë me nevojat e tregut të punës. Nuk janë raportuar zhvillime në lidhje me rritjen e shpenzimeve publike për kërkim-zhvillimin. Buxheti për kërkim-zhvillimin mbetet mjaft i ulët, në 0.04% të PBB-së në 2012-ën, i ngjashëm me atë të caktuar për vitin 2011. Ka mungesë institucionesh kërkimore shkencore dhe bashkëpunimi midis universiteteve dhe industrisë për kërkim-zhvillimin është i dobët. Sistemi “Brain Gain” që u jep bonuse nëpunësve publikë të shkolluar jashtë shtetit, rifilloi në vitin 2012 pas pezullimit në 2011-ën.

Sipas të dhënave paraprake, investimet në 2011-ën përbënin 33.1% të PBB-së, pak më poshtë sesa në 2010-ën. Shpenzimet kapitale publike vlerësohet të kenë arritur në 6.2% të PBB-së në 2011-ën dhe pritet të jenë pak më të ulëta në 2012-ën, rreth 5.8%. Shëndetësia, arsimi, infrastruktura dhe bujqësia vazhdojnë të jenë fushat prioritare në lidhje me investimet publike. Megjithatë, investimet publike kryesore (rreth 55% e totalit të investimeve publike) janë përqendruar në infrastrukturën rrugore. Mirëmbajtja rrugore e pamjaftueshme dhe ndërtimet e paligjshme përgjatë rrugëve mbeten çështje shqetësuese. Transporti hekurudhor mbetet i pazhvilluar . Nevojiten investime të mëtejshme në infrastrukturë për të tërhequr investitorët dhe për të stimuluar turizmin. Prodhimi i energjisë elektrike mbetet i cenueshëm, për shkak të varësisë së lartë nga hidrocentralet. Kushtet e pafavorshme të motit kanë cenuar seriozisht prodhimin e energjisë që ra me 48% në 2011-ën. Për të shmangur ndërprerjet, është importuar energji, çka ka pasur ndikim negativ në rritjen e ekonomisë dhe në bilancin tregtar. Gjithashtu, sistemi energjetik ka nevojë për investime të konsiderueshme për të përmbushur kërkesat në lidhje me sigurinë e furnizimit. Furnizimi i pasigurt me energji përbën pengesë për bizneset, pasi ndërpret prodhimin dhe shton kostot. Në përpjekje për të përmirësuar kapacitetet prodhuese në mënyrë që të përballohet kërkesa, qeveria vazhdoi dhënien e lejeve koncesionare në 2011-ën për ndërtimin e hidrocentraleve të reja. Sidoqoftë, numri i koncesioneve që janë funksionale mbetet i ulët, duke pasqyruar kryesisht kuadrin e dobët ligjor. Operatorët e centraleve private prodhojnë vetëm 2% të ofertës totale. Në tërësi, nevojiten nivele më të larta investimesh për ta bërë ekonominë shqiptare konkurruese në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Rritja afatgjatë do të inkurajohej nëse përqendrohen më tepër shpenzime në kategoritë që nxisin rritjen, si p.sh. kapitali njerëzor dhe infrastruktura fizike prodhuese, përfshi furnizimin me energji elektrike.

Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Përqindja relative kundrejt vlerës së shtuar neto (VSHB) e bujqësisë, industrisë dhe shërbimeve mbeti në 2011-ën pothuaj njësoj si vitin pararendës. Shërbimet vazhdojnë të jenë kontribuesi kryesor në GVA me rreth 60%, ku tregtia, hoteleria dhe restorantet përbëjnë pjesën kryesore të këtij sektori. Përqindja e bujqësisë në GVA u rrit me rreth 21% në kurriz të ndërtimit që pësoi rënie me pothuaj 11%. Rënia e industrisë prodhuese si përqindje e GVA-së u kompensua nga rritja e industrive nxjerrëse. Bujqësia mbetet “punëdhënësi” kryesor me 54% të punësimit total në gjysmën e parë të 2012-ës. Industria e përpunimit të brendshëm pati performancë të mirë gjatë 2011-ës, por prodhimi i energjisë u tkurr.

Baza e industrisë prodhuese mbetet e përqendruar në tre nënsektorë që përbëjnë rreth 83% të totalit të eksporteve të mallrave në vitin 2011 që janë produkte ose me vlerë të shtuar të ulët, ose të cenueshme nga luhatjet e çmimeve globale të mallrave: tekstilet dhe veshjet për këmbën (32%), mineralet, karburantet dhe energjia elektrike (30%) dhe materialet e ndërtimit (21%).

Politikat e dobëta tatimore dhe të shpenzimeve si dhe zbatimi i dobët i ligjit, përfshi luftën kundër korrupsionit, po nxisin sektorin e konsiderueshëm joformal. Gjatë vitit janë marrë disa nisma për të adresuar informalitetin, përfshi përdorimin e pajisjeve fiskale (kasave) në mbarë vendin. Megjithatë, zbatimi mbetet sfidë për administratën. Ekonomia joformale vazhdon të pengojë konkurrencën e lirë në treg, dhe forcimi i sundimit të ligjit mbetet prioritet për qeverinë. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme vazhdojnë të përfitojnë fonde nga skemat mbështetëse të kreditimit si edhe nga Fondi Europian për Europën Juglindore (EFSE). Në tërësi, struktura e ekonomisë mbetet e pandryshuar. Edhe pse janë ndërmarrë disa masa për të luftuar ekonominë gri të konsiderueshme, informaliteti mbetet sfidë. Baza prodhuese e Shqipërisë nuk ka diversifikim, për sa i përket sektorëve dhe tregjeve të eksportit, duke e lënë ekonominë të cenueshme nga tronditjet specifike të industrisë.

Ndikimi i Shtetit në konkurrueshmëri

Subvencionet mbetën pothuaj të pandryshuara si vitin pararendës, në 0.3% të PBB-së në 2011-ën. Për vitin 2012, buxheti parashikon rënie të subvencioneve në 11.4 milion euro, ose rreth 0.1% të PBB-së. Subvencionet u jepen një numri të kufizuar sektorësh, konkretisht sektorit të hekurudhave, energjetikës dhe furnizimit me ujë, si edhe për skemat horizontale të ndihmës shtetërore. Rentabiliteti financiar i sektorit energjetik mbetet i luhatshëm, pasi humbjet në rrjetin energjetik dhe shpërndarje u përkeqësuan më tej në 2011-ën, arkëtimi i faturave vazhdoi rënien, ndërsa tarifat janë ende nën nivelin e mbulimit të kostos, gjë që shkakton presion mbi financat publike. Kostoja e importimit të energjisë elektrike për të kompensuar rënien e prodhimit, nuk është transferuar te përdoruesit përfundimtarë, por ka nxitur qeverinë të japë në janar të 2012-ës edhe 14.2 milion euro shtesë KESH-it në formë garancie huaje. Financat e KESH-it vazhdojnë të jenë të ekspozuara ndaj rezultatit të marrëveshjes së rakordimit të borxheve të miratuar në mars të 2012-ës me CEZ-in, shoqërinë tregtare të shpërndarjes. Kjo marrëveshje është pjesë e zbatimit të protokollit për zgjidhjen e pjesshme financiare të borxheve të ndërsjella të prapambetura, i nënshkruar nga autoritetet shqiptare, CEZ-i dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në nëntor të 2011-ës. Ende nuk është zbatuar plotësisht dhe mosmarrëveshja ndërmjet KESH-it dhe CEZ-it për borxhet e ndërsjella të prapambetura e cila mbetet e pazgjidhur. Në tërësi, ndërhyrja e shtetit mbetet e kufizuar. Sidoqoftë, mbetet shqetësim ndikimi që ka mbi financat publike mungesa e diversifikimit dhe rentabilitetit të plotë financiar të sektorit të energjisë elektrike, si dhe varësia e lartë ndaj kushteve klimatike.

Integrimi ekonomik me BE-në

Hapja e ekonomisë shqiptare vazhdoi të rritet në 2011-ën. Në 2011-ën, tregtia e mallrave dhe e shërbimeve përbënte rreth 90% të PBB-së, me rritje nga 86% vitin pararendës. Pavarësisht një rënieje në 2011-ën, BE-ja mbetet partneri kryesor tregtar i Shqipërisë. Rreth 80% e eksporteve shqiptare janë me BE-në, ku tekstilet dhe veshjet për këmbën përbëjnë më shumë se gjysmën e eksporteve totale. Rreth 65% e importit e zënë mallrat nga BE-ja. Me gjithë kushtet ekonomike të pasigurta në disa Shtete Anëtare të BE-së, eksportet drejt BE-së në periudhën janar-korrik u rritën me rreth 8.5% me bazë vjetore. Janë rritur ndjeshëm importet dhe eksportet me vendet CEFTA gjatë 2011-ës. Në 2011-ën, tregtia e mallrave me CEFTA-n u rrit me rreth 33%, duke përbërë 17.2% të eksporteve totale dhe 13.5% të importeve totale. BE-ja mbetet burimi kryesor i investimeve në Shqipëri, por përqindja e BE-së në stokun IHD ka pësuar rënie në katër vitet e fundit.

Pas një periudhe ku u rritën presionet konkurruese të çmimeve, kursi efektiv i këmbimit (REER) ra ndjeshëm në 2010-ën, kryesisht për shkak të zhvlerësimit të lekut në terma nominalë efektivë. REER përgjithësisht mbeti i qëndrueshëm gjatë 2011-ës dhe në muajt e parë të 2012-ës. Konkurrueshmëria e kostos është përmirësuar që nga 2010-a, dhe vlerësohet se ka pasur rënie të fortë të kostove për njësi pune, e ndihmuar nga rritja e

prodhueshmërisë. Në tërësi, BE-ja vazhdoi të jetë partneri kryesor tregtar dhe i investimeve në Shqipëri. Tregtia me vendet CEFTA është rritur.

4. AFTËSIA PER TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

Ky seksion merr në shqyrtim aftësinë e Shqipërisë të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, që do të thotë ato të *acquis* siç shprehet në traktate, të akteve nënligjore dhe politikave të Bashkimit. Gjithashtu, analizon kapacitetin administrativ të Shqipërisë për të zbatuar *acquis*. Analiza ndahet sipas listës së 33 kapitujve të *acquis*. Në çdo sektor, vlerësimi i Komisionit trajton përparimin e arritur gjatë periudhës raportuese dhe bën një përmbledhje të nivelit të përgjithshëm të gatishmërisë së vendit.

4.1. Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave

Nuk është bërë përparim në fushën e **parimeve të përgjithshme**.

Shqipëria përgjithësisht ka bërë përparim për sa i përket **masave horizontale**, veçanërisht në fushën e standardizimit dhe vlerësimit të konformitetit.

Përparim i mirë është bërë në fushën e **standardizimit**. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) ka vazhduar të punojë drejt përbushjes së kushteve për të aplikuar për anëtarësim të plotë në Komitetin Europian të Standardizimit (CEN) dhe në Komitetin Europian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC) në vitin 2012. Bordi Drejtues i Standardizimit ka miratuar rregullore të brendshme në përputhje me parimet e anëtarësimit të CEN-it dhe CENELEC-it. Ka vijuar përparimi drejt adoptimit të Standardeve Europiane (ENs). PS-ja ka adoptuar rreth 95.5% të EN-ve si standarde shqiptare, duke përfshirë të gjitha EN-et e përafuara. Mbetet i ulët numri i standardeve të përkthyer, pasi shumica e SE-ve janë miratuar përmes metodës së “faqes së parë”. Nuk janë adoptuar ende në nivel kombëtar standardet e Institutit Europian të Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI). Është miratuar kodi mbi zhvillimin, miratimin, aprovimin dhe zbatimin e standardeve dhe u krijua një grup pune për miratimin e standardeve kombëtare për naftën dhe benzinën. Megjithatë, nuk mund të raportohet përparim rreth përgatitjes së Strategjisë Kombëtare mbi standardizimin.

Nuk ka pasur përparim në fushën e **vlerësimit të konformitetit**. Ligji “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimore” i miratuar në dhjetor të 2011-ës, synon përafrim më të gjerë me legjislacionin europian. Ka ende nevojë për vlerësimin e përafrimit të tij me legjislacionin europian.

Mund të raportohet përparim në fushën e **akreditimit**. Numri i institucioneve të akredituara për vlerësimin e konformitetit është rritur në 21. Në nëntor të 2011-ës, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) u bë anëtare e asociuar e Bashkëpunimit Europian për Akreditimin (EA). Janë duke u kryer përgatitjet për anëtarësim të plotë. DPA-ja ka mbështetur organizimin e testeve të zotësisë në fushat e materialeve të ndërtimit dhe cilësisë së ujit. U ngritën katër komitete teknike për laboratorët e testimit dhe kalibrimit, institucionet inspektuese, akreditimin e pajisjeve mjekësore dhe certifikimit të institucioneve për sistemin e administrimit të mjedisit dhe kontrolleve mjedisore. Megjithatë, nuk ka pasur përparim në përafrimin e ligjit të akreditimit me *acquis* horizontale të vitit 2008.

Ka pasur përparim në fushën e **metrologjisë**. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) u përforcua me një rritje stafi teknik prej 10 personash. U shtua kapaciteti i laboratorit të saj dhe u zgjeruan ambientet e matjeve. Është drejt përfundimit puna për ambientet e reja të Qendrës Kombëtare të Metrologjisë në Tiranë. Shoqata Europiane e Institutit Kombëtar të Metrologjisë ka dhënë një vlerësim pozitiv për sistemin e administrimit të

cilësisë të DPM-së. Është bërë përparim i vogël në përafrimin e ligjit “Për metrologjinë” dhe zbatimimi i legjislacionit sipas legjislacionit evropian. Mbetet ende pezull përafrimi me Direktivën “Për instrumentet e peshimit joautomatik dhe instrumentet e matjeve”. Pret miratim draftstrategjia e komunikimit në fushën e metrologjisë.

Ka pasur përparim në fushën e **mbikëqyrjes së tregut**. Ligji i dhjetorit të 2011-ës “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimore” synon përafrim më të gjerë të legjislacionit shqiptar me legjislacionin evropian. Megjithatë, nuk është ngritur ende inspektorati i planifikuar për mbikëqyrjen e tregut.

Ka pasur përparim të kufizuar në **legjislacionin e produkteve të “Përqasjes së Vjetër”**. Qeveria ka miratuar një rregullore teknike mbi emërtimin e pluhurave larës dhe disa rregullore rreth farmaceutikës.

Ka pasur disa përparime në **legjislacionin e produkteve të “Përqasjes së Re dhe Globale”**. Janë miratuar rregullore teknike në fushën e emetimit të zhurmave nga pajisjet e jashtme duke synuar përafrimin e legjislacionit me *acquis*.

Nuk ka pasur përparim në fushën e **masave procedurale**. Nuk është miratuar ende legjislacioni i hartuar për t'u përafuar me atë evropian për kthimin e objekteve kulturore. Nuk ka pasur zhvillim në përafrimin legjislativ për armët e zjarrit për përdorim civil.

Përfundim

Ka pasur përparim në fushën e lëvizjes së mallrave, veçanërisht për sa i përket standardizimit. Nevojiten përpjekje të mëtejshme në përafrimin e përgjithshëm të legjislacionit dhe në krijimin e një inspektorati kompetent për mbikëqyrjen e tregut. *Në tërësi*, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

4.2. Kapitulli 2: Liria e lëvizjes e punëtorëve

Nuk ka pasur zhvillim në **aksesimin e tregut të punës**. Presin miratim ndryshimet e ligjit “Për të huajt”, duke synuar garantimin për qytetarët e BE-së të aksesit në tregun shqiptar të punës pa pasur detyrimin e pajisjes më leje pune.

Ka pasur disa përparime në përgatitjet për pjesëmarrjen në rrjetin **EURES** (Shërbimi Evropian i Punësimit). Shërbimi Kombëtar i Punësimit ka nisur një program për kompjuterizimin e të gjitha zyrave të punësimit, duke synuar bërjen e sistemit në përputhje me standardet e rrjetit EURES.

Ka pasur pak përparim për sa i përket **koordinimit të sistemeve të sigurimeve shoqërore**. Është firmosur një marrëveshje e sigurisë sociale me Belgjikën. Kanë vazhduar negociatat me Hungarinë dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe kanë filluar ato me Republikën Çeke dhe Rumaninë.

Nuk ka zhvillime për sa i përket **Kartës Europiane të Sigurimeve Shëndetësore**.

Përfundim

Ka pasur përparim të pakët në fushën e lirisë së lëvizjes të punëtorëve. Janë bërë disa përgatitje rreth pjesëmarrjes së ardhshme në EURES dhe koordinimit të sistemeve të sigurisë sociale. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përafuar legjislacionin lidhur me aksesin në tregun e punës me atë evropian. *Në tërësi*, përgatitjet në këtë fushë nuk janë shumë të avancuara.

4.3. Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime

Nuk ka pasur përparim të mëtejshëm në fushën e të **drejtës së vendosjes**. Përgatitjet për lehtësimin e procedurave dhe uljen e procesit të lejeve të ndërtimit janë në një fazë fillestare.

Ka pasur përparim të kufizuar me krijimin e një plani veprimi për përputhjen e Direktivës së Shërbimeve në fushën e lirisë të ofrimit të shërbimeve ndërkufitare. Nuk ka pasur përparim në drejtim të miratimit të kuadrit institucional dhe zhvillimit të kapaciteteve të mjaftueshme me institucionet përkatëse.

Nuk ka pasur përparim në fushën e shërbimeve postare me miratimin e Strategjisë Kombëtare të Postës apo me përcaktimin e tarifave dhe peshave për shërbime të veçanta për operatorin publik të postës. Gjithashtu nuk ka një ndarje të funksioneve rregullatore nga kontrolli i politikëbërjes dhe ushtrimit të pronësisë në sektorin postar. Struktura e re organizative e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) pret miratimin nga Parlamenti i Shqipërisë.

Ka pasur disa përparime drejt njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale. Janë përparuar përgatitjet për rregullimin e urdhrat profesional për inxhinierët dhe arkitektët. Legjislacioni në zbatim të ligjit “Për profesionet e rregulluara” u aprovua në vjeshtën e vitit 2011, me qëllim rregullimin e procedurave për provimet shtetërore për profesionistët vendas. Është shkurtuar koha e përpunimit të aplikimeve për njohjen e diplomave akademike dhe profesionale të lëshuara nga institucione përkatëse të huaja. Është ecur përpara me përgatitjet e futjes së aplikimit *online* për këto njohje.

Përfundim

Ka pasur disa përparime në fushën e vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime, veçanërisht në drejtim të njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale. Megjithatë, përgatitjet për përafrimin me direktivën “Për shërbimet” janë ende në një fazë të hershme. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për përafrimin e legjislacionit postar me atë europian. *Në tërësi*, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

4.4. Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit

Në fushën e **lëvizjes së kapitalit dhe sistemit të pagesave** nuk raportohet përparim i mëtejshëm. Shqipëria ka legjislacion relativisht liberal për investimet; megjithatë, ka ende kufizime për blerjen e pronës së paluajtshme nga të huajt. Nevojiten më tepër përpjekje për të forcuar koordinimin ndërinstitucional për të promovuar dhe zbatuar ligjin “Për investimet e huaja” në praktikë.

Ka pasur pak përparim në përafrimin e legjislacionit në fushën e **sistemeve të pagesave**. Mbetet ende pezull miratimi i ligjit “Për sistemet e pagesave” në Parlament. Ka pasur përparim në përmirësimin e legjislacionit bankar. Ligji “Për bankat” u ndryshua në nëntor të 2011-ës me qëllim reflektimin e zhvillimeve në tregjet financiare dhe administrimin e rreziqeve të sistemit. Këto ndryshime hoqën ekskluzivitetin e bankave për pagesën elektronike, duke lejuar edhe institucione të tjera pagesash që të ushtrorjnë këtë aktivitet. Gjithashtu, bankave iu dha e drejta të hapin degë dhe agjenci brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe për të ofruar pagesa ndërkufitare.

Për sa i përket pagesave elektronike, volumi i kryer përmes Sistemit Shqiptar të Pagesave Ndërbankare u ul krahasuar me vitin 2010, por u rrit volumi dhe vlera e transaksioneve, veçanërisht në shtatë muajt e parë të vitit 2012. Është rritur volumi i pagesave dhe transaksioneve të kaluara përmes sistemit të klerimit të pagesave (AECH). Megjithatë ekonomia shqiptare bazohet ende në transaksionet me para në dorë.

Është bërë përparim në **luftën kundër pastrimit të parasë**. Në mars u ndryshua Kodi Penal duke reflektuar rekomandimet e Komitetit MONEYVAL. Legjislacioni i ri krijon ndarjen e krimit të pastrimit të parasë nga vepra penale kryesore. Ndryshimet e ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave” u bënë në qershor me qëllim përmirësimin e kontrollit të transaksioneve të dyshimta bankare brenda dhe jashtë vendit. Shqipëria ka miratuar disa udhëzime dhe akte nënligjore lidhur me pastrimin e parave. Është përmirësuar raportimi elektronik përmes trajnimeve të organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave. Modulet relevante u pasuruan me opsione për garantimin e integritetit të të dhënave, gjë e cila është e rëndësishme për përmbushjen e funksionit bazë të Njesisë së Inteligjencës Financiare.

Ka pasur rritje të dukshme në raportimin e transaksioneve të dyshimta nga 211 raste në vitin 2010 në 383 të tillë në vitin 2011. Gjatë periudhës së raportimit ka pasur 271 raportime të transaksioneve të dyshimta. Zyrat e këmbimit valutor, ekspertët kontabël dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme kanë raportuar për transaksione të dyshimta për herë të parë në vitin 2011. Është rritur numri i hetimeve të pasurive, vijuar me një rritje të numrit të rasteve të dërguara në gjykatë për qëllime sekuestrimi dhe të konfiskimeve me urdhër gjykate. Megjithatë, numri i dënimeve për pastrim parash mbetet shumë i ulët. (*Shih Kapitullin 24 - Drejtësia, liria dhe siguria*).

Përfundim

Ka pasur përparim për sa i përket masave legjislative në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit me ndryshimet në Kodin Penal, ligjin “Për bankat” dhe ligjin “Për parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit”. Nevojiten përpjekje të mëtejshme drejt përafrimit të ligjit “Për sistemet e pagesave” me atë europian. *Në tërësi*, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

4.5. Kapitulli 5: Prokurimi publik

Nuk raportohen zhvillime në lidhje me **parimet e përgjithshme**.

Ka pasur pak përparim në fushën e **dhënies së kontratave publike**. Raporti i kontratave direkte me negociatat konkurruese ka pasur rënie në vitin 2011, por sërish mbetet i lartë. Nevojiten përpjekje të mëtejshme veçanërisht në përmirësimin e transparencës së termave të referencës dhe përzgjedhjen e procedurave, dhe sigurimin e publikimit të njoftimeve për tenderët në kohë reale. Shqipëria ka një sistem të avancuar të prokurimit elektronik por mbetet sërish vend për përmirësim. Dispozitat për koncesionet e punës dhe shërbimit nuk janë të përafuara me legjislacionin europian. Mbetet ende pezull miratimi i një ligji të ri për koncesionet, dhe përgatitjet relevante janë ende mbrapa. Shqipëria nuk ka një legjislacion specifik për partneritetin publik privat.

Nuk është miratuar ende legjislacioni për zbatimin e ligjit “Për prokurimin publik”. U rrit kapaciteti administrativ i Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) por ende nuk është në proporcion me detyrat dhe numrin në rritje të ankesave. Në muajin mars, Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) u kalua në varësi të Kryeministrit. Mbeten për t’u vlerësuar pasojat e pavarësisë operationale.

Nuk është krijuar ende një ndarje e qartë e roleve mes APP-së, KPP-së dhe Avokatit të Prokurimit Publik (APP). Ky problem sistematik ka rezultuar në dublikimin e funksioneve dhe në problematikë në rastet e adresimit të ankesave dhe monitorimit të zbatimit të prokurimit publik dhe kontratave të koncesionit. Nuk respektohet gjithmonë përgjegjësia e APP-së për iniciativat ligjore.

APP-ja ka organizuar aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit dhe trajnime kryesisht në dialogun konkurrues, marrëveshjet kuadër, nënkontraktimet, prokurimin e përqendruar, masat dhe procedurat e rishikimit, koncesionet dhe partneritetin publik privat. Në janar të 2012-ës u përgatit i Plani Kombëtar i Trajnimit dhe

Strategjia e Komunikimit në fushën e Prokurimit Publik. Mund të raportohet përparim në fushën e **masave korigjuese**. Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e KPP-së u ndryshua në muajin shkurt për të shmangur konfliktin e interesit dhe për të rregulluar procedurat e adresimit të ankesave për veprimet publike në përputhje me rregulloren e prokurimit publik.

Përfundim

Ka pasur pak përparim në fushën e prokurimit publik, veçanërisht për sa i përket përafrimit të kuadrit ligjor të prokurimit publik dhe koncesioneve me atë europian. Ndarja e përgjegjësiave mes të gjitha institucioneve publike të prokurimit publik mbetet e përcaktuar në nivel të ulët, dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar kapacitetin dhe pavarësinë e tyre administrative. *Në tërësi*, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

4.6. Kapitulli 6: E drejta e shoqërive tregtare

Ka pasur përparim në fushën e **së drejtës të shoqërive tregtare**. Përafrimi i legjislacionit me atë europian për rregullimin e kërkesave minimale kapitale për kompanitë shtetërore me përgjegjësi të kufizuar ka ecur përpara me miratimin e ndryshimeve në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” në tetor të 2011-ës. Kodi për Qeverisjen Korporative hyri në fuqi në janar të 2012-ës për t’u zbatuar nga shoqëritë tregtare në bazë të vullnetit. Janë në ecuri përgatitjet për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë europian në fushën e bashkimit ndërkufitar. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për sa i përket raportimit dhe kriterëve të dokumentimit në rastet e bashkimeve dhe ndarjeve.

Nuk raportohen zhvillime të veçanta për sa i përket prezantimit të **firmës elektronike**. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të ngritur infrastrukturën e nevojshme teknike.

Ka pasur përparim të vogël në fushën e **kontabilitetit**. Në janar të 2012-ës, ndryshimet e bëra për Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar u miratuan si standarde kombëtare nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK). Megjithatë, nuk raportohet përparim në përafrimin me Direktivën e Katërt dhe atë të Shtatë mbi të Drejtën e Shoqërive Tregtare. Nuk ka përparim në rritjen e kapaciteteve të KKSHEK-së.

Ka pasur pak përparim në fushën e **auditimit**. Janë miratuar rregulloret mbi hetimet dhe disiplinën dhe mbi cilësinë e kontrollit të auditorëve ligjorë, por legjislacioni në tërësi nuk është plotësisht i përafruar me atë europian. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të forcuar burimet njerëzore dhe financiare të Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) dhe për të siguruar pavarësinë e tij.

Përfundim

Është bërë përparim në lidhje me të drejtën e shoqërive tregtare. Shqipëria miratoi Kodin për Qeverisjen Korporative, duke e përafruar më tej legjislacionin e saj me *acquis*. Nevojitet të bëhen të tjera përpjekje legjislative mbi raportimin dhe dokumentimin e kërkesave në rastet e bashkimit dhe ndarjes si dhe të kontabilitetit dhe auditimit. *Në tërësi*, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

4.7. Kapitulli 7: Legjislacioni për pronësinë intelektuale

Nuk është bërë përparim në fushën e **së drejtës së autorit dhe të drejtave që lidhen me të**, për përafrimin me *acquis*. Ligji i ri “Për të drejtën e autorit” nuk është miratuar ende.

Raportohet pak përparim në fushën e të drejtave të pronësisë industriale. Në shtator të 2011-ës, Rregullorja e Patentave, u ndryshua me qëllim unifikimin e disa procedurave kombëtare me procedurat e Zyrës Europiane të Patentave dhe Traktatin e së drejtës së Patentave.

Ka pasur përparim të kufizuar lidhur me zbatimin. Në mars të 2012-ës Shqipëria ndryshoi dispozitat e Kodit Penal mbi shkeljen e të drejtave të pronësisë industriale, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga Marrëveshja TRIPS. Megjithatë, Kodi Penal i ndryshuar, nuk mbulon shkeljet e së drejtës së autorit. Kjo përfshihet në ligjin e ri “Për të drejtën e autorit” i cili pritet të miratohet. Numri i procedimeve penale të paraqitura në gjykatë kundër përdoruesve të paautorizuar të pronësisë artistike, është rritur. Ende duhen bërë përpjekje të mëtejshme, për të siguruar zbatim të efektshëm të Strategjisë Kombëtare për Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (DPI) dhe industriale, duke përfshirë rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional. Në vitin 2011, është zhvilluar vetëm një takim ndërministror, për monitorimin e zbatimit të Strategjisë. Në maj të 2012-ës është zhvilluar takimi i dytë.

Në shkurt të 2012-ës, Autoriteti i Konkurrencës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave nënshkruan një memorandum mirëkuptimi, duke synuar forcimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale. DPPM-ja ka nënshkruar gjithashtu një memorandum mirëkuptimi me Zyrën e Pronësisë Intelektuale të Kosovës. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave miratoi një manual mbi statistikën për produktet e falsifikuara dhe disa formate standarde relevante njoftimi. Sistemi i informatikës në DPPM është përmirësuar me pajisje të reja dhe version të modernizuar të Sistemit për Administrimin e Pronësisë Industriale. Sidoqoftë, përpjekje të tjera duhen bërë për përmirësimin e shërbimeve *online* dhe për rritjen e numrit të personelit në DPPM. Ristrukturimi dhe përforsimi i Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA) është ende i diskutueshëm, duke mbajtur pezull miratimin e ligjit “Për të drejtën e autorit”. Ende nuk është themeluar një inspektorat që mbulon zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

ZSHDA-ja ka vazhduar me kryerjen e aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit mbi zbatimin e së drejtës së autorit dhe ka mundësuar trajnimin e gjyqtarëve nga Shkolla e Magjistraturës dhe gjykatat e rrethit. Gjithsesi, niveli i njohurive dhe ndërgjegjësimit për të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të, veçanërisht për sistemin e administrimit kolektiv, mbetet i ulët. Gjyqësorit i mungon përvoja dhe kualifikimi i përshtatshëm. Në tërësi, mbeten mangësi të mëdha, sikurse pamjaftueshmëria e kapacitetit administrativ, niveli i ulët i mbledhjes së gjobave, ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm publik dhe zbatueshmëria në përgjithësi.

Përfundime

Përparimi në fushën e legjislacionit për pronësinë intelektuale, ka qenë i kufizuar. Ende kërkohet të bëhen përpjekje të rëndësishme për të adresuar mangësitë ekzistuese, në zbatueshmërinë efektive të të drejtave për pronësinë intelektuale dhe industriale, të cilat cenojnë angazhimet e Shqipërisë të përcaktuara në MSA. Në tërësi, përgatitjet nuk janë shumë të avancuara.

4.8. Kapitulli 8: Politika e konkurrencës

Janë bërë përparime në fushën **antikartel dhe bashkimet**. Miratimi i Rregullores “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël” në muajin nëntor e afroi më shumë legjislacionin me *acquis*. Autoriteti i Konkurrencës (AK) miratoi gjashtë vendime për marrëveshjet antikonkurrese (kartelet) dhe dy vendime për abuzimin me pozitën dominuese. Dhjetë bashkimet e propozuara i autorizoi pa kushte. Për më tepër, AK-ja ka lëshuar tri rekomandime për institucionet e tjera qeveritare. AK-ja i ka lëshuar rekomandim Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) lidhur me një shkrirje mes dy operatorëve të telekomunikacioneve me përgjigje pozitive të AKEP-it. Rekomandimi i AK-së për Bankën e Shqipërisë (BSH) për rritjen e transparencës lidhur me

aksesueshmërinë e qytetarëve për të marrë informacion mbi normat e interesit bankar u realizua përmes publikimit të tyre *online*. Qeveria nuk ka ndjekur ende rekomandimin e AK-së për të krijuar institucionin e Avokatit të Bankës.

AK-ja përfundoi hetimet në tregjet e bukës dhe të shërbimeve të sigurisë dhe vuri gjoba për caktimin e paligjshëm të çmimeve. Pas hetimit të shërbimeve telefonike fikse të furnizimit me karta të parapaguara, AK-ja ka bërë rekomandime specifike. Autoriteti i Konkurrencës nisi gjithashtu hetimet paraprake për abuzimet e mundshme të pozitive dominuese të tregut në një varg sektorësh: në sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike për palën e tretë; shërbimet ndërkombëtare portuale; ngarkim/shkarkimin e depozitave të gazit të lëngshëm natyror dhe naftës; tregun e importit për sheqerin dhe orizin, tregun e prodhimit të vajit vegjtal; dhe tregun e importit të prodhimit dhe tregtimit me shumicë të çimentos.

AK-ja vazhdoi me mbështetjen dhe aktivitetet sensibilizuese publike. Ka pasur përparime për sa i përket kapaciteteve administrative të AK-së. Numri i përgjithshëm i personelit është rritur me një ekspert ligjor dhe po vazhdon me rekrutimin e ekspertit të TI-së dhe teknikës hetimore, ndërsa dy poste administrative u konvertuan në poste teknike, në përputhje me strukturën e re të AK-së, miratuar në janar. Trajnimi ndihmoi për të forcuar kapacitetet hetimore.

Janë bërë disa përparime në fushën e **ndihmës shtetërore**. Komisioni i Ndhmës Shtetërore (KNSH) autorizoi katër skema të reja të ndihmës shtetërore, që lidhen kryesisht me promovimin e punësimit. Veç kësaj, KNSH-ja nisi hetimin *ex officio* brenda një skeme të ndihmës potenciale të shtetit nga ana e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për të cilën ajo i dha një opinion negativ. Numri i njoftimeve mbetet shumë i ulët, duke treguar se jo të gjitha skemat që njoftohen në KNSH para miratimit, bëhen siç kërkohet sipas ligjit të ndihmës shtetërore.

Harta rajonale e ndihmës shtetërore është miratuar nga KNSH-ja, bazuar në ndarjen NUTS II të vendit dhe është në përputhje me *acquis*. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për të përfunduar rishikimin e plotë të kuadrit të përgjithshëm ligjor për kontrollin e ndihmës shtetërore për ta sjellë atë në përputhje me *acquis*.

Nuk janë bërë përparime për sa i përket **kapaciteteve administrative të Sektorit të Ndhmës Shtetërore** (SNSH), i cili gjithashtu shërben si Sekretariat i KNSH-së. Numri aktual i stafit të tij (katër) është krejtësisht i papërshtatshëm. Pavarësia operationale e KNSH-së dhe SNSH-së duhet ende të konfirmohet. SNSH-ja ka zhvilluar disa programe trajnimi për stafin e tij dhe ka kryer një fushatë sensibilizuese.

Përfundim

Shqipëria ka bërë disa përparime në fushën e konkurrencës. Harmonizimi i legjislacionit me *acquis* për kontrollin antikartel dhe bashkimet ka përparuar, dhe harta rajonale e ndihmës shtetërore është miratuar. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të ruajtur kapacitetet administrative dhe për të garantuar pavarësinë operationale të Komisionit të Ndhmës Shtetërore dhe të Autoriteteve të Konkurrencës. Në tërësi, përgatitjet janë në rrugën e duhur.

4.9. Kapitulli 9: Shërbimet financiare

Janë bërë disa përparime në fushën e **bankave dhe konglomerateve financiare**. Banka e Shqipërisë (BSH) miratoi rregulloret që synojnë përafrimin e pjesshëm me *acquis* mbi procedurat për ndërhyrjen në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore; menaxhimin e riskut të kredisë, mjaftueshmërinë e kapitalit, menaxhimin e riskut të likuiditetit, si dhe krijimin, licencimin dhe funksionimin e Bankës Urë në nëntor të 2011-ës. Ligji “Për bankat” u ndryshua më tej për të përafruar legjislacionin me *acquis* (*Shih gjithashtu Kapitullin 4 - Lëvizja e lirë e kapitalit*). Ndryshimet në ligjin “Për sigurimin e depozitave” u miratuan në korrik të 2012-ës. Nuk është

raportuar ndonjë përparim për krijimin e institucionit të Ombudsmanit të Bankave, siç u rekomandua nga Autoriteti shqiptar i Konkurrencës në vitin 2011.

Departamenti i Mbikëqyrjes (DM) i BSH-së ka vazhduar rishikimin e kuadrit rregullator në përputhje me dispozitat e Bazel II dhe me synimin për përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me *acquis* në procesin e rishikimit të mbikëqyrjes dhe dhënies së informacioneve. DM-ja është në procesin e miratimit të Sistemit Europian të Vlerësimit të Riskut (RAS). Metoda e re mbulon të gjitha llojet e risqeve dhe aktualisht po testohet në të gjitha aspektet e saj. Për shkak të ristrukturimit, stafi i DM-së është ulur nga 49 punonjës në vitin e kaluar, në 43.

Mund të raportohen disa përmirësime në sektorin financiar jobankar. Legjislacioni për zbatimin e sipërmarrjeve kolektive të investimit u miratua në tetor të 2011-ës. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) rinovoi mandatet e shtatë anëtarëve të bordit dhe caktoi kryetarin e ri të bordit. AMF-së i mungojnë kapacitetet e duhura administrative dhe të mbikëqyrjes dhe stafi i saj ka mbetur i pandryshuar. Institucionet jobankare arritën në 21, pasi BSH-ja licenoi dy institucione në fushën e faktorimit (parapagimit) dhe investimit.

Në fushën e **sigurimeve dhe pensioneve të punës** mund të raportohen pak përparime. Legjislacioni për sigurimin e jetës dhe risigurimin nuk është harmonizuar me *acquis*. Tregu shqiptar i sigurimeve është akoma i kufizuar. Ai pati pak rritje deri në fund të vitit 2011, por gjatë gjysmës së parë të vitit 2012, regjistroi një tkurrje të aktivitetit. Sigurimi vullnetar është rritur sidomos gjatë gjysmës së parë të vitit 2012. AMF-ja licenoi operatorin e tretë në fushën e fondeve të pensioneve vullnetare. Deri në fund të vitit 2011, numri i kontribuesve të pensioneve vullnetare u rrit me 26% krahasuar me vitin 2010 dhe me 2.9% në tremujorin e parë të vitit 2012. Megjithatë, tregu i pensioneve private mbetet i vogël në drejtim të të dyjave, si numrit të kontribuesve ashtu dhe shumës së kontributeve.

Pas liberalizimit të sektorit të sigurimeve motorike në vitin 2011, Autoriteti shqiptar i Konkurrencës (AK) filloi në prill të 2012-ës një hetim brenda një marrëveshjeje të mundshme për një çmim fiks në këtë sektor, si dhe një inspektim në maj të 2012-ës për mënyrën se si kompanitë e sigurimeve i trajtojnë pretendimet dhe si e përdorin fondin e lompensimit. Mossigurimi i mjeteve mbetet i lartë. Progres ka pasur në përmirësimin e informacionit të dhënë nëpërmjet Qendrës së Informimit të Sigurimit të Detyrueshëm (ICCI), ndërsa sistemi *bonus malus* nuk është ende në funksionim.

Nuk ka pasur përparim **në infrastrukturën e tregut financiar**, kryesisht për shkak të faktit se ligji “Mbi sistemet e pagesave” ende nuk është miratuar.

Përparim i pakët është bërë në harmonizimin me *acquis* në lidhje **me tregjet e letrave me vlerë dhe shërbimet e investimit**. Tregu i letrave me vlerë vazhdon të dominohet nga bonot e thesarit të qeverisë dhe obligacionet afatgjata.

Në fushën e shërbimeve të investimit, në mars të 2012-ës AMF-ja miratoi legjislacionin zbatues për krijimin, llogaritjen, financimin dhe administrimin e Fondit të Kompensimit. AMF-ja gjithashtu licenoi kompaninë e parë për menaxhimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe miratoi *prospectus*-in e parë për lëshimin e bonove. Megjithatë, tregu i letrave me vlerë mbetet i ende i pazhvilluar, me asnjë shoqëri tregtare të listuar në bursë. Nuk ka pasur përparime në drejtim të miratimit të rregulloreve në përputhje me Direktivën “Prospectus”, me Direktivën “Për abuzimin me tregun” dhe me Direktivën “Për tregjet e instrumenteve financiare” (MIFID). Nuk ka pasur zhvillime në lidhje me sistemin për ankimin gjyqësor dhe nuk ka legjislacion për skemat e kompensimit të investitorit.

Përfundim

Janë bërë disa përparime në fushën e shërbimeve financiare. Legjislacioni është harmonizuar me *acquis* në fushën e bankave dhe tregu i investimeve është zhvilluar më tej. Nevojiten përpjekje të mëtejshme në lidhje me sigurimet dhe pensionet e punës, infrastrukturën e tregut financiar dhe të tregut të letrave me vlerë, të investimeve dhe shërbimeve. Kapacitetet administrative në sektorët bankarë dhe jobankarë mbeten të pamjaftueshëm. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar.

4.10. Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe media

Janë bërë disa përparime në fushën e **komunikimeve elektronike dhe teknologjive të informacionit**. Kushtet konkurruese në tregjet e telefonisë janë përmirësuar për shkak të futjes së garancive të përzgjedhjes së operatorit dhe mbartjes së numrit. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) miratoi ofertën e parë referencë të interkonjeksionit për akses të hapur në rrjetin lokal (*Local Loop Unbundling*) dhe vendosi tarifatat celulare të terminimit të thirrjeve duke zbatuar metodën e llogaritjes së kostos progresive nga lart poshtë. Është ngritur një grup pune për zbatimin e shërbimit universal.

Megjithatë, miratimi i ndryshimeve të ligjit të vitit 2008 “-të “ Për komunikimet elektronike” dhe akteve nënligjore” është ende në pritje. Projektligji “Për të drejtën e kalimit” ka qenë në pritje të miratimit në Parlament që nga viti 2010-të. Paqartësitë që dalin nga marrëveshjet aktuale “Për të drejtën e kalimit” pengojnë zhvillimin e sektorit si një i tërë.

Numri 112 i urgjencës nuk është zbatuar ende. Nuk mund të raportohet progres për liberalizimin e aksesit në spektër. Procesi i tretë i tenderimit për licencën e UMTS/3G dështoi pasi ofertat nuk arritën çmimin e vendosur. Në gusht të vitit 2012, AKEP-i njoftoi tenderin për dhënien e dy frekuencave të mbetura me çmimin më të ulët të konsiderueshëm. Struktura e re organizative e AKEP-it është në pritje të miratimit në Parlament. Kapacitetet administrative dhe burimet e AKEP-it mbeten të dobëta.

Gjatë këtij viti, shërbimi celular në Shqipëri ka treguar rritje të lartë midis vendeve të zgjerimit, me shkallën e penetrimit që arriti në 185% në fund të vitit 2011. Normat e penetrimit të telefonisë fikse dhe brezit të gjerë u rritën gjithashtu me 12% dhe 4.9% respektivisht, por janë ende të ulëta krahasuar me standardet rajonale dhe europiane.

Përparimi në fushën e **shërbimeve të shoqërisë së informacionit** ka qenë jo i njëtrajtshëm. Rrjeti i infrastrukturës GovNet është përmirësuar dhe zgjeruar më tej. Megjithatë, rrjete të ndryshme paralele janë në zhvillim e sipër, çka ngre dyshimin rreth efektivitetit të sistemit aktual. Instituti Kombëtar i Statistikave ka filluar të mbledhë informacione mbi treguesit e shoqërisë së informacionit. Posta Shqiptare ka filluar të lëshojë certifikata të kualifikuara për nënshkrimin elektronik. Përparim është bërë në ngritjen e institucioneve me krijimin e Agjencisë Kombëtare të Sigurimit Kibernetik si një ekip i ri përgjegjës për emergjencën kompjuterike.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka përmirësuar kapacitetet e saj teknike. Megjithatë, kapacitetet administrative për të zhvilluar dhe zbatuar politikën dhe legjislacionin në këtë fushë mbetet i dobët. Ligji i ndryshuar për tregtinë elektronike është ende në pritje. Rregullimi i aksesit të kushtëzuar është ende në pritje të miratimit të projektligjit “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Është përgatitur një plan i ri kombëtar me objektiva ambicioze për zhvillimin e brezit të gjerë.

Janë bërë pak përparime në fushën e **politikës audiovizive**. Diskutime dhe konsultime janë mbajtur me aktorë të ndryshëm dhe partnerët ndërkombëtarë, duke sjellë disa përmirësime të projektligjit “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, sidomos për sa i përket pavarësisë së autoritetit rregullator. Megjithatë, miratimi i këtij ligji në Parlament është vonuar dhe është ende në pritje.

Në maj të vitit 2012, qeveria miratoi strategjinë e digjitalizimit dhe planin e veprimit të bazuar në qasjen rajonale

“rajon-pas-rajoni”, por zbatimi nuk ka filluar ende. Disa frekuenca janë përdorur ilegalisht nga transmetues të lartë pa licencë. Sipas strategjisë, afati i fundit për plotësimin e kalimit digjital është muaji qershor i 2015-ës. Ky afat i ri ngre shqetësime potenciale për zbatimin në kohë të procesit të digjitalizimit.

Autoriteti Rregullator – Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) – vazhdon të mos ketë kapacitete të mjaftueshme administrative e teknike. Ekzistojnë shqetësime lidhur me pavarësinë e tij. Pavarësia editoriale e transmetuesit të shërbimit publik nuk është forcuar.

Përfundim

Janë bërë pak përparime në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medias. Ndërsa janë marrë një numër masash rregulluese prokonkurruese për komunikimet elektronike, ka ende shqetësime në lidhje me reformën e përgjithshme dhe liberalizimin e sektorit, përfshi paqartësitë ligjore, kapacitetet dhe pavarësinë e rregullatorit të telekomit. Miratimi i ligjit “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë/Shqipërisë” është vonuar më tej. Me gjithë, përparimin për sa i përket lirisë së medias, shqetësimet mbeten, veçanërisht lidhur me pavarësinë e autoritetit rregullator. Zbatimi efektiv i strategjisë së kalimit digjital duhet të sigurohet. *Në tërësi*, përgatitjet në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medias nuk kanë përparuar shumë.

4.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Ka pasur përparime në çështjet **horizontale**. Buxheti i bujqësisë në vitin 2012 kryesisht është shpërndarë në *skemat e mbështetjes së drejtpërdrejtë* të lidhura me prodhimin. Strukturat e shërbimit këshillimor kanë vazhduar të japin informacione dhe trajnime për fermerët dhe operatorët e biznesit të ushqimit në vend. Janë miratuar rregulla dhe akte të ndryshme për përmirësimin e administrimit dhe mbrojtjes së tokës. Megjithatë, ritmi i ngritjes së regjistrit funksional të tokës mbetet shumë i ngadaltë. Politika për përdorimin e tokës duhet të jetë e efektshme dhe statistikave për konvertimin e saj, degradimin dhe fragmentimin të përmirësohen. Përgatitjet për regjistrimin e tokës bujqësore janë duke vazhduar. Një test pilot është kryer në pesë rrethe. Megjithatë, regjistrimi i planifikuar fillimisht për mesin e 2012-ës është shtyrë deri në tetor të vitit 2012. Përgatitjet në fushën e çështjeve horizontale janë në një fazë të hershme. Nuk mund të raportohet progres në organizimin e tregut të përbashkët. Përgatitjet në këtë fushë nuk janë shumë të përparura .

Në fushën e zhvillimit rural, përparimi është bërë në lidhje me ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të Autoritetit Menaxhues dhe Agjencisë së Pagesave për të menaxhuar dhe kontrolluar fondet e zhvillimit rural në kuadër të Instrumentit të Paraanëtarësimit (IPARD). Një projekt paketë akreditimi i është dorëzuar Komisionit. Mirëpo, ky përparim është kthyer pjesërisht në të kundërt nga riorganizimi i ministrisë në një mënyrë të tillë që koherenca dhe funksionaliteti i Autoritetit Menaxhues dëmtohet. Kapacitetet administrative të të gjitha autoriteteve operacionale, përfshi Zyrtarin Kombëtar Autorizues, Fondin Kombëtar dhe Autoritetin e Auditimit duhet të forcohen. Pronësia e përgatitjeve për paraanëtarësimin duhet të rritet dhe, si një pjesë thelbësore e saj, të sigurohet mbajtja e stafit. Shqipëria ka nevojë të përgatitet për kuadrin e ri strategjik në fushën e bujqësisë dhe për strategjinë e ushqimit për periudhën 2014-2020. *Në tërësi*, përgatitjet në fushën e zhvillimit rural nuk kanë përparuar shumë.

Është bërë pak përparim në fushën e **politikës së cilësisë**. Ministria e Bujqësisë ka marrë propozime nga rajonet lidhur me identifikimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara si produkte me origjinë të mbrojtur. Ndryshimet e fundit në Kodin Penal përmbajnë dispozita të përgjithshme në lidhje me miratimin e sanksioneve penale për shkelje të të drejtave për treguesit gjeografikë. Përgatitjet në fushën e politikës së cilësisë janë në një fazë të hershme.

Përparimi në fushën e **bujqësisë organike** ka qenë i kufizuar. Shqipëria ka vazhduar me skemat e drejtpërdrejta të pagesave dhe trajnimet mbi prodhimin organik për fermerët e bujqësisë organike. Përgatitjet në fushën e

bujqësisë organike janë në një fazë të hershme.

Përfundim

Përparimi ka qenë jo i njëtrajtshëm në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, në veçanti në ngritjen e institucioneve të zhvillimit rural. Kërkohen përpjekje të mëtejshme në lidhje me forcimin e kapaciteteve (të aktorëve publikë dhe privatë) për zhvillimin rural, krijimin e regjistrimit të tokës dhe përcaktimin e prioritetëve strategjike për bujqësinë dhe shfrytëzimin e tokës. Pronësia e përgatitjeve për paraanëtarësim duhet të rritet si dhe të sigurohet stafi. Në tërësi, në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, Shqipëria ka filluar të adresojë prioritetet e saj.

4.12. Kapitulli 12: Politika e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare

Disa përpime vihen re në **sigurinë e përgjithshme ushqimore**. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) është krijuar dhe plotësuar me personel. Përcaktimi i kompetencave, përgjegjësive dhe komunikimit ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) dhe AKU-së duhet të qartësohet. Numri i kontrolleve zyrtare u rrit në vitin 2011, pra zbatimi i rregullave të kontrollit është përmirësuar. Edhe pse më shumë se 13.000 stabilimente ushqimore janë futur në bazën e të dhënave të AKU-së, këto të dhëna duhet të përditësohen dhe të vlerësohen, në mënyrë që të përdoren në lidhje me klasifikimin e riskut dhe kontrollet zyrtare. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ende nuk ka zhvilluar kapacitetet për vlerësimin e riskut, si dhe nuk është ngritur ende Komiteti Shkencor dhe Panelet. Rregullat mbi aktivitetet e menaxhimit të riskut nuk janë miratuar dhe procedurat zbatuese nuk janë zhvilluar. Përgatitjet në fushën e sigurisë ushqimore janë në një fazë të hershme.

Në **politikën veterinare** përpimi ka qenë i pakët. Një ligj i ri “Për veterinarinë” ka hyrë në fuqi duke ripërcaktuar kompetencat mbi shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve në shërbimin veterinar. Niveli i personelit, në veçanti në nivelin qendror, vazhdon të jetë joadekuat. Përkufizimi i detyrave, funksioneve dhe përgjegjësive të shërbimit veterinar ende mungon, duke penguar kështu menaxhimin e zgjuar të mbetjeve klinike, kafshëve të ngordhura dhe nënprodukteve të kafshëve, të cilat janë bërë çështje serioze në drejtim të bio- sigurisë.

Është përpunuar databaza e harmonizuar e kafshëve (e cila përfshin gjithashtu databazën e shëndetit të kafshëve) dhe pritet të përmirësojë regjistrimin e bagëtive të imta dhe vaksinimin e tyre kundër brucelozës. Mungesa e udhëzimeve të qarta dhe regjistrimit sistematik, raportimi dhe analizat e lëvizjeve të kafshëve mbeten një shqetësim serioz në lidhje me transmetimin e sëmundjeve dhe gjurmueshmërinë e produkteve blegtorale. Raportimi i sëmundjeve nga veterinerët lokalë dhe dorëzimi i mostrave për të kontrolluar gjendjen shëndetësore të kafshëve mbeten të pamjaftueshme. Përgatitjet në fushën e veterinarisë nuk kanë përpunuar shumë.

Përparim është bërë në fushën e **hedhjes në treg të ushqimit për kafshët dhe njerëzit dhe i nënprodukteve shtazore**. Shqipëria vazhdon përafrimin me rregulloret e BE-së për importin e ushqimit, monitorimin e substancave dhe mbetjeve në produktet shtazore, kushtet higjienike dhe kontrollet për molusqet bivalvorë dhe peshkun, si dhe kontrollin e produkteve medicinale veterinare. Ndërgjegjësimi i operatorëve të biznesit të ushqimeve me rregullat e reja higjienike është i ulët, dhe harmonizimi i ushqimit dhe stabilimenteve ushqimore me standardet e higjienës mbeten sfida. Përgatitjet në këtë fushë janë në një fazë të hershme.

Nuk mund të raportohet progres në politikën **fitosanitare**. Përgatitjet në këtë fushë nuk janë shumë të përpunuara .

Nuk mund të raportohet progres në përafrimin me *acquis* për organizmat gjenetiksht të modifikuar. Përgatitjet në këtë fushë janë ende për t'u nisur.

Përfundim

Përparimi është i kufizuar në fushat e sigurisë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare. Kërkohej përpjekje për të përmirësuar përcaktimin e kompetencave, përgjegjësitë dhe komunikimin që lidhen me menaxhimin e riskut, regjistrimin e lëvizjeve dhe kontrollin e sëmundjeve të kafshëve, si dhe përmirësimin e ushqimit dhe të stabilimenteve ushqimore. Në tërësi, përgatitjet në fushat e sigurisë ushqimore dhe politikave veterinarë dhe fitosanitare janë në një fazë të hershme.

4.13. Kapitulli 13: Peshkimi

Ligji i ri “Për peshkimin”, i cili parashtron parimet themelore për menaxhimin e aktiviteteve të peshkimit, është miratuar. Duhet të përforcohet harmonizimi i tij me *acquis*. Aktet nënligjore janë duke u përgatitur. Ndryshimet në kuadrin ligjor do të duhet të shoqërohen me rirregullimet përkatëse administrative për të shmangur fragmentimin e funksioneve, mungesën e komunikimit dhe zbatimin e pamjaftueshëm të ligjit.

Për sa i përket **menaxhimit të burimeve dhe flotës**, Shqipëria ka përmbushur detyrën 1 sipas rekomandimeve të Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun, (KPPM) dhe aktualisht është duke ndjekur rekomandimet e tij për krijimin e regjistrit të flotës së peshkimit.

Në fushën e **inspektimit dhe kontrollit** ka pasur progres të kufizuar në lidhje me kapacitetet teknike të zbatimit. Pas instalimit të Sistemit të Kontrollit Satelitor të Anijeve (SKSA), lëvizjet e anijeve monitorohen në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe në Drejtorinë e Peshkimit në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Qëndrueshmëria e SKSA-së duhet të sigurohet nëpërmjet ofrimit të burimeve adekuate financiare. Ristrukturimi i shërbimeve të inspektoratit kombëtar që përfshin shkrirjen e inspektoratit të peshkimit me inspektoratin e pyjeve dhe mjedisit nuk është shoqëruar nga ndonjë ndarje e qartë detyrash midis Drejtorisë së Peshkimit dhe Drejtorisë së Inspektimit.

Sasitë e peshkut të zënë dhe sasitë e peshkut të dorëzuar nuk janë ende të besueshme, pasi inspektorët nuk i verifikojnë sasitë e kapjes në një bazë 24/7. Të dyja si metoda e raportimit ashtu dhe të dhënat e pamjaftueshme të kapjes së peshkut i komprometojnë statistikën e Drejtorisë së Peshkimit, dhe si pasojë dhe zhvillimin e planeve të menaxhimit të besueshëm. Numri i inspektorëve nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar anët kryesore përgjatë bregdetit. Inspektimet për të luftuar peshkimin e vogël bregdetar janë të rralla dhe nuk janë të koordinuara me organet e tjera të tilla si Roja Bregdetare ose Policia Kufitare.

Në fushat e **aksioneve strukturore, ndihmës shtetërore dhe politikës së tregut**, nuk mund të raportohen zhvillime.

Për sa i përket **marrëveshjeve ndërkombëtare**, Shqipëria është anëtare e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM) dhe merr pjesë në projektin AdriaMed. Megjithatë, vendi nuk përfaqësohet rregullisht në mbledhjet e Komisionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut (ICCAT) dhe nuk ka paraqitur planin e saj të inspektimit për vitin 2012 në lidhje me Planin e Rigjenerimit për tonin e kuq. Ka pasur pak progres në këtë fushë.

Përfundim

Ka pasur përparim të kufizuar në fushën e peshkimit. Nevojitet të shtohen burimet dhe kapacitetet teknike për monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve kompetente, përfshi IMOC, si dhe për pjesëmarrje më të rregullt në ICCAT. Ndarja e detyrave të raportimit dhe komunikimit në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nuk është përcaktuar mjaftueshëm. Në tërësi, përgatitjet nuk kanë përparuar shumë.

4.14. Kapitulli 14: Politikat e transportit

Në nëntor të 2011-ës, qeveria miratoi Planin Kombëtar të Transportit (rishikimi i parë pesëvjeçar) si instrumentin kryesor për vendimmarrjen dhe planifikimin strategjik në sektorin e transportit në Shqipëri.

Në **transportin rrugor** ka pasur shumë pak përparim. Kodi Rrugor u ndryshua në dhjetor të 2011-ës duke futur dispozita të reja në trajnimin profesional dhe kualifikimet e para për shoferët e kamionëve dhe autobusëve. Janë miratuar aktet nënligjore për regjistrimin e automjeteve. Që nga shtatori i 2011-ës janë duke u lëshuar kartat e tahogرافit digjital për shoferët dhe kompanitë. Kanë filluar iniciativat e para për koncesionet e mirëmbajtjes së rrugëve për rrjetin e nivelit të lartë, me disa çështje të mbetura për mirëmbajtjen e rrugëve. Nevojitet harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit me *acquis* në fushën e lejitimit të veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor dhe aksesin në tregun e transportit rrugor. Nuk raportohen zhvillime për gatishmërinë teknike të mjeteve për qarkullim, për lejen e drejtimit dhe inspektimet e automjeteve. Nuk ka plane për të futur kufizuesit e shpejtësisë. Miratimi i standardeve të reja teknike për transportin rrugor është ende në pritje. Siguria rrugore vazhdon të përbëjë një problem të madh. Numri i të vrarëve nga aksidentet rrugore në vend mbetet jashtëzakonisht i lartë. Rregullat e sigurisë rrugore nuk janë mjaft bindëse dhe nuk zbatohen si duhet; nuk është kryer ndonjë fushatë efektive për sigurinë rrugore. Legjislacioni për mallrat e rrezikshme ende nuk është miratuar.

Përparimi ka qenë i pakët në **transportin hekurudhor**. Marrëveshja e kalimit të kufirit me Malin e Zi ka përfunduar në gusht të 2012-ës. Ligji i ri “Për hekurudhat” është ende në pritje të miratimit. Deklarata e rrjetit hekurudhor ende nuk është botuar. Burimet e caktuara për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore janë të pamjaftueshme me rrezikun e përkeqësimit të mëtejshëm të rrjetit.

Nuk raportohen përparime për sa i përket **transportit të brendshëm ujor**.

Nuk ka pasur përparime në **transportin e kombinuar**.

Në rastin e **transportit ajror**, është bërë pak përparim në përafrimin e legjislacionit me *acquis*. Ndryshimet në Kodin Ajror u miratuan në nëntor të 2011-ës. Aktet nënligjore janë miratuar me synimin për të përafruar më tej menaxhimin e trafikut ajror dhe rregulloret e sigurisë së aviacionit me *acquis*. Aktet nënligjore që synojnë përafrimin për alokimin e slotëve kanë hyrë në fuqi në shtator të vitit 2011. Ndryshimet legjislative për të rritur pavarësinë e Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë (AAC) u miratuan në nëntor të 2011-ës. Megjithatë, zbatimi i fazës së parë të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Europiane të Aviacionit mbetet i ngadaltë. Nuk ka pasur zhvillime në lidhje me përpunimin në tokë dhe tarifatat aeroportuale, të cilat mbeten të shtrenjta. Siguria e monitorimit të trafikut ajror është një arsye për t'u shqetësuar. AAC ende ka mungesë të stafit të kualifikuar dhe mbështetet kryesisht në ekspertë të jashtëm për detyrat e mbikëqyrjes së sigurisë. Kapaciteti administrativ dhe teknik në sektorin e transportit ajror mbetet i dobët.

Në **transportin detar** mund të raportohen disa përparime. Riorganizimi i Drejtorisë së Përgjithshme Detare ka përfunduar. Regjistri i anijeve dhe i sektorëve detarë është krijuar së bashku me një sektor të ri që ka të bëjë me Kontrollin Shtetëror Portual dhe Kontrollin e Flamurit. Kodi Detar u ndryshua në nëntor të 2011-ës, duke zgjeruar të drejtën për të ofruar shërbime kabotazhi për kompanitë e transportit që përdorin flamur të BE-së dhe heqjen e kërkesës që komandantët e anijeve duhet të jenë shtetas shqiptarë. Është miratuar një vendim për thjeshtësimin e raportimit të formaliteteve në transportin detar për hyrjet ose daljet në portet e Bashkimit Europian me synimin e harmonizimit me *acquis*. Shkalla e ndalimit të mjeteve të lundrimit që lundrojnë me flamur shqiptar është përmirësuar. Megjithatë, përpjekje të mëtejshme nevojiten për të forcuar Kontrollin Shtetëror Portual dhe Kontrollin e Flamurit. Shqipëria nuk ka kërkuar ende anëtarësimin në Memorandumin e Mirëkuptimit të Parisit për Kontrollin Shtetëror Portual dhe mbetet në listën e zezë të flamurit të kësaj organizate.

Nuk mund të raportohet ndonjë përparim në fushën e **navigimit satelitor**. Shqipëria nuk ka planifikuar të marrë pjesë në programin e navigimit satelitor Galileo.

Përfundim

Është bërë pak përparim në politikën e transportit, kryesisht në lidhje me kabotazhin në sektorin detar. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për përafrimin e transportit me *acquis* dhe zbatimin e legjislacionit me efikasitet. Kapacitetet administrative dhe teknike mbeten të dobëta për mjetet e ndryshme të transportit, në veçanti në lidhje me aviacionin dhe sigurinë rrugore. Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore është një shqetësim dhe ka nevojë për më shumë burime. Në tërësi, përgatitjet nuk janë të përparuara .

4.15. Kapitulli 15: Energjia

Është bërë pak përparim në lidhje me **sigurinë e furnizimit me energji**. Shqipëria ka përmirësuar kapacitetin e interkonjeksionit nëpërmjet inaugurimit të një nënstacioni të ri në Tiranë, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për të plotësuar lidhjet e interkonjeksionit me shtetet fqinje. Kapaciteti i prodhimit të energjisë elektrike është përmirësuar përmes ndërtimit dhe vënies në punë të disa hidrocentraleve të vegjël, por vendi mbetet tepër i varur nga kushtet hidrologjike. Nuk është bërë përparim në zbatimin e *acquis* në lidhje me sigurinë e furnizimit me energji elektrike në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Shqipëria, e cila nuk është e lidhur me ndonjë rrjet ndërkombëtar gazi apo naftë, nënshkroi në shtator Memorandumin me Greqinë dhe Italinë për gazsjellësin TransAdriatik (TAP), në kuadrin e Korridorit Jugor të Gazit.

Ka pasur disa përparime në drejtim të zbatimit të detyrimit ligjor për të mbajtur një rezervë naftë të emergjencës për 90 ditë. Janë vënë sanksione për aktivitetin e kompanive që nuk përmbushin detyrimet e tyre. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të forcuar kapacitetet teknike dhe zbatimin në mënyrë që të sigurohet që legjislacioni është zbatuar plotësisht.

Është bërë pak përparim në **tregun e brendshëm të energjisë**. Kufizimet për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit janë hequr zyrtarisht. Që prej shkurtit të vitit 2012 janë mbajtur ankande të hapura ndaj palëve të treta. Qeveria ka vazhduar të japë leje koncesionare për ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël. Megjithatë, numri i operatorëve mbetet i kufizuar për shkak të boshllëqeve legjislative që pengojnë ekzekutimin e kontratave (Shih gjithashtu Kapitullin 5 - Prokurimi Publik). Parashikohet ndërtimi i më shumë se njëqind hidrocentraleve të vegjël; nuk është bërë ndonjë vlerësim strategjik i mjedisit apo studim socio-ekonomik, deri më tani, për të vlerësuar ndikimin e tyre të përgjithshëm.

Nuk është bërë ndonjë përparim në harmonizimin e ligjit pr“Për sektorin e isenergjisës” me *acquis*. Kuadri ligjor i Shqipërisë në thelb ende nuk arrin të përmbushë detyrimet e Komunitetit të Energjisë. Shqipëria nuk ka filluar ende përafrimin e legjislacionit me paketën e tretë të BE-së për tregun e brendshëm të energjisë. Operacionet e prodhimit dhe shitjes me shumicë të kompanisë shtetërore KESH nuk janë ndarë ende. Humbjet në shpërndarje dhe në rrjet janë rritur dhe mbledhja e faturave është përkeqësuar më tej. Prodhimi i energjisë ra me 47% në 2011-ën, kryesisht për shkak të kushteve të këqija hidroenergjetike. Pavarësisht disa përmirësimeve në prodhimin e energjisë gjatë gjysmës së parë të vitit 2012, kjo situatë ka rezultuar në vështirësi financiare për KESH, që ka qenë i detyruar të kërkojë subvencione dhe hua të garantuara nga shteti. Përveç kësaj, një konflikt ndërmjet KESH-it dhe kompanisë së shpërndarjes CEZ mbi borxhin e papaguar të dyanshëm mbetet i pazgjidhur dhe mund të rrezikojë stabilitetin e sektorit të energjisë elektrike. Enti Rregullator i Energjisë (ERE) miratoi një vendim për tarifën e energjisë elektrike për vitin 2012 dhe ka zhvilluar një model të ri balancues për tregun e energjisë elektrike. Ndërsa çmimi i energjisë elektrike me shumicë është rritur ndjeshëm për shkak të importeve të larta, çmimet e rregulluara të energjisë elektrike kanë vetëm një rritje të lehtë. ERE ka ulur në mënyrë të përsëritur çmimin e rregulluar të gjenerimit të energjisë për të mënjeluar ndikimin e importeve të larta.

Monitorimi dhe zbatimimi i kompetencave nga ERE mbetet i dobët, po ashtu dhe pavarësia e tij. Nuk ka përparime substanciale në përgatitjen e akteve nënligjore në fushën e gazit, përfshi metodologjinë e tarifave.

Nuk ka pasur progres në fushën e **energjisë së rinovueshme**. Ligji “Për energjinë e rinovueshme” mbetet për t’u miratuar. Përpjekje të konsiderueshme nevojiten për të rritur përdorimin e potencialit të konsiderueshëm të Shqipërisë për energjinë e rinovueshme, për të miratuar Planin e Veprimit Kombëtar të Energjisë së Rinovueshme dhe për të arritur objektivin në vitin 2020. Mbeten ende barriera administrative për sa i përket licencimit dhe autorizimit të investimeve të energjisë së rinovueshme si dhe lidhjeve të prodhuesve të energjisë së rinovueshme me rrjetin.

Nuk ka pasur përparime në fushën e **eficencës së energjisë**. Ligji i ri “Për eficientësinë e energjisë” mbetet për t’u miratuar. Përpjekje të konsiderueshme duhen bërë për përgatitjen e akteve nënligjore dhe për zbatimin e Planit të Veprimit Kombëtar të Eficencës së Energjisë për periudhën 2011-2018.

Shumë pak progres është bërë në fushën e **energjisë bërthamore, sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimet**. Në këtë fushë Shqipërisë ende i mungon korniza e përshtatshme ligjore dhe kapacitetet administrative. Shqipëria miratoi legjislacionin bazë për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese. Në maj të 2012-ës u miratua rregullorja “Për sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve që shkaktohen nga burimet e rrezatimeve jonizuese.” Megjithatë, duhen përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin me *acquis* dhe për të garantuar sigurinë bërthamore dhe menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive, mospërhapjen e shpejtë dhe mbrojtjen nga rrezatimi.

Përfundim

Është bërë pak përparim në sektorin e energjisë. Mungesa e diversifikimit pengon sigurinë e furnizimit me energji elektrike. Reformat e tregut të energjisë kërkojnë përpjekje të konsiderueshme për të siguruar qëndrueshmërinë e sektorit. Kapacitetet administrative dhe pavarësia e Entit Rregullator të Energjisë kërkojnë forcim të mëtejshëm. Në tërësi, përgatitjet nuk janë përparuar shumë.

4.16. Kapitulli 16: Tatimet

Ka pasur disa përparime në fushën e **tatimit të tërthortë**. Procedurat e rimbursimit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) treguan disa përmirësime në lidhje me shumën e rimbursuar. Megjithatë, vonesat në rimbursimin e TVSH-së vazhdojnë dhe projektligji i ri “Për TVSH-në” që synon përafrimin e mëtejshëm me *acquis* është ende në pritje të miratimit. Përdorimi i pajisjeve fiskale (kasave) nga bizneset është rritur, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për të forcuar zbatimin e legjislacionit dhe për të zvogëluar evazionin fiskal.

Ligji i ri “Për akcizat”, i cili hyri në fuqi, më 1 tetor të 2012-ës, e sjell legjislacionin shqiptar me afër *acquis*. Megjithatë, struktura dhe normat e akcizës nuk janë ende në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së. Përgjegjësia për mbledhjen e akcizës është transferuar nga administrata tatimore tek administrata doganore që nga data 1 korrik e vitit 2012. Janë miratuar aktet nënligjore për përdorimin e pullave të reja fiskale që nga 1 mars i vitit 2012.

Është bërë përparim i pakët në fushën e **tatimit të drejtpërdrejtë**. Pragu për deklaratat e të ardhurave personale është rritur në rreth 14.000 €. Deklaratat mbi të ardhurat personale kanë filluar të aplikohen për herë të parë në vitin 2012. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të siguruar kapacitetin teknik dhe analitik të duhur për menaxhimin e procesit të deklarimit të të ardhurave personale. Projektaktet që synojnë harmonizimin me *acquis* për bashkimet dhe kursimet është në pritje të miratimit.

Përparim të kufizuar ka pasur për sa i përket **bashkëpunimit administrativ dhe asistencës së ndërsjellë**.

Është nënshkruar marrëveshja me Irlandën për të shmangur taksimin e dyfishtë lidhur me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin dhe për të parandaluar evazionin fiskal, e cila hyri në fuqi në janar të 2012-ës.

Ka pasur disa përparime në fushën e **kapaciteteve operacionale dhe të kompjuterizimit**. Avokati i Tatimpaguesve ka vazhduar në mënyrë aktive të adresojë ankesat e tatimpaguesve, por kapacitetet administrative dhe pavarësia e tij operacionale mbeten të dobëta. Në dhjetor të 2011-ës qeveria miratoi strukturën e Akademisë së Tatimeve dhe Doganave, por Akademia nuk është ende funksionale. Është miratuar një strategji për trajnimin e stafit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor. Zyrtarët e tatimeve janë trajnuar për mbledhjen e informacionit dhe hetimin e evazionit fiskal dhe kanë bërë përparim në ushtrimin e kompetencave të tyre gjyqësore. Numri i rasteve të evazionit tatimor, të cilat janë identifikuar dhe raportuar nga zZyrtat Rajonale Tatimore në Drejtorinë e Hetimit Tatimor është rritur dhe rastet e tjera të veprave penale të mundshme janë referuar në prokuroritë e rretheve.

Konsultimet me bizneset dhe shoqërinë civile janë zhvilluar përmes Këshillit Konsultativ të Biznesit dhe Këshillit Tatimor kur hartoheshin ligjet mbi TVSH-në dhe Akcizën. Megjithatë, niveli i pjesëmarrjes së bizneseve në hartimin e politikave dhe legjislacionit mbetet i ulët.

Janë marrë masa për të forcuar kontrollin e brendshëm dhe për të luftuar korrupsionin në administratën tatimore. Janë përcaktuar praktikat e auditimit të performancës dhe treguesit e monitorimit; janë përgatitur manualët për auditimin e brendshëm dhe stafi ka bërë trajnime për Kodin e Etikës. Megjithatë, korrupsioni në administratën tatimore mbetet shkak për shqetësim.

Për sa i përket kompjuterizimit, është prezantuar një sistem elektronik për paraqitjen e pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe është zhvilluar një program i ri për regjistrimin e mbledhjes së të ardhurave. Megjithatë, sistemi TI nuk është i përshtatshëm për nevojat e DPT-së. Pagesa elektronike e tatimeve mbetet e pazhvilluar për shkak të faciliteteve të kufizuara të ofruara nga bankat tregtare dhe operatorët telefonike.

Përfundim

Ka pasur disa përparime në fushën e tatimeve. Legjislacioni për tatimin e tërthortë është përafëruar më tej me *acquis* dhe kapacitetet e administratës tatimore për hetimin dhe auditimin e brendshëm janë forcuar. Nevojiten përpjekje të mëtejshme në fushat e tatimit të drejtpërdrejt, mbledhjen e taksave, rimbursimin e TVSH-së dhe TI. Në tërësi, përgatitjet janë mesatarisht të përparura.

4.17. Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare

Nuk ka pasur përparim në përafrimin e kuadrit ligjor shqiptar me *acquis* për **politikën monetare**. Ligji “Për Bankën Kombëtare të Shqipërisë” nuk është miratuar dhe nuk është arritur progres në procedurat e shkarkimit të Guvernatorit, pavarësinë personale të anëtarëve të Këshillit dhe llogaridhënien e Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë ka vazhduar të monitorojë normën e inflacionit dhe ka ndërhyrë duke zvogëluar normat bazë të interesit pesë herë brenda një periudhe të shkurtër, duke e mbajtur inflacionin brenda kufirit të synuar. Politika monetare mbeti e qëndrueshme dhe stabiliteti i kursit të këmbimit u ruajt gjerësisht.

Shqipëria ka bërë përparim të pakët në përafrimin e *acquis* në fushën e **politikave ekonomike**. Programi Ekonomik dhe Fiskal (PEF) për periudhën 2012-2014 u miratua në muajin shkurt. Objektivat e tij kryesore përfshijnë stabilitetin makroekonomik dhe konsolidimin fiskal, duke ruajtur një nivel të lartë të investimeve publike dhe mbështetjen e rritjes ekonomike me synimin për të arritur përputhjen e shpejtë me nivelet e të ardhurave të BE-së. Programi është një instrument i koordinimit të politikave, i bazuar në disa strategji

afatmesme të qeverisë. Ai zbatonkërkesat e Komisionit Europian mbi formatin dhe përmbajtjen, megjithëse ka disa boshllëqe në të dhënat. Të dhënat e financave publike nuk përputhen me metodologjinë e sistemit europian të llogarive ESA95. Përpjekje të konsiderueshme të mëtejshme nevojiten për përmirësimin e statistikave dhe parashikimeve relevante të punës dhe pagave, duke adresuar lidhjen ndërmjet reformave dhe implikimeve të tyre fiskale dhe buxhetore.

PEF nuk arrin të paraqesë ndonjë strategji afatmesme dhe afatgjatë apo të përcaktojë ndikimin buxhetor të masave. Kapaciteti për formulimin e politikave ekonomike dhe koordinimin mbetet i dobët.

Përfundim

Shqipëria nuk ka bërë progres në harmonizimin legjislativ me *acquis* në fushën e politikës ekonomike dhe monetare. Pak progres është bërë në përgatitjen e dokumentit të politikave ekonomike. Nuk ka kapacitete të mjaftueshme për formulimin e politikave. Në tërësi, përgatitjet në fushën e politikës ekonomike dhe monetare ende nuk janë të mjaftueshme.

4.18. Kapitulli 18: Statistikat

Është bërë pak progres në fushën e **infrastrukturës statistikore**. Buxheti dhe stafi i Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT) është rritur, duke i paraprirë censusit të 2011-ës për popullsinë dhe banesat dhe regjistrimit të bujqësisë, i cili pritet të kryhet në vjeshtë të vitit 2012. Infrastruktura në zyrën qendrore të INSTAT-it në Tiranë është përmirësuar me krijimin e një qendre të përpunimit të të dhënave në shtator të 2011-ës. Megjithatë, zyra rajonale të INSTAT-it u mungon infrastruktura bazë dhe akses në internet.

Në mars të vitit 2012, ligji “Për statistikat” u ndryshua për të vënë INSTAT-in nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Kryeministrit. Megjithatë, ndryshimi as nuk ka adresuar çështjen e pavarësisë profesionale të INSTAT-it as nuk ka prezantuar ndonjë dispozitë në lidhje me rolin e INSTAT-it si koordinues i sistemit kombëtar të statistikave. Ligji nuk siguron përfaqësim të gjerë në Këshillin e Statistikave. Programi për statistikat zyrtare për periudhën 2012-2015, i cili duhet të planifikojë mbledhjen e të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e situatës ekonomike, sociale dhe mjedisore në Shqipëri, ende nuk është miratuar.

Janë bërë përparime të mira në lidhje me **klasifikimet dhe regjistrat**. Kodifikimi i njësive në regjistrin e bizneseve në bazë të klasifikimit NACE Rev.2 ka përfunduar dhe mbulon si ndërmarrjet ashtu dhe njësitë vendore. Cilësia e të dhënave të regjistrit të biznesit është përmirësuar duke përdorur informacionin e mbledhur në regjistrimin e ndërmarrjeve ekonomike, por cilësia e të dhënave për njësitë vendore duhet të përmirësohet. Procedura për vlerësimin e statusit të aktivitetit të ndërmarrjeve dhe njësive lokale (aktiv / jo aktiv) është shqyrtuar plotësisht, bazuar në burimet e disponueshme statistikore dhe metoda e re, e cila është në përputhje me standardet e BE-së.

Ka pasur progres në fushën e **statistikave sektoriale**. Puna është në proces për përmirësimin e llogarive kombëtare tremujore dhe llogarive rajonale të PBB-së. Raportet ose të dhënat institucionale dhe sektoriale janë në krijim e sipër. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar saktësinë dhe nivelin e detajeve me synim përafrimin me standardet e BE-së.

INSTAT ka kryer censusin e popullsisë dhe banesave në tetor të vitit 2011, duke bërë përpjekje për të përmbushur standardet ndërkombëtare. Rezultatet e para paraprake u publikuan në dhjetor të vitit 2011. Përpunimi i të dhënave është duke vazhduar. Aktivitetet përgatitore për regjistrimin e bujqësisë në 2012-ën janë në zhvillim e sipër. Korniza metodologjike për regjistrimin e bujqësisë u finalizua në bazë të një programi pilot i realizuar në dhjetor të vitit 2011. Kërkohen përpjekje të mëtejshme për të siguruar se do të kryhet me sukses.

Në fushën e statistikave të tjera sektoriale, janë bërë disa përparime në drejtim të përmirësimit të proceseve redaktuese të të dhënave dhe kriterëve të vlerësimit për statistikatat strukturore të biznesit.

Përfundim

Disa përparime janë bërë në fushën e statistikave. INSTAT-i ka kryer një census të popullsisë dhe të banesave në tetor të 2011-ës. Duhet përpjekje të konsiderueshme për përmirësimin e disa fushave të statistikave sektoriale, përfshi sigurimin e regjistrimit të ardhshëm bujqësor. Duhet të sigurohet kapaciteti administrativ dhe pavarësia e INSTAT. *Në tërësi*, përgatitjet janë mesatarisht të përparuar .

4.19. Kapitulli 19: Politika sociale dhe Punësimi

Nuk është bërë përparim në fushën e **të drejtës së punës**. Ndryshimet në Kodin e Punës, përfshi një plan të detajuar për përafrimin me *acquis* në fushën e të drejtës së punës janë në pritje të miratimit.

Është bërë pak përparim në fushën e **shëndetit dhe sigurisë në punë**. Inspektorati Shtetëror i Punës është forcuar me krijimin e Drejtorisë së re për Standardet e Inspektimit të Shërbimeve Sociale me pesë punonjës. Megjithatë, nuk është bërë përparim në drejtim të krijimit të 23 zyrave vendore të mbetura të Inspektoratit Shtetëror të Punës. Disa aksidente në punë dhe një shpërthim vdekjeprurës në tetor të vitit 2011 goditi një minierë kromi për shkak të kushteve të këqija të punës. *Në tërësi*, kushtet e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe zbatimi i legjislacionit vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme.

Është bërë pak përparim në lidhje me **dialogun social**. Është krijuar një Komision Trepalësh për mundësi të barabarta në kuadër të Këshillit Kombëtar të Punës (KKP). Kriteret e përfaqësimit për anëtarësim në KKP janë duke u diskutuar me partnerët socialë. Megjithatë, sistemi aktual i përfaqësimit në KKP nuk përputhet me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO). Sindikatat kanë shprehur shqetësim në lidhje me mosgatishmërinë e institucioneve shtetërore për të nënshkruar kontrata kolektive. Dialogu social dypalësh dhe marrëveshjet kolektive në sektorin privat mbeten të pazhvilluara.

Është bërë pak përparim në lidhje me **politikën e punësimit**. Plani i veprimit për punësimin e të rinjve është duke u zbatuar, por nuk është miratuar ende ndonjë plan veprimi për punësimin. Sa i përket situatës në tregun e punës, niveli i inaktivitetit mbetet i lartë, veçanërisht ndër gratë, ashtu si edhe shkalla e papunësisë, megjithëse ka rënë pak në vitin 2011 në 13.3%. Niveli aktual i papunësisë është i shtrembëruar edhe nga rëndësia që zë bujqësia që prodhon vetëm për nevoja ekzistenciale. Papunësia prek kryesisht të rinjtë, grupet cenueshme gjithashtu, si një trend i ri, emigrantët e kthyer. Shkalla e punësimit tregon një rritje të lehtë (me 1.6), megjithëse me një ritëm të ngadalësuar në vitin 2012. Vlerësimi i masave aktive të tregut të punës ka filluar. Masat janë marrë për të nxitur së pari punësimin e punëkërkuesve dhe punësimin e grave nga grupet e cenueshme. Megjithatë, buxheti i përgjithshëm për programet e nxitjes së punësimit në vitin 2012 është ulur me 40% krahasuar me vitin 2010, që çon në zvogëlimin e numrit të pjesëmarrësve. Në vitin 2011 përfunduan trajnimin profesional 4880 njerëz, që është 3.5% e numrit të përgjithshëm të të papunëve të regjistruar zyrtarisht. Aktualisht ekzistojnë nëntë qendra profesionale në qytetet e mëdha, plus një qendër e formimit profesional në Shqipërinë Verilindore. Janë bërë disa përpjekje për të luftuar punësimin informal, i cili vazhdon të përbëjë një pjesë të konsiderueshme të punësimit në Shqipëri. Të dhënat e Studimit të Fuqisë Punëtore të vitit 2011 priten të dalin në tetor të 2012-ës.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) është duke punuar për kompjuterizimin e të gjitha zyrave të punësimit për të krijuar bazat e të dhënave të punëkërkuesve dhe punëdhënësve. Megjithatë, nivelet e performancës dhe atraktivitetit të SHKP-së mbeten të ulëta. Kapacitetet administrative të SHKP-së në nivel kombëtar dhe lokal kërkojnë forcim të mëtejshëm.

Nuk mund të raportohet ndonjë përparim në përgatitjet për **Fondin Social European**. (Shih gjithashtu edhe Kapitullin 22 - Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore).

Në fushën e **përfshirjes sociale** është bërë pak përparim. Vlerësimi afatmesëm i zbatimit të Strategjisë për përfshirjen sociale për periudhën 2007-2013 nuk është finalizuar ende. Nuk ka të dhëna të fundit për nivelin e varfërisë. Është bërë shumë pak përparim në zbatimin e politikave që synojnë përfshirjen e romëve, pjesërisht për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe njerëzore të caktuara në nivelin e njësisive të qeverisjes vendore. Papunësia e pakicës rome, e cila ka qenë e lartë, tashmë është rritur më tej. Puna e fëmijëve prek veçanërisht pakicën rome.

Nuk është bërë përparim në lidhje me punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Ligji “Për nxitjen e punësimit” nuk është zbatuar siç duhet dhe kuota e punësimit nuk është zbatuar. Ligji kuadër “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara” është në pritje të miratimit.

Janë bërë disa përparime në fushën e **mbrojtjes sociale**. Aktet nënligjore për zbatimin e ligjit “Për asistencën dhe shërbimet sociale” u miratuan për të zgjeruar kategoritë e përzgjedhura për ndihmë ekonomike dhe për të rritur tavanin e ndihmës në përfitim të familjeve të mëdha. Ligji “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme për sigurimet shëndetësore dhe shoqërore” u ndryshua në shkurt të vitit 2012 për të iniciuar deklarin elektronik të listë-pagesave që nga korriku i vitit 2012. Në shkurt të 2012-ës, qeveria rishikoi skemën e pensioneve me synimin për të rritur efikasitetin e saj dhe për të adresuar nivelin e ulët të kontributeve private. Megjithatë, sigurimet shoqërore dhe skemat e pensioneve nuk kanë funksionuar si duhet. Pagesat e personave me aftësi të kufizuara dhe pagesat e pensioneve kanë vuajtur nga vonesat dhe ndërprerjet. Vështirësitë me kontributet dhe raportet kontribuuesi/ marrësi mbeten një shqetësim. Baza e të dhënave elektronike e pensioneve nuk ka përfunduar dhe dallimi në trajtim midis gjinive nuk është rishikuar.

Mund të raportohet përparim i moderuar në fushën e **antidiskriminimit**. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është kryesisht në linjë me *acquis*, por zbatimi i tij mbetet i pamjaftueshëm. Një plan strategjik (për periudhën 2012-2015) për zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe një plan veprimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) janë miratuar. KMD-ja është fokusuar në forcimin e kapaciteteve të tij dhe rritjen e ndërgjegjësimit. KMD-ja ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa ministri. Megjithatë, numri i rasteve të sjella në vëmendjen e Komisionerit mbetet i ulët dhe, deri tani, nuk kanë çuar në përgjithësi, në sanksione financiare kundër autorëve. Ndërgjegjësimi i përgjithshëm mbi ligjin dhe mundësitë për të apeluar në KMD mbetet i ulët.

Përparim i pakët është bërë në fushën e **mundësive të barabarta** ndërmjet grave dhe burrave. Ekziston akoma një hendek mes kuadrit ligjor dhe nivelit real të barazisë mes meshkujve dhe femrave në aspektin e punësimit, pagës, aksesit në sipërmarrje dhe në kreditë. Në korrik të 2012-ës u miratua një Vendim i Këshillit të Ministrave “Për integrimin gjinor” në programin afatmesëm të buxhetit për të gjitha ministritë e linjës. Aktivitetet sensibilizuese janë përqendruar në pjesëmarrjen politike të grave dhe kuotës gjinore, në sipërmarrje dhe luftën kundër dhunës ndaj grave. Megjithatë, gratë vazhdojnë të jenë më pak të përfaqësuara në tregun e punës, në veçanti në vendimmarrjen politike dhe ekonomike. Mungojnë burimet e mjaftueshme financiare dhe njerëzore në nivelet e qeverisjes qendrore dhe vendore që çon në zbatimin e ngadaltë të Strategjisë Kombëtare “Për barazinë gjinore”, për periudhën 2011-2015.

Përfundim

Përparimi në fushën e politikës sociale dhe punësimit ka qenë i pakët. Tregu i punës vazhdon të jetë i karakterizuar nga informaliteti i lartë, pjesëmarrja e ulët e grave, dhe papunësia relativisht e lartë e të rinjve. Përfshirja sociale e personave me aftësi të kufizuara dhe e pakicës rome mbetet e pamjaftueshme. Qëndrueshmëria e financimit duhet të adresohet për të siguruar zbatimin e suksesshëm të ndihmës sociale dhe

reformave të mbrojtjes. Zbatimi i politikave në këtë fushë vazhdon të jetë një sfidë. Në tërësi, përgatitjet në fushën e politikës sociale dhe punësimit nuk janë shumë të përparuara .

4.20. Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe politika industriale

Disa përpertime janë bërë në lidhje me **parimet e ndërmarrjeve dhe politikave industriale**. Shqipëria ka vazhduar të zbatojë aktin ligjor “Për biznesin e vogël”, veçanërisht në fushat e regjistrimit të kompanisë dhe hapjes së biznesit. Qendra Kombëtare e Regjistrimit për Biznes e ka zgjeruar mbulimin e regjistrimit elektronik. Një *one-stop shop* i ri u krijua në muajin shkurt në Tiranë për të reduktuar kohën që nevojitej për lëshimin e licencave dhe lejeve të qeverisjes vendore. Një paketë e re e reformave rregullatore u hodh në mars për të zvogëluar vonesat në regjistrimin e pronës, marrjen e lejeve të ndërtimit dhe të lidhte bizneset me rrjetin e energjisë elektrike. Megjithatë, dobësitë vazhdojnë për sa i përket sigurimit të mbështetjes për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM), politikave të inovacionit dhe standardeve mjedisore. Nuk ka pasur ndonjë përpertime lidhur me miratimin e legjislacionit “Për vlerësimin e ndikimit rregullator”.

Janë bërë disa përpertime në zbatimin e Strategjisë së Novacionit të Teknologjisë dhe Biznesit. Fondi i Inovacionit prej rreth 285.000 € është themeluar për periudhën 2011-2014. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve është pajisur me staf të plotë dhe bordi i saj ka miratuar rregulloren për zbatimin e Fondit të Inovacionit.

Është bërë pak përpertime në fushën e **instrumenteve të ndërmarrjeve dhe të politikave industriale**. Masat për lehtësimin e aksesit në financat për NVM-të kanë vazhduar nën Fondin e Garantimit të Kredive për NVM-të dhe Fondit European për Europën Juglindore. Zbatimi i skemës së mbështetjes së kredisë financuar nga qeveria italiane ka vazhduar; janë duke përfunduar përgatitjet për fazën e dytë të skemës për periudhën 2012-2014.

Shqipëria është partner i asociuar në Programin e Konkurrueshmërisë dhe Novacionit (CIP - EIP). Në mars të 2012 –ës ajo u bë gjithashtu anëtare e Rrjetit European të Ndërmarrjeve. Përgatitjet për përafrimin me direktivën për pagesat e vonuara janë në fazë të hershme.

Në fushën e **politikave sektoriale** janë bërë disa përpertime në zbatimin e rregulloreve të sektorit minerar. Qeveria ka revokuar licencat e kompanive që nuk kanë arritur të përmbushin detyrimet e tyre. Janë bërë disa përpertime në zbatimin e strategjisë së turizmit, kryesisht lidhur me diversifikimin e produktit dhe përmirësimin e aksesit në zonat turistike. Përgatitjet për hartimin e një strategjie të re për turizmin dhe rishikimin e ligjit “Për turizmin” kanë filluar.

Përfundim

Janë bërë disa përpertime në fushën e ndërmarrjeve dhe politikave industriale. Janë ndërmarrë disa masa për të lehtësuar aksesin në financimin e NVM-ve dhe për të përmirësuar kuadrin rregullator për të bërë biznes. Në tërësi, përgatitjet janë mesatarisht të përparuara .

4.21. Kapitulli 21: Rrjetet transeuropiane

Shqipëria ka bërë disa përpertime në fushën e **rrjeteve të transportit**. Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë në Memorandumin e Mirëkuptimit “Për zhvillimin e rrjetit rajonal të transportit të Europës Juglindore,” e cila u përfshi në rishikimin e Rrjetit të Transportit Trans-European (TEN -T) të propozuar nga Komisioni në tetor të vitit 2011.

Sa i përket infrastrukturës, ndërtimi i rrugës Tiranë-Elbasan dhe e një segmenti të ri në korridorin veri-jug afër

kufirit me Malin e Zi, po ecën mirë. Disa projekte infrastrukturore janë shtyrë për shkak të problemeve të shpronësimit dhe mungesës së burimeve financiare. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet vlerësimit të ndikimit të përgjithshëm në mjedis. Në shkurt të 2012-ës u shpall tenderi i koncesionit për mirëmbajtjen e autostradës Milot-Morinë. Mirëmbajtja dhe menaxhimi i infrastrukturës janë dy çështje ende për t'u adresuar. Nevojiten burime të konsiderueshme financiare për të ruajtur dhe për të përmirësuar si duhet infrastrukturën e transportit. Në lidhje me infrastrukturën hekurudhore, nuk është marrë ndonjë masë për rehabilitimin e rrjetit. Sa i përket infrastrukturës portuale, ndërtimi i terminalit të pasagjerëve në Durrës ka përfunduar në maj të vitit 2012. Puna është duke vazhduar në portin e Shëngjinit dhe kohët e fundit ka filluar edhe në Durrës dhe Sarandë. Puna e planifikuar për në Vlorë ende nuk ka filluar.

Përsa i përket **rrjeteve energjetike**, janë bërë disa përparime. Një nënstacion i ri për transmetimin e energjisë elektrike u përrua në Tiranë në nëntor të vitit 2011. Ai është një nga më të mëdhenjtë në Shqipëri dhe është pjesë e rrjetit të interkonjeksionit me Malin e Zi. Përgatitjet për përmirësimin e linjës së transmisionit 400 kV me Kosovën janë të vonuara. Përgatitjet për ndërtimin e interkonjeksionit midis Vlorës dhe Brindisit janë të ngadalta. Nuk ka zhvillime në drejtim të një strategjie për futjen e gazit natyror.

Përfundim

Janë bërë përparime në fushën e rrjeteve transevropiane. Transporti hekurudhor mbetet i pazhvilluar dhe nevojiten investimeve të konsiderueshme për të ruajtur dhe përmirësuar infrastrukturën e transportit. Për sa i përket rrjeteve energjetike, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të përfunduar linjat e interkonjeksionit të energjisë elektrike me vendet fqinje dhe për të filluar zhvillimin e një strategjie për futjen e gazit natyror. *Në tërësi*, përgatitjet nuk kanë përparuar shumë.

4.22. Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore

Për politikat rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore, *acquis* nuk kërkon transpozim në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, disa fusha të **kuadrit legjislativ** kanë ndikim në politikën rajonale. Nuk mund të raportohen zhvillime të veçanta në kuadrin legjislativ. Përgatitja e një ligji "Për zhvillimin rajonal" u braktis meqenëse masat e politikës relevante përfshihen tani në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) për periudhën 2013-2020 .

Janë bërë përparime të moderuara në **kuadrin institucional**. Paketa e akreditimit për komponentin IPA I u finalizua dhe u dërgua për vlerësim në Komisionin Europian në shkurt. Ndryshimet në bazën ligjore për vënien në punë të strukturave për zbatimin e komponentëve IPA II, III dhe IV (instrumentet pararendëse të Politikës së Kohezionit të BE-së) janë në pritje të miratimit. Zbatimi i marrëveshjeve ose programeve operationale do të duhet të nënshkruhet në mes të Zyrtarit Kombëtar të Autorizuar, kreu i strukturave operative dhe organeve, që formojnë strukturat operative për komponentët III dhe IV, sapo baza ligjore të jetë miratuar. Udhërrëfyesi kombëtar për transferimin e përgjegjësive të menaxhimit tek autoritetet kombëtare në lidhje me komponentët IPA II, III dhe IV është rishikuar. Në mënyrë që të veçojë programimin dhe funksionet e monitorimit, Ministria e Integritimit ka rishikuar strukturën e saj të brendshme organizative dhe ka krijuar një sektor monitorimi të veçantë.

Përparim modest është bërë në forcimin e **kapaciteteve administrative** të organizmave të IPA-s. Është përgatitur një plan trajnimi për stafin e njësive të IPA-s pas përfundimit të analizave të nevojave në muajin qershor të 2011-ës. Si rezultat i kësaj, trajnimi mbi planifikimin strategjik, programimin, monitorimin, prokurimin, parregullsitë, menaxhimin e riskut dhe fusha të tjera relevante është ofruar përmes asistencës teknike dhe nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike. Është rekrutuar staf shtesë në Njësinë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit (CFCU). Megjithatë, dobësitë serioze operationale në veçanti mungesa e ekspertizës dhe personelit mbeten tek ministrinë e linjës që do të përgjigjen për asistencën e IPA-s sapo

decentralizimi të jetë arritur. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme për të forcuar kapacitetet administrative adekuate në të gjitha nivelet.

Për sa i përket **programimit**, janë bërë disa përpaparime. Përgatitjet për hartimin e Strategjisë Kombëtare ër Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) për periudhën 2013-2020 filluan në muajin shkurt; miratimi i saj është planifikuar nga marsi i vitit 2013. SKZHI do të jetë një sintezë e të gjitha strategjive dhe politikave qeveritare, përfshi politikën rajonale, dhe do të udhëheqë programin buxhetor afatmesëm. Projektpogramet Operacionale të rishikuara për komponentët IPA III dhe IV u dërguan për komente në Komisionin Europian në shtator të vitit 2011. Duhet bërë forcim domethënës i kapaciteteve administrative në fushën e programimit dhe përgatitjes së projekteve. Zhvillimi i projekteve prioritare mbetet një çështje e rëndësishme.

Janë bërë përpaparime të moderuara në fushat e **monitorimit dhe vlerësimit**. Procedurat e monitorimit dhe vlerësimit janë duke u rishikuar për të reflektuar qasjen e re ndaj programimit të IPA-s. Një sektor monitorimi është themeluar në Ministrinë e Integritetit planifikuar me dy specialistë. Trajnimi mbi procedurat e monitorimit dhe vlerësimit është dhënë si pjesë e asistencës teknike.

Disa përpaparime mund të raportohen në fushën e **menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit**. Janë përgatitur manuale të brendshme për menaxhimin financiar dhe kuadrin e kontrollit të brendshëm dhe trajnimi është dhënë për menaxhimin financiar. Sistemi i kontabilitetit analitik i nevojshëm për Njësinë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit (CFCU) dhe Fondi Kombëtar për menaxhimin e transaksioneve financiare për komponentët e IPA I, II, III dhe IV është plotësisht funksional.

Përfundim

Janë bërë përpaparime në fushën e politikës rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore. Duhet përpjekje të konsiderueshme për të ngritur kapacitetet e nevojshme institucionale dhe administrative në nivel qendror dhe vendor dhe për të zhvilluar projekte prioritare të menduara mirë dhe me cilësi. Në tërësi, përgatitjet në këtë fushë janë ende në një fazë të hershme.

4.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore *(shih edhe Kriterin Politik)*

Përpaparim i moderuar është bërë në plotësimin e kuadrit ligjor “Për reformën gjyqësore”. Zbatimi i Strategjisë së Reformës Gjyqësore dhe planit relevant të veprimit ka filluar, edhe pse ngadalë. Akordimi buxhetor dhe planifikimi, niveli i burimeve njerëzore dhe bashkëpunimi ndërinstitucional mbeten fusha shqetësuese. Shqipëria duhet të përshpejtojë më tej zbatimin e Strategjisë së Reformës Gjyqësore në mënyrë që të sigurojë pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien e institucioneve të saj gjyqësore.

Grupe pune u ngritën në Ministrinë e Drejtësisë (MD) për të rishikuar legjislacionin kyç për funksionimin dhe organizimin e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), Shkollës së Magjistraturës, Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, dhe Administrimit të Gjyqësorit. Rezultatet e grupeve të punës ende kanë nevojë për t’u finalizuar. Ligji për Gjykatat Administrative, Ligji për Konferencën Gjyqësore Kombëtare, si dhe Ligji për Profesionin e Avokatit janë miratuar, si dhe ndryshimet në Kodin Penal *(shih gjithashtu politika kundër korrupsionit)*.

Janë bërë disa përpaparime në lidhje me *pavarësinë* dhe paanshmërinë e **gjyqësorit**. Në shtator është miratuar një paketë rregullash për transferimet e gjyqtarëve. Neutraliteti, efikasiteti dhe pavarësia e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese ende nuk janë të garantuara plotësisht nën kuadrin e tanishëm ligjor.

Një sistem regjistrimi audio është duke u instaluar gradualisht në gjykata, por nuk është lidhur ende me sistemin e menaxhimit të çështjes. Vendimet e gjykatave nuk publikohen në mënyrë sistematike dhe cilësia e hartimit të

vendimit mbetet e ulët.

Në lidhje me *llogaridhënien* në sistemin gjyqësor, dispozitat kushtetuese që kufizojnë imunitetin e gjyqtarëve janë miratuar. Janë ndërmarrë hapa për të adresuar mbivendosjen e kompetencave të inspektimit mes inspektorateve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) dhe Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit “Për inspektimet”, por rreziku i mbivendosjes vazhdon. Ndryshimet e ligjit “Për Këshillin e Lartë të Drejtësisë” në lidhje me inspektimet janë ende për t'u finalizuar. Vlerësimet nuk janë kryer ende me të gjithë gjyqtarët. Është bërë pak përparim në lidhje me masat garantuese të përgjegjësisë disiplinore dhe të integritetit.

Shkolla e Magjistraturës është duke ofruar kurrikula dhe trajnime me cilësi të mirë për çështjet etike dhe të tjera. Megjithatë, buxheti i saj është i pamjaftueshëm për të mbuluar aktivitetet e planifikuara.

Përparim i kufizuar është bërë në lidhje me *efikasitetin* e sistemit gjyqësor, por janë marrë disa masa për të adresuar problemin e vonësive të paarsyeshme të çështjeve gjyqësore të shkaktuara nga shtyrja e procedimeve gjyqësore. Mungesa e një kuadri të plotë ligjor në përputhje me standardet europiane, me organizim të qartë të gjykatave dhe stafit gjyqësor, pengon efikasitetin e veprimtarisë së gjykatave. Seancat dëgjimore shpesh zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve dhe kushtet e punës në gjykata mbeten joadekuate. Menaxhimi i gjykatave mbetet i dobët për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare. Akumulimi i çështjeve të prapambetura, zvarritja e procedimeve dhe numri i seancave minojnë efikasitetin e sistemit gjyqësor.

Për sa i përket ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, është krijuar sistemi i ri përmbarimor privat.

Përparim i moderuar është bërë në **politikën antikorruption**. Ka vazhduar zbatimi i Strategjisë Antikorruption dhe i masave specifike në sektorë dhe fusha të ndryshme në kuadrin e planit të veprimit për periudhën 2011-2012, edhe pse ka qenë i ngadaltë. Raportet për zbatimin e planit të veprimit nga ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera përkatëse nuk publikohen rregullisht.

Përparim i moderuar është bërë në forcimin e kuadrit ligjor. Këtu përfshihet zbatimi i rekomandimeve të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) në lidhje me inkriminimin si dhe financimin e partive politike. Janë miratuar ndryshime në ligjin “Për noterinë” që parashikojnë digjitalizimin e veprimtarisë së noterive. Përparim është bërë me miratimin e ndryshimeve kushtetuese të nevojshme për të hequr imunitetin e pakufizuar të zyrtarëve publikë të nivelit të lartë dhe gjyqtarëve.

Përparim i kufizuar është bërë në lidhje me kuadrin institucional dhe krijimin e mekanizmave specifike për të luftuar korrupsionit. Janë bërë përpjekje për të përmirësuar bashkëpunimin ndërinstitucional, pjesërisht duke ngritur dy grupe pune ndërinstitucionale për shkëmbimin e informacionit dhe standardizimin e statistikave për rastet e korrupsionit. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP) ka nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi “Për të nxitur bashkëpunimit me disa institucione”, si Kontrollin e Lartë të Shtetit, ZKKP-në, ALUIZNI-n dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Nuk ka përparime në lidhje me rolin institucional që luan Departamenti i Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorruptionit (DKBA). Kjo strukturë nuk ka mjaftueshëm pavarësi institucionale, autoritet dhe kapacitete administrative për të realizuar detyrat.

Njësitë e Përbashkëta Hetimore, edhe pse vazhdojnë të jenë instrumente të mira për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit, kanë burime njerëzore dhe pajisje teknike të pamjaftueshme, si shumica e agjencive të hetimit dhe zbatimit të ligjit. Mungesa e pajisjeve teknike për masat e hetimeve speciale pengon efektivitetin e politikave antikorruption. Departamentet e kontrollit të brendshëm nëpër ministri shpesh nuk kanë ekspertizë të specializuar dhe u mungon fokusimi i mjaftueshëm në luftën kundër korrupsionit. Niveli i bashkëpunimit ndërmjet agjencive ligjzbatuese, sidomos ndërmjet policisë dhe prokurorëve, mbetet i

pamjaftueshëm.

Hetimet proaktive bazuar në përdorimin efektiv të informacionit të shërbimeve sekrete dhe vlerësimet e riskut ende mungojnë në Shqipëri. Pak raste korrupsioni përfundojnë me dënime. Ende nuk është krijuar një vijimësi bindëse hetimesh, ndjekjesh penale dhe dënimesh në rastet e korrupsionit në të gjitha nivelet, përfshi nivelin e zyrtarëve të lartë. Statistikat penale dhe statistikat për rastet e konfliktit të interesit duhet të forcohen. Korrupsioni në gjyqësor vazhdon të jetë problem veçanërisht serioz. Korrupsioni mbetet problem veçanërisht serioz edhe në sektorët e tatim-taksave, arsimit dhe shëndetësisë.

Shqipëria ka përmirësuar më tej kuadrin ligjor dhe institucional për mbrojtjen e **të drejtave themelore**. Emërimi i Avokatit të ri të Popullit ka ndihmuar në përmirësimin e funksionimit të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut. Shumica e ankesave të pranuar nga Avokati i Popullit kanë të bëjnë me pohimet e keqtrajtimit nga policia, me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, me vonesat në procedurat gjyqësore dhe me shkeljen e të drejtës për punësim nga ana e administratës publike. Megjithatë, ka ende disa boshllëqe ligjore dhe zbatimi i akteve nënligjore dhe instrumenteve të politikave në fushën e të drejtave themelore vazhdon të jetë i ngadaltë dhe të jetë kryesisht i varur nga shoqëria civile dhe financimi i donatorëve.

Janë bërë përparime në lidhje me **parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit**. Ndjekja e rekomandimeve të Avokatit të Popullit është përmirësuar dhe Policia e Shtetit ka filluar bashkëpunimin me dy organizata joqeveritare. Një databazë e re, e njohur si ADAM, u prezantua për hartimin e të dhënave për personat e shoqëruar, arrestuar dhe të paraburgosur. Ndryshimet në manual mbi rregullat dhe trajtimin e personave të arrestuar dhe të paraburgosur në stacionet e policisë janë miratuar. Megjithatë, ende mbeten shqetësime rreth rasteve të raportuara të keqtrajtimit dhe mosrespektimit nga ana e policisë për të zbatuar në mënyrë sistematike procedurat për arrestimin dhe paraburgimin. Është planifikuar ndërtimi i një institucioni të veçantë mjekësor për trajtimin e të burgosurve të sëmurë mendorë, por do të duhet kohë deri në ngritjen e tij dhe kujdes i specializuar shtesë duhet të jepet për këtë kategori të burgosurish.

Janë bërë përparime në **sistemin e burgjeve** lidhur me trajnimet e vazhdueshme dhe përmirësimin e standardeve. Standardet e jetesës në burgje ende ndryshojnë duke u varur në sigurimin e ushqimit dhe pajisjeve nga familjet. Katër zyra të reja rajonale të Shërbimit të Provës u hapën dhe janë miratuar plane për burime shtesë. Përbën shqetësim përdorimi i tepërt i masës së paraburgimit.

Përparimi ka qenë i pakët në lidhje me **aksesin në organet e drejtësisë**. Zbatimi i ligjit “Për ndihmë juridike falas” ka qenë i ngadalshëm dhe as aktet nënligjore në lidhje me rekrutimin e avokatëve falas të ndihmës juridike, as procedurat për të kërkuar ndihmë juridike falas nuk janë zbatuar në mënyrë efektive. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike ka trajtuar vetëm një numër të kufizuar të rasteve. Aksesin në drejtësi për grupet e cenueshme pengohet, sidomos nga taksat e larta të administratës gjyqësore.

Janë bërë disa përparime në fushën e **lirisë së shprehjes** me miratimin e ndryshimeve në Kodin Penal dhe Civil duke hequr dënimin me burg për shpifjen dhe mashtrimin dhe shfuqizimin e mbrojtjes së veçantë të zyrtarëve publikë. Megjithatë, këto vepra janë ende të dënueshme me gjoja potencialisht të larta sipas Kodit Penal. Shqetësim mbetet pamjaftueshmëria në transparencën e pronësisë, përdorimi i medias për të promovuar interesat politike dhe ekonomike private dhe mungesa e përparimit në forcimin e pavarësisë editoriale të transmetuesit të shërbimit publik.

Liria e tubimit dhe organizimit është respektuar në përgjithësi. Zhvillimi i shoqërisë civile vazhdon të pengohet nga vështirësi në gjetjen e fondeve, duke përfshirë nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. Konsultimi i shoqërisë civile në procesin legjislativ nuk është sistematik. *Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe e fesë* vazhdon të respektohet.

Janë bërë disa përparime në lidhje me të **drejtat e grave dhe barazinë gjinore**. Shqipëria ka nënshkruar

Konventën e Këshillit të Europës mbi Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Gruas dhe Dhunës në Familje. Ka nisur të zbatohet strategjinë kombëtare për barazinë gjinore dhe dhunën në familje. Ndryshimet në Kodin Penal u miratuan, duke përfshirë mbrojtje të mëtejshme nga dhuna në familje dhe një strehë kombëtare për viktimat e dhunës në familje është funksionale. Koordinimi ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore mbetet i pamjaftueshëm. Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje mbetet e kufizuar.

Ka pasur përparim jo të njëtrajshëm në fushën e **të drejtave të fëmijëve**. Zbatimi i planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve për periudhën 2012-2015 është një hap pozitiv. Procesi i ngritjes së njësive vendore të mbrojtjes së fëmijëve vazhdon, megjithëse me shumë varësi në shoqërinë civile dhe donatorët për dhënien e shërbimeve. Përparimi i efektshëm në zbatim varet nga rritja e burimeve financiare dhe njerëzore dhe koordinimit ndërmjet nivelit qendror dhe vendor. Strategjia e drejtësisë për të miturit dhe plani i veprimit nuk janë miratuar. Përdorimi i tepruar i masës arrest me burg për të miturit është një shqetësim serioz.

Përparim i kufizuar është bërë në lidhje me **personat e cenueshëm nga ana sociale dhe/ose me aftësi të kufizuara**, që është pjesë e prioritetit kyç për antidiskriminimin. Puna për projektligjin vazhdon dhe do të ekzistojë statusi diferencues për disa aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me vështirësi në aksesin e arsimit, punësimit, kujdesit shëndetësor dhe shërbimet sociale.

Është bërë përparim i moderuar në fushën e **politikave të antidiskriminimit**. Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nisi një plan strategjik për periudhën 2012-15 dhe një plan veprimi për vitin 2012 dhe u përqendrua në rritjen e ndërgjegjësimit dhe krijimin e kapaciteteve. Megjithatë, ndërgjegjësimi i përgjithshëm mbi ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi mbetet i pakët dhe duhet krijuar një regjistër i rasteve të cilat kanë marrë zgjidhje përfundimtare. Është miratuar një plan masash për mosdiskriminim mbi bazë orientimi seksual dhe gjinie. Në të njëjtën kohë, vazhdon diskriminimi ndaj personave LGBT, romëve dhe grupeve të tjera të cenuara. Shqipëria nuk publikon të dhëna të mbledhura mbi krimet e urrejtjes dhe rasteve të lidhura me këto. Në periudhën e raportimit, nuk ka pasur dënime për krime të lidhura me racizmin ose ksenofobinë.

Të drejtat e punës dhe të sindikatave janë respektuar në përgjithësi dhe ka nisur një dialog në lidhje me kushtet e anëtarësisë në Këshillin Kombëtar të Punës. Mbetet për të arritur përparim mbi bisedimet kolektive në sektor privat dhe publik.

Janë bërë disa përparime në fushën e **të drejtave të pronësisë**, veçanërisht nëpërmjet miratimit të ligjit të ri “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe nëpërmjet miratimit të strategjisë ndërsektoriale dhe planit të veprimit. Nevojitet koordinim dhe monitorim efikas për të siguruar zbatimin e strategjisë dhe lidhje ndërmjet legjislacionit në fuqi dhe nismave të ardhshme. Konsultimet me grupet e interesuara në këtë drejtim duhet të vazhdojnë. Regjistri i territorit nuk është plotësuar ende. Pronarët e mëparshëm kanë ende pretendime të pazgjidhura për shpërblimin dhe rikthimin e pronave të konfiskuara nga regjimi komunist.

Edhe pse marrëdhëniet ndëretnike mbeten të mira në përgjithësi, mund të vërehet përparim shumë i kufizuar në përmirësimin e kuadrit legjislativ dhe të politikave në lidhje me **respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe kulturore**. Mandati i Komitetit Shtetëror për Mbrojtjen e Pakicave nuk është përmirësuar, dhe puna nuk ka nisur ende për hartimin e një legjislacioni gjithëpërfshirës për pakicat i rekomanduar nga Komiteti Këshillimor i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Nuk janë publikuar ende rezultatet e plota të censusit të popullsisë dhe banesave të tetorit 2011-ës që përfshiu pyetje opsionale për origjinën etnike dhe përkatësinë fetare.

Është bërë përparim shumë i kufizuar në lidhje me përfshirjen e romëve. Zbatimi i masave në këtë fushë vazhdon të jetë shumë i ngadaltë, veçanërisht për shkak të burimeve të papërshtatshme dhe koordinimit të papërshtatshëm ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore. Romët vazhdojnë të përballen me kushte jetese shumë të vështira dhe diskriminim. Ka shqetësim në lidhje me dëbimet me forcë të romëve dhe reagimin e dobët të autoriteteve për problemet e strehimit në komunitet. Vështirësitë lindin nga mungesa e statistikave zyrtare të njësuara në lidhje me popullsinë romë në Shqipëri.

Janë bërë disa përparime në fushën e **mbrojtjes së të dhënave personale**, ku ndryshimet në ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” synojnë përafrimin e mëtejshëm me *acquis* e BE-së. Zyra e Komisionerit për të Dhënat Personale nuk renditet ende ndër institucionet që duhet të konsultohen gjithmonë mbi projektpropozime legjislative. Zyra miratoi dhe zbatoi dy manualë procedurash. Ajo realizoi më shumë inspektime dhe miratoi disa udhëzime për sektorët përkatës.

Nuk ka pasur zhvillime në lidhje me të **drejtat e qytetarëve të BE-së**; pritet të miratohen ndryshimet në ligjin “Për të huajt”.

Përfundim

Në tërësi, janë bërë përpaparime në zbatimin e politikave për gjyqësorin dhe të drejtat themelore, veçanërisht nëpërmjet përpjekjeve për t'i dhënë përgjigje prioriteteve kryesore përkatëse të përcaktuara në Opinionin e Komisionit. Sidoqoftë, mbeten boshllëqe të ndjeshme në kuadrin legjislativ, në veçanti në lidhje me reformën gjyqësore. Zbatimi i vazhdueshëm i masave legjislative dhe politikave mbetet një sfidë në të gjitha fushat sipas këtij kapitulli. Harmonizimi i Shqipërisë me standardet europiane dhe *acquis* në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore nuk është shumë i përpaparuar.

4.24. Kapitulli 24 :Drejtësia, liria dhe siguria

Janë bërë disa përpaparime në fushën e politikës së **migracionit**. Është arritur përpaparim në mbledhjen dhe publikimin e informacionit analitik për migracion e ligjshëm dhe të jashtëligjshëm. Zbatimi i marrëveshjes së ripranimit ka vazhduar rrjedhshëm. Në 2011-ën u regjistruan vetëm 15 185 raste kthimi, për shkak të rënies së thellë në numrin e të kthyerve nga Greqia. Duhet të përforcohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për emigrantët e kthyer. Zbatimi i Strategjisë së re Kombëtare të Migracionit është në pritje. Përgatitjet në këtë fushë po përparojnë me moderim.

Nuk ka pasur përpaparim të ndjeshëm në fushën e **azilit**. Kuadri institucional dhe ligjor është pjesërisht i krijuar. Megjithatë, përgatitjet në këtë fushë duhet të shtohet. Deri në gusht të 2012-ës, Shqipëria u dha azil 81 individëve, me 20 kërkesa të tjera në pritje. Refugjatët dhe personat me mbrojtje plotësuese nuk janë pajisur ende me dokumente identifikimi. Duhet të sigurohet një proces kontrolli paraprak i efektshëm në kufi duke marrë parasysh tendencat e reja dhe të mundshme të migracionit dhe rritja e mundshme e tranziteve të paligjshme nga shtetasit e vendeve të treta. Përgatitjet kanë përpaparuar në masë të moderuar..

Janë bërë disa përpaparime në politikat për vizat. Është ende në pritje një ndryshim në ligjin “Për të huajt” që synon përshtatjen e marrëveshjeve të vizave me *acquis*. Zbatimi i liberalizimit të vizave përparoi rrjedhshëm në përgjithësi. Në vijim të një rritjeje në kërkesa të pabazuara azili nga shtetas shqiptarë, autoritet shqiptare reagojnë me shpejtësi dhe bashkëpunuan me Shtetet Anëtare. Duhet të vazhdojnë përpjekjet për të siguruar ndërgjegjësimin e publikut mbi të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga liberalizimi i vizave dhe për të parandaluar abuzimet. Duke filluar që nga muaji korrik i vitit 2012, Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Total (TIMS) është lidhur me bazën e të dhënave të regjistrimit civil në pikat e kalimit kufitar. Komisioni ka vazhduar monitorimin pas liberalizimit të vizave dhe paraqiti raportin monitorues të tij të tretë në Parlamentin Europian dhe Këshill në muajin gusht të 2012-ës.

Ka pasur përpaparim në fushën e kufijve të **jashtëm dhe Shengenit**. U nënshkruan një protokoll për patrullimin e përbashkët me Kosovën, një marrëveshje për krijimin e një pike të re kontrolli kufitar të përbashkët me Malin e Zi dhe një marrëveshje për shkëmbimin e informacionit me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Filluan të funksionojnë patrullat kufitare të lëvizshme, duke mbuluar kufirin e gjelbër. Është ende në fuqi ndalimi i motoskafeve. Duhet të rriten kapacitetet e vlerësimit të kërcënimeve në Policinë Kufitare dhe të Migracionit (BMP). Duhet të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi i institucioneve të përfshira në menaxhimin e kufirit blu dhe duhet të sigurohet qëndrueshmëria financiare e mekanizmave të mbikëqyrjes. Duhet të përforcohen analizat e rrezikut dhe inteligjenca në Qendrën Ndërinstitucionale të Operacioneve Detare (IMOC), duke përfshirë lidhjen e saj me sistemin e informacionit të hetimit kriminal MEMEX. Në tërësi, përgatitjet në këtë fushë kanë përpaparuar.

Ka pasur përpaparim në fushën e **bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile dhe penale**. Protokollin e Tretë Shtesë të Konventës Europiane për Ekstraditimin ka hyrë në fuqi, por nuk është zbatuar ende. Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me EULEX-in, Europol-in, Austrinë, Holandën, Rusinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Duhet të sigurohet zbatimi i rrjedhshëm i marrëveshjes së ekstraditimit me Italinë. Shqipëria miratoi një bashkëpunim me EULEX-in që lehtëson ligjin në kuadrin e hetimit për trafikimin e dyshuar të organeve njerëzore. Kanë përpaparuar përgatitjet për nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi me Eurojust-in. Në përgjithësi, ka pasur përpaparim të moderuar në këtë fushë.

Në fushën e **bashkëpunimit policor dhe luftës kundër krimit të organizuar** - një nga prioritetet kryesore të përcaktuara në Opinionin e Komisionit - raportohet se janë bërë disa përparime. Përdorimi më i shpeshtë i MEMEX-it ka përmirësuar shkëmbimin e të dhënave brenda Policisë së Shtetit të Shqipërisë (ASP). Megjithatë, kapaciteti operativ i laboratorit mjeko-ligjor, veçanërisht interpretimi i ADN-së dhe një bazë e të dhënave të ADN-së, ka nevojë për mbështetje të mëtejshme. Është marrë një vendim për të ristrukturuar shërbimet e mbrojtjes së dëshmitarit me qëllim rritjen e efektshmërisë së tyre dhe plotësimin e standardeve të BE-së. Është miratuar një plan veprimi kundër trafikut të mjeteve dhe është bërë përparim në zbulimin e mjeteve të trafikuar në kufi. Zbatimi i ligjit “ Antimafia” ka çuar në një rritje në numrin e pasurive kriminale të konfiskuara. Megjithatë, përpjekjet në këtë fushë duhet të intensifikohen ndjeshëm nëpërmjet koordinimit më të afërt ndërmjet autoriteteve të gjyqësorit dhe të zbatimit të ligjit, duke çuar në rikuperimin e efektshëm të pasurive të përfituara në mënyrë të paligjshme.

Bashkëpunimi ndërinstitucional ka përparuar në hetimet e krimit financiar dhe pastrimit të parave. Megjithatë, ka një nevojë urgjente që institucionet kryesore të shtojnë koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit dhe kështu të rritin kapacitetet e tyre për të hetuar krimin e organizuar dhe të rëndë. Trajnimi i vazhdueshëm dhe i specializuar i punonjësve të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve mbetet i nevojshëm. Janë zbatuar procedura operative standarde për menaxhimin skenat e krimeve të rënda. Vlerësimi i kërcënimeve dhe hetimet proaktive duhet të promovohen më tej. Përgatitjet për të ndërtuar një regjistër të plotë hetimesh, ndjekjesh penale dhe dënimesh në të gjitha nivelet kanë përparuar në masë të moderuar.

Është raportuar përparim në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, edhe pse Shqipëria është ende një vend burimi i trafikimit të qenieve njerëzore dhe trafikimi i brendshëm vazhdon të jetë shqetësim. Ka pasur përparim në punën e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar Antitrafik. U krijua një grup pune i përbashkët për të përmirësuar hetimet dhe procedimet gjyqësore. Janë krijuar dhe po zbatohen në mënyrë të efektshme procedurat operative standarde për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të mundshme. Është ngritur një mekanizëm i ri kombëtar referimi.

Mund të raportohet përparim në fushën e **luftës kundër pastrimit të parave**. Duke marrë parasysh rekomandimet e MONEYVAL-it, u miratuan ndryshimet e Kodit Penal duke përcaktuar ndarjen e krimit të pastrimit të parave nga vepra penale kryesore dhe krimi i vetëpastrimit. Gjithashtu, u zbatuan masat ndëshkimore për këtë krim. Ka pasur rritje në numrin e raporteve nga bankat, noterët, Zyra e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Është rritur numri i hetimeve të pasurive, të rasteve të dërguara në gjykatë për qëllime sekuestrimi dhe të konfiskimeve me urdhër gjykate. Megjithatë, numri i dënimeve për pastrim parash mbetet i ulët ndjeshëm në krahasim me shkallën e problemit. Krimet e pastrimit të parave dhe korrupsionit nuk mbulohen nga Gjykata e Krimeve të Rënda.

Për sa i përket burimeve njerëzore të Policisë së Shtetit, ka vazhduar zbatimi i strategjisë së shumëllojshmërisë. Janë bërë disa përparime në rekrutimin e punonjësve të policisë femra. Megjithatë, mbetet nevoja për të ndjekur plotësisht praktikën më të mira në lidhje me procedurat e transferimit, përzgjedhjes, emërimit dhe ngritjes në detyrë. Kontrolli i brendshëm duhet të zbatohet për t'i dhënë përgjigje korrupsionit në institucionet ligjzbatuese.

Janë bërë disa përparime në bashkëpunimin ndërkombëtar, veçanërisht nëpërmjet instalimit të linjave të sigurta të komunikimit me Europol-in dhe shkëmbimet e informacionit kanë vazhduar. Bashkëpunimi operativ me vendet fqinje, Shtetet Anëtare të BE-së dhe Europol-in duhet të rritet më tej nëpërmjet shkëmbimit të inteligjencës kriminale dhe realizimit të operacioneve të përbashkëta.

Shqipëria ka filluar të zbatojë Strategjinë Kombëtare dhe planin e veprimit të **luftës kundër terrorizmit**. Duhet të zhvillohen struktura të efektshme për të garantuar inteligjencë sigurimi me rëndësi dhe në kohën e duhur. Përgatitjet në këtë fushë kanë përparuar në masë të moderuar.

Ka pasur përparim modest në lidhje me **bashkëpunimin në luftën kundër drogës**. Në tërësi, sekuestrimet dhe ndjekjet penale janë rritur. Strategjia e re antidrogë u miratua në qershor, duke ndjekur objektivat e rritjes së koordinimit strategjik ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit dhe duke i dhënë përgjigje furnizimit, kërkesës dhe pakësimit të dëmit. Po sigurohet bashkëpunim ndërkombëtar dhe duhet të vazhdohet në të gjitha institucionet përkatëse me përqasjen e udhëhequr nga inteligjenca, si dhe me përdorimin në rritje të vlerësimit të rrezikut. U vendos një bashkëpunim i mirë ndërmjet Qendrës Monitoruese Europiane për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave dhe Zyrës Kombëtare për të Dhëna mbi Drogat të ngritur në 2011-ën. Janë shtuar operacionet e

policisë kundër kultivimit të kanabisit. Duhet të intensifikohet përparimi për sa i përket sekuestrimeve në pikat e hyrjes. Grupet e krimit të organizuar vazhdojnë të përfitojnë nga vendndodhja e Shqipërisë si një vend tranzit. Mbeten të nevojshme hetime dhe operacione më të përqendruara dhe proaktive.

Janë bërë disa përparime në fushën e **bashkëpunimit doganor**. Është vërejtur një bashkëpunim i mirë doganor ndërmjet autoriteteve doganore dhe policisë në luftën kundër trafikut të paligjshëm të mjeteve. Kjo lëvizje pozitive duhet të mbështetet nga zhvillimi i mëtejshëm i inteligjencës në këtë fushë, *shih Kapitulli 29 - Bashkimi doganor*.

Për hollësi mbi masat kundër falsifikimit të euros, *shih Kapitulli 32 - Kontrolli financiar*.

Përfundim

Shqipëria ka bërë disa përparime në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, veçanërisht në menaxhimin e kufijve, bashkëpunimin ndërkombëtar në hetime dhe luftën kundër krimit të organizuar. Përpjekjet duhet të shtohen në koordinimin ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit dhe konsolidimit të një regjistri hetimesh, ndjekjesh penale dhe dënimesh. Në tërësi, përgatitjet në këtë fushë po përparojnë.

4.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi

Ka pasur përparim të kufizuar në fushën e **politikave të kërkimit dhe novacionit**. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (ARTI) ka rritur kapacitetet administrative të saj dhe ka vazhduar përpjekjet për promovimin e bashkëpunimit në kërkim dhe novacion sipas Programit të Shtatë Kuadër të BE-së nëpërmjet faqes së internetit dhe veprimtarive për rritjen e ndërgjegjësimit. Nuk është bërë përparim drejt integritimit në zonën Europiane Kërkimore dhe ka pasur kontribut të kufizuar në Bashkimin e Novacionit. Niveli kombëtar i investimeve në kërkim dhe zhvillim teknologjik është ende shumë i ulët dhe nuk është rritur që nga viti 2010, pavarësisht objektivave të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Novacionin për periudhën 2009-2015.

Për sa i përket pjesëmarrjes së Shqipërisë në **Programin e Shtatë Kuadër** të BE-së (FP7), u rrit numri i kërkesave, por mbetet ende i vogël numri i projekteve të suksesshme të financuara nga FP7. ARTI shtoi përpjekjet promovuese të tij dhe seancat e trajnimit, mori pjesë në disa veprimtari rrjetëzimi të BE-së dhe ndoqi aktivisht punën për projektin WBC.INCO.NET pjesë e FP7. ARTI ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe me Italinë, Greqinë, Malin e Zi, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Slloveninë dhe Turqinë.

Për sa i përket integritimit në **Hapësirën Europiane të Kërkimit (ERA)**, ka pasur përparim të pakët në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Novacionin. Janë marrë disa masa për të rritur kapacitetet e kapitalit njerëzor, si në rritjen e Fondit të Ekselencës, nxitjen e lëvizshmërisë së jashtme, ngritjen e Portalit Kombëtar Euraxess (ARTI) dhe fillimin e ngritjes së një rrjeti të kërkuesve. Nuk ka pasur përparim në ngritjen e qendrave të ekselencës. Nuk ka pasur rritje në nivelin e investimeve në kërkim dhe nuk është bërë asnjë veprim për të nxitur investime në kërkim dhe novacion nga sektori privat ose për të mbështetur partneritete ndërmjet sektorit privat dhe atij publik. Për më tepër, është e vështirë të përcaktohet niveli i investimeve në kërkim si pjesë e PBB-së për shkak të mungesës së statistikave të besueshme. Nuk është rritur financimi në kërkim, por është përmirësuar sistemi falë një procesi të ri përzgjedhjeje për projektet e financuara drejtpërdrejt nga departamentet. Megjithatë, nuk është zbatuar deri tani asnjë shqyrtim kolegjial ndërkombëtar. Qendra Shqiptare e Biznesit dhe Inovacionit (AIDA) filloi të nxitë novacionin nga sipërmarrësit duke u dhënë SME-ve me ide novatore auditime të teknologjisë. Ky veprim është në përputhje me idenë kryesore të Bashkimit të Novacionit të BE-së.

Përfundim

Ka pasur përparim të pakët në fushën e shkencës dhe kërkimit. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme në nivel kombëtar për të rritur kapacitetet e kërkimit dhe të novacionit dhe për të rritur konkurrueshmërinë e vendit. Mbeten i ulët niveli i investimeve në kërkim dhe duhet rritur kapaciteti i kapitalit njerëzor. Në tërësi, përgatitjet nuk janë shumë të përparura .

4.26. Kapitulli 26: Arsimit dhe kultura

Ka pasur përparim të mirë në fushat e **arsimit, formimit profesional dhe rinisë**. Ligji “ Për arsimin parauniversitar” u miratua në qershor të vitit 2012. Janë realizuar trajnime të mëtejshme për të ndërtuar kapacitetet e mësuesve dhe për të përshtatur dhënien e arsimit dhe formimit me tregun e punës. Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar ka vazhduar të kryejë inspektime duke zbatuar udhëzime të reja për inspektimin dhe vlerësimin e kopshteve dhe shkollave. Ka pasur përparim në luftën kundër korrupsionit në arsim nëpërmjet digjitalizimit gradual të provimeve të shtetit në fund të shkollës (matura) dhe përgatitjes së një kodi kombëtar të sjelljes për mësuesit parauniversitarë dhe universitarë.

Janë bërë përpjekje të mëtejshme për të rritur kapacitetet e sektorit të Arsimit dhe formimit Formimit Profesional (AFP) në ciklin e dytë. Janë rritur kapacitetet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Janë reformuar disa programe mësimore për të pasqyruar më mirë nevojat e tregut të punës. Janë ndërtuar katër shkolla AFP.

Është duke u përgatitur një reformë gjithëpërfshirëse e sistemit të arsimit të lartë, duke përfshirë dhe aspektet financiare. Është ngritur një bazë të dhënash për të ndjekur numrat dhe rezultatet e studentëve. Po shqyrtohet një skemë e renditjes dhe vlerësimit të universiteteve. Po zhvillohet Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK) por kërkohen përpjekje të mëtejshme për të zhvilluar kualifikimet, përcaktuar kompetencat dhe kalimin e tyre në programe studimi. Është përmirësuar pavarësia e Agjencisë së Akreditimit dhe janë bërë përpjekje për të vlerësuar institucionet e arsimit të lartë. Është pezulluar licenca e një universiteti privat për mospërputhje me ligjin. Megjithatë, duhet të vazhdojnë përpjekjet për sa i përket vlerësimit dhe inspektimit të institucioneve dhe programeve të institucioneve të arsimit të lartë, veçanërisht ato në universitete private. Është përmirësuar ndjeshëm në thirrjen e fundit pjesëmarrja e universiteteve shqiptare në programin Tempus. U zhvilluan veprimtari të ndërgjegjësimit të publikut për “Rinia në Veprim”. Është rritur vazhdimisht pjesëmarrja e të rinjve në këtë program. Po hartohet një strategji e re për të rinjtë.

Përparim i mirë është bërë në fushën e **kulturës**. Shqipëria ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi “Për programin e kulturës” dhe filloi të marrë pjesë në 2012-ën. Janë zhvilluar rrjete dhe ndërtim kapacitetesh për pjesëmarrje në programin Europa për Qytetarët, por pjesëmarrja mbetet e kufizuar. Po përgatitet një strategji e re për trashëgiminë kulturore për periudhën (2012-2020).

Përfundim

Ka pasur përparim të mirë në fushat e arsimit dhe kulturës në përafrimin me standardet europiane, veçanërisht në fushat e arsimit të lartë dhe zhvillimin e AFP-së. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar transparencën në institucionet private të arsimit të lartë. Në 2012-ën, Shqipëria filloi të marrë pjesë në programin e kulturës. Në tërësi, përgatitjet kanë përparuar në masë të moderuar.

4.27. Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

Për sa i përket **mjedisit**, janë bërë disa përparime në **legjislacionin horizontal**. Është përmirësuar bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe akses i publikut në informacion. Megjithatë, ligjet për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe lejeve mjedisore nuk janë përafërur ende me *acquis* dhe përfshijnë shmangie serioze si koncepti i “pëlqimit të heshtur”. Është në pritje miratimi i ligjit “Për vlerësim mjedisor strategjik”. Mbetet shqetësim mungesa e zbatimit dhe respektimit të legjislacionit. Nuk ka kryerje sistematike të konsultimeve publike dhe vlerësimeve përkatëse të ndikimit në mjedis dhe lejet mjedisore nuk lëshohen në mënyrë sistematike para fillimit të projekteve të infrastrukturës. Sanksionet nuk janë shtrënguese mjaftueshëm dhe nuk zbatohen në mënyrë të duhur.

Për sa i përket **cilësisë së ajrit**, janë bërë disa përparime me ratifikimin e disa protokolleve të Konventës “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët”. U përmirësua pak monitorimi dhe raportimi i cilësisë së ajrit. Është në pritje një ligj i ri “Për mbrojtjen e ajrit”, që përcakton një kuadër gjithëpërfshirës për politikën e cilësisë së ajrit. Janë në pritje planet e menaxhimit të ajrit për bashkitë kryesore, duke përfshirë Tiranën. Për shkak të buxhetit të vogël që i është caktuar këtij sektori, vetëm dy stacione të cilësisë së ajrit janë funksionale.

Janë bërë disa përparime në **menaxhimin e mbetjeve**, me miratimin e ligjit “Për administrimin e integruar të mbetjeve”. Zbatimi i ligjit duhet të monitorohet me kujdes për të garantuar që mbetjet administrohen dhe

importohen ligjrisht. Miratimi i planeve rajonale të administrimit të mbetjeve është ende në pritje. Trajtimi i mbetjeve veterinarë dhe mjekësore nuk administrohet në mënyrën e duhur. Bashkitë po hasin probleme në administrimin e volumit në rritje të mbetjeve. Nuk ka procedura për administrimin dhe kontrollin e fushave të groposjes dhe ka disa vende të pakontrolluara që janë ende në përdorim.

Është arritur pak përparim në **cilësinë e ujit**. U miratuan strategjitë kombëtare të furnizimit me ujë dhe të sektorit të shërbimeve të kanalizimeve dhe u hartua masterplani i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Është në pritje miratimi i ligjit "Për ujin". Tani funksionojnë tre impiante trajtimi të ujërave të zeza ndërkohë që katër të tjera kanë përfunduar por nuk janë ende funksionale. Ka pak kapacitete për të vlerësuar cilësinë e ujit ose ujërave të zeza të shkarkuara nga impiantet industriale. Në këtë drejtim, nuk ka pasur përparim për identifikimin e fushave të ndjeshme. Zhvillimi i planeve të administrimit të baseneve lumore, duke përfshirë nivelin rajonal, është ende në një fazë të hershme.

Mund të raportohet përparim i pakët në fushën e **mbrojtjes së natyrës**. Fushat kandidatë të propozuara në Shqipëri për Rrjetin e Smeraldit u pranuan nga Konventa e Bernës në dhjetor të vitit 2011. U miratuan rregullat për ngritjen e zonave të mbrojtjes së veçantë në rrjetin NATURA 2000. Një zonë e mbrojtur e re u caktua në 2011-ën, duke rritur sipërfaqen totale të territorit shtetëror të mbrojtur nga 13,7% në 15,1%. Janë zhvilluar dy plane të reja administrimi për parqet kombëtare të Prespës dhe Shkodrës. Megjithatë, buxheti dhe burimet njerëzore nuk janë të mjaftueshme për t'i mbrojtur dhe administruar këto zona në mënyrën e duhur. Zbatimi i legjislacionit mbetet i dobët. Nuk është përmirësuar kontrolli i lejeve të gjahut dhe janë raportuar raste të gjuetisë së paligjshme. Ka filluar puna përgatitore për përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së për natyrën dhe për ngritjen e rrjetit NATURA 2000.

Nuk ka pasur përparim në fushën e **kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimit të rrezikut**.

Nuk ka përparim për t'u raportuar në sektorët e **kimikateve, zhurmës, dhe mbrojtjes civile**.

Për sa i përket **ndryshimeve klimatike**, Shqipëria nuk ka bërë përparime për zhvillimin e politikave të përgjithshme. Mbetet për t'u zhvilluar një strategji gjithëpërfshirëse për klimën. Çështjet klimatike po integrohen gjithmonë e më shumë në politikat energjetike, por duhet të bëhen përpjekje të mëdha për të integruar plotësisht ndryshimin e klimës në politikat dhe strategjitë sektoriale përkatëse.

Shqipëria ka ndjekur rregullisht qëndrimet e BE-së në kontekstin ndërkombëtar. Megjithatë, ndërkohë që ndjek marrëveshjen e Kopenhagenit, vendi nuk ka paraqitur ende një angazhim zbutës për vitin 2020. Shqipëria duhet të konsiderojë marrjen e angazhimeve zbutëse në pajtim me ato të BE-së dhe Shteteve Anëtare me qëllim arritjen në vitin 2015 të marrëveshjes së klimës së pas 2020-ës.

Për sa i përket harmonizimit me *acquis* e klimës, nuk janë bërë përparime të ndjeshme. Shqipëria mbetet në një fazë shumë të hershme. U bënë disa hapa fillestare për të identifikuar instalimet e palëvizshme me qëllim zbatimin në të ardhmen të Sistemit të Tregtimit të Emetimeve. Duhet bërë përpjekje të ndjeshme për të rritur kapacitetet monitoruese, raportuese dhe verifikuese të vendit. Kapacitetet administrative të kufizuara dhe bashkëpunimi i dobët ndërinstitucional po vonojnë përgatitjen dhe zbatimin e një politike për klimën në përputhje me *acquis*. Struktura administrative për ndryshimin e klimës duhet të forcohet ndjeshëm për t'i dhënë përgjigje nevojave të mëdha të kapaciteteve, bashkëpunimit dhe koordinimit.

Shqipëria mori pjesë rregullisht në pjesën e klimës të Rrjetit Mjedisor Rajonal për aderim (RENA). Një konferencë e suksesshme e nivelit të lartë u organizua në qershor të 2012-ës nga RENA-s për bashkëpunimin klimatik BE-Shqipëri. Duhet të vazhdojnë përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet dhe për promovimin e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesuara përkatëse.

Për sa i përket **kapaciteteve administrative** në sektorin e mjedisit, numri i personelit është rritur në Ministrinë e Mjedisit, inspektoratet dhe agjencitë e baseneve lumore. Mund të raportohet disa përparime në forcimin e gjyqësorit, veçanërisht për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për çështjet mjedisore. Megjithatë, Ministrisë së Mjedisit vazhdojnë t'i mungojnë burimet njerëzore dhe financiare. Duhet të përmirësohet bashkëpunimi dhe koordinimi me Ministrinë e Punëve Publike. Gjithashtu, janë të dobëta kapacitetet e Ministrisë së Punëve Publike për të hartuar dhe administruar projekte të infrastrukturës së administrimit të mbetjeve dhe ujit. Burimet që caktohen janë të pamjaftueshme për të siguruar qëndrueshmërinë e projekteve të tilla. Agjencia e Mjedisit ka nevojë për investime të mëdha në pajisje dhe trajnim për të administruar çështje, si: kërkesat për leje,

monitorimin e lejeve, monitorimin e mjedisit dhe marrjen e kampionëve dhe zbatimin e legjislacionit. Inspektorati Kombëtar i Mjedisit nuk ka personel të mjaftueshëm. Autoritetet vendore kanë buxhete të kufizuara dhe mjete administrative të pakta për të zhvilluar infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme. Koordinimi brenda institucioneve qendrore dhe ndërmjet autoriteteve qendrore dhe vendore është i dobët. Fondi mjedisor nuk është krijuar ende.

Përfundim

Ndërkohë që janë bërë disa përpertime në harmonizimin me *acquis* në fushën e mjedisit, është bërë shumë pak përpertime në fushën e ndryshimit të klimës. Duhet bërë përpjekje urgjente për të harmonizuar, zbatuar dhe respektuar legjislacionin. Ndërgjegjësimi publik dhe konsultimi për nisma legjislative ose investime publike mbeten të dobëta. Ka nevojë për angazhim politik më të madh dhe veprim të koordinuar në këto sektorë. Duhet bërë investime të mëdha ndërkohë që fondet e dhëna aktualisht mbeten të kufizuara. Mjedisi duhet të integrohet më shumë në fushat e tjera të politikave si energjetika ose transporti. Për sa i përket ndryshimit të klimës, duhet bërë përpjekje të mëdha për rritjen e ndërgjegjësimit, vendosja e një qëndrimi më strategjik për vendin, harmonizimi dhe zbatimi i *acquis*-së, si dhe rritja e kapaciteteve administrative dhe bashkëpunimi ndërinstitucional. Përgatitjet në fushën e mjedisit janë ende në një fazë të hershme, ndërsa përgatitjet në fushën e ndryshimit të klimës mbeten në një fazë shumë të hershme.

4.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit

Janë bërë disa përpertime në fushën e **mbrojtjes së konsumatorit**.

Për sa i përket aspekteve horizontale, është duke u përfunduar strategjia e re e mbrojtjes së konsumatorit. Janë bërë disa përpertime në rritjen e kapaciteteve administrative të Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit (SMK) që shërben si sekretariat për Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit (KMK). U rrit numri i personelit dhe u forcua pavarësia e saj politike. Për sa i përket zbatimit të legjislacionit, KMK-ja ka qenë duke vlerësuar shkëlqje të mundshme në fusha si telekomunikacionet, arsimit të lartë publik dhe privat dhe energjia elektrike dhe ka marrë disa masa administrative. Si KMK-ja ashtu edhe SMK-ja kanë vazhduar veprimtaritë e rritjes së ndërgjegjësimit. Që nga prilli i 2011-ës, konsumatorët mund të përdorin një sistem për trajtimin e ankesave që administrohet nga sekretariati i KMK-së.

Janë bërë disa përpertime në çështjet që lidhen me **sigurinë e produktit**. U miratua ligji “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, me qëllim harmonizimin me *acquis*. Megjithatë, nuk është vendosur ende një sistem i mbikëqyrjes së tregut. Mund të raportohen disa përpertime në **çështjet që nuk lidhen me sigurinë**. U miratua zbatimi i legjislacionit për marketingun në distancë të shërbimeve financiare, me qëllim harmonizimin me *acquis*.

Ka pasur përpertime të pakta në fushën e **shëndetit publik**. Është riorganizuar Instituti i Shëndetit Publik. Është ngritur një infrastrukturë e re për shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor. Është themeluar një sistem trajnimi, por nuk përfshin ende trajnime mbi legjislacionin e BE-së për shëndetësinë. Në janar të vitit 2011, qeveria miratoi një vendim që reformon financimin e shërbimeve spitalore, por zbatimi mbetet i ngadalët. U përfundua studimi i fizibilitetit për e-shëndetin. Është në pritje Strategjia Kombëtare Elektronike e Shëndetit.

Ka pasur përpertime të pakta në fushën e **kontrollit të duhanit**. U zbatua ndalimi i reklamimit të duhanit dhe është përgatitur një plan që paraqet paralajmërime vizuale në paketat e duhanit. Task forca e mbrojtjes së shëndetit nga përdorimi i duhanit dhe alkoolit nga të miturit rriti numrin e inspektimeve të saj dhe nivelin e mbledhjes së gjobave në Tiranë. Inspektorati Sanitar Shtetëror vazhdoi të kryejë inspektime në gjithë vendin. Megjithatë, norma e mbledhjes së gjobave mbetet e ulët dhe produktet e duhanit vazhdojnë të shiten në rrugë, veçanërisht nga të miturit. Në përgjithësi, ligji “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” nuk është zbatuar mjaftueshëm.

Ka pasur përpertime në fushën e **sëmundjeve ngjitëse**. Po kryhet një analizë e mangësive në legjislacionin e sëmundjeve të transmetueshme për të krahasuar legjislacionin shqiptar me *acquis*. Në nivel kombëtar, mbulimi i vaksinimit në 2011-ën ishte afërsisht 95%. Kanë vazhduar përgatitjet për zbatimin e një sistemi të ri dhe modern vaksinimi. U miratuan në prill 2012-ës udhëzimet për kontrollin e infeksioneve në spitale. Parandalimi i HIV/AIDS nëpërmjet grantit të Fondit Global (2007-2012) ka shënjestruar kryesisht komunitetin rom. Janë zhvilluar veprimtari për rritjen e ndërgjegjësimit. Kanë vazhduar përgatitjet për zbatimin e Rregulloreve

Ndërkombëtare të Shëndetit. U themelua Qendra e Zhvillimit Rajonal brenda Departamentit të Sëmundjeve Infektive pranë Institutit të Shëndetit Publik, por i mungojnë burime njerëzore dhe financiare të mjaftueshme. Është ende në pritje miratimi i legjislacionit zbatues që siguron të drejtën për të gëzuar shëndet për personat dhe fëmijët me HIV/AIDS dhe personat në rrezik.

Nuk mund të raportohet përparim në fushat e **gjakut, indeve, qelizave dhe organeve dhe të drejtave të pacientit në kujdesin shëndetësor ndërkufitar.**

Mund të raportohen disa përparime në fushën e **shëndetit mendor**. Ligji "Për shëndetin mendor" u miratua në qershor të vitit 2012. Ka vazhduar aktivisht trajnimi i mjekëve të përgjithshëm për shëndetin mendor. Pritet të miratohen Strategjia Dhjetëvjeçare e Shëndetit Mendor dhe Plani i Neprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor. Ka një nevojë urgjente për të ngritur një sistem të qëndrueshëm të shërbimeve të shëndetit mendor, të bazuar në financim të mjaftueshëm, një fuqi punëtore të shëndetit mendor të trajnuar mirë dhe aksesueshmëri për të gjitha pakicat dhe grupet e cenuara shoqërore, duke përfshirë zonat rurale. Veç kësaj, ka një mungesë të theksuar doktorësh që specializohen në trajtimin e personave me paafësi mendore. Duhet të ngrihen më shumë shërbime komunitare të shëndetit mendor me cilësi të lartë duke u përqendruar në shërim si një alternativë ndaj kujdesit institucional.

Mund të raportohen disa përparime në fushën e **parandalimit të abuzimit me drogën**. U miratua në qershor të 2012-ës Strategjia e re Kombëtare e Kontrollit të Drogës. Është ngritur Qendra Kombëtare e Informacionit për drogat si një njësi e Departamentit të Epidemiologjisë dhe Sistemeve Shëndetësore pranë Institutit të Shëndetit Publik. Në mars të vitit 2012, u hap Qendra e Trajtimit të Varësisë nga Droga në spitalin Nënë Tereza në Tiranë si qendra e parë gjithëpërfshirëse për trajtimin nga droga në Shqipëri.

Është bërë pak përparim në zvogëlimin e **pabarazive shëndetësore**. Në dhjetor të 2011-ës, u lëshua një qarkore nga Ministria e Shëndetësisë për të përfshirë certifikatat e lindjes, numrin e identifikimit dhe emrin e vajzërisë së nënës për të shmangur deklaratat e gabuara/të rreme në maternitete dhe për të parandaluar mosregjistrimin e fëmijëve, veçanërisht nga komuniteti rom. U realizua një numër fushatash për ndërgjegjësimin publik mbi kujdesin shëndetësor dhe shërbimet për romët bashkë me kontrole shëndetësore dhe fushata vaksinimi. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme për t'i bërë shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe vaksinimet të aksesueshme për romët dhe grupet e tjera të cenuara (veçanërisht të rinjtë me HIV/AIDS dhe përdoruesit e rinj të drogës) në mbarë vendin, veçanërisht në zonat rurale.

Është bërë përparim në drejtim të pakësimit të **dëmit të lidhur me alkoolin** duke vlerësuar përdorimin e alkoolit dhe lëndëve të tjera të studentët dhe bërja e disponueshme e mjeteve për kontrollin e përdorimit të lëndëve ndër të rritur. Janë bërë disa përparime në fushën e **kontrollit të kancerit**, në veçanti për kancerin e gjirit. U miratua Strategjia Kombëtare për Kontrollin e Kancerit për periudhën (2011-2020). Megjithatë, duhen bërë përpjekje të mëtejshme për të zbatuar programet e kontrollit në përputhje me *acquis*.

Përfundim

Janë bërë disa përparime në fushat e mbrojtjes së konsumatorit dhe të shëndetit. Megjithatë, zbatimi dhe respektimi i legjislacionit mbeten shumë të dobët. Nuk është vendosur ende sistemi i mbikëqyrjes së tregut. Ndërgjegjësimi i ulët në sistemin e mbrojtjes së shëndetit, si ndër profesionistë ashtu edhe në publik, po pengon transparencën dhe zbatimin. Sektori i shëndetit mbetet i keqfinancuar. Në tërësi, përgatitjet nuk janë shumë të përparura .

4.29. Kapitulli 29: Bashkimi doganor

Është bërë përparim në **legjislacionin doganor**. Legjislacioni është miratuar duke marrë parasysh aderimin në Konventën Rajonale "Për rregullat preferenciale të origjinës Pan-Euro-Med", në Konventën Ndërkombëtare të Kiotos "Për thjeshtimin dhe harmonizimin i procedurave doganore" dhe në Konventën e "Sistemeve të Harmonizuara". Në gusht Shqipëria fitoi statusin e vëzhguesit jozyrtar në Komitetet e Përbashkëta BE-EFTA për transitin e përbashkët dhe thjeshtimin e formaliteteve dhe grupeve të lidhura me to. Shqipëria shtoi se ka vendosur të bëhet palë me Konventën e Transitit të Përbashkët. Sidoqoftë, nuk është zbatuar ende Konventa ATA për importimin e përkohshëm. Drejtoria për të Drejtat e Pronësisë Intellektuale në administratën doganore miratoi një manual për marrjen e masave kundër produkteve të falsifikuara, u paraqitën statistika dhe u publikuan udhëzime me formularët standardë të lidhur me to. Shqipëria përditësoi tarifën e saj doganore në

përputhje me versionin e vitit 2012 të Nomenklaturës së Kombinuar të BE-së. Legjislacioni dytësor është përafuar me *acquis* duke hequr tarifat administrative për magazinat doganore dhe magazinimin e përkohshëm. Sidoqoftë, projektkodi i ri doganor dhe dispozitat zbatuese të tij, të cilat synojnë përafrimin e mëtejshëm me *acquis*, presin ende miratimin. Norma e përdorimit të vlerës së transaksioneve mbetet e ulët në krahasim me standardet e BE-së.

Është thjeshtuar deklarimi i importeve rastësore nga udhëtarët si dhe i mallrave të natyrës jotregtare dhe janë lëshuar autorizime për magazina të lira për produkte energjetike. Megjithatë, mbetet i kufizuar përparimi për përdorimin e procedurave të thjeshtuara dhe lehtësimin e tregtisë. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme në këtë fushë, duke përfshirë zhvillimin e konceptit të 'operatorëve ekonomikë të autorizuar' dhe rritjen e ndërgjegjësimit të punonjësve doganorë dhe komunitetit të biznesit.

Është bërë përparim në **kapacitetet administrative dhe operative**. Në muajin korrik u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi "Për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e doganave të BE-së" për vitin 2013. Monitorimi digjital me kamera është funksional në shumicën e doganave. U shtua një modul në sistemin e TI-së (Asycuda) për të mbuluar lëvizjet e produkteve me akcizë dhe për të përfshirë aplikimin për magazinat fiskale. U përfundua ndërtimi i një dhome për serverin e TI-së në zyrat qendrore të doganave në përputhje me standardet e Shoqatës së Industrisë së Telekomunikacionit. Megjithatë, duhet bërë përpjekje të mëtejshme në ndërlidhjen dhe ndërshtetëzueshmërinë e TI-së me sistemet e BE-së. Laboratori doganor nuk është ende funksional. Duhet bërë ende përpjekje për të përmirësuar infrastrukturën në pikat e kalimit kufitar. Është ulur lehtë numri i kontrolleve fizike falë përmirësimeve në procesin e shënjestrimit me ndihmën e profileve të riskut. Nuk është bërë përparim në zhvillimin e kontrolleve pas-zhdoganimit.

Është miratuar një plan veprimi për burimet njerëzore dhe trajnimin për vitin 2012 dhe në muajin korrik u miratuan Strategjia e Biznesit dhe Plani i Administrimit të Ndryshimeve të Biznesit për Administratën Doganore. U krijuan departamente të reja për TI-në dhe Akcizën në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD). U miratua organizimi dhe struktura e Akademisë së Trajnimit por nuk është ende funksionale. Janë marrë disa masa për t'i dhënë përgjigje korrupsionit në administratën doganore. U miratua rregullorja e brendshme e Drejtorisë së Hetimeve të Brendshme dhe Antikorrupsionit pranë DPD-së. Është vënë në përdorim një numër falas dhe një lidhje e një faqe interneti për raportimin e korrupsionit dhe janë organizuar masa për rritjen e ndërgjegjësimit për rolin e qytetarëve në luftën kundër korrupsionit. Vazhdoi bashkëpunimi me institucionet përkatëse si bankat, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Pronave, Zyra e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme dhe nëpërmjet task forcës së përbashkët hetimore. Megjithatë, duhet bërë përpjekje të mëtejshme meqenëse mbetet ende i lartë perceptimi i korrupsionit në administratën doganore. Punonjësit doganorë nuk gëzojnë ende statusin e nëpunësit civil.

Përfundim

Është bërë përparim në përafrimin e legjislacionit në fushën e bashkimit doganor. Vazhdojnë të ekzistojnë mangësi në kapacitetet administrative dhe operative, duke përfshirë përputhshmërinë e sistemeve të TI-së me kërkesat e BE-së. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme për vlerësimin doganor dhe lehtësimin e tregtisë. *Në tërësi*, përgatitjet kanë përparuar në masë të moderuar.

4.30. Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë

Është bërë përparim i moderuar në fushën e **politikave të përbashkëta tregtare**.

Në përgjithësi, Shqipëria ka vazhduar koordinimin me Komisionin Europian dhe harmonizimin me politikat dhe qëndrimet e Bashkimit Europian mbi vendet e treta në organizata ndërkombëtare, në veçanti Organizatën Botërore të Tregtisë.

Është bërë përparim i kufizuar për sa i përket kapaciteteve administrative në politikat tregtare. Drejtorja e Tregtisë dhe Politikave të Integritetit organizoi veprimtari trajnimit për personelin e saj dhe atë të ministrive të linjës mbi aspekte të ndryshme të tregtisë dhe shërbimeve. Nuk është bërë përparim për miratimin dhe zbatimin e planit të përgjithshëm të trajnimit mbi politikat tregtare dhe mbi politikën e përbashkët tregtare të BE-së.

Janë bërë disa përparime në fushën e mallrave me përdorim të dyfishtë. Në dhjetor të vitit 2011, Drejtorja e Përgjithshme e Doganave (DPD) dhe Agjencia Shtetërore e Kontrollit të Eksportit (AKSHE) nënshkruan një

Memorandum Mirëkuptimi “Për bashkëpunimin në fushën mallrave ushtarake dhe me përdorim të dyfishtë dhe kontrolleve të teknologjikes”. Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme ndërmjet DPD-së dhe AKSHE-s në nivel specialisti dhe drejtuesi. U përditësua në dhjetor të 2011-tës profili i veçantë i riskut për mallrat ushtarake dhe ato me përdorim të dyfishtë. Janë organizuar trajnime të punonjësve doganorë në terren, për kontrollin e mallrave me përdorim të dyfishtë, analizën e riskut dhe paszhdoganimin.

Për sa i përket nënshkrimit dhe zbatimit të **marrëveshjeve dypalëshe me vendet e treta**, Shqipëria ka filluar zbatimin e protokollit shtesë për liberalizimin e tregtisë në bujqësi në kuadrin e CEFTA-s. Janë nënshkruar traktate dypalëshe investimesh me Azerbajxhanin dhe Katarin.

Përparim i pakët mund të raportohet në **politikën e zhvillimit dhe ndihmës humanitare**. Ministria e Punëve të Jashtme emëroi një person për të ndjekur çështjet e lidhura me politikën e zhvillimit të BE-së dhe ndihmën humanitare.

Përfundim

Shqipëria ka vazhduar bashkëpunimin e mirë brenda OBT-së dhe CEFTA-s. Megjithatë, është bërë përparim i kufizuar në rritjen e kapaciteteve administrative të institucioneve të përfshira në politikën për tregtinë. Në tërësi, përgatitjet në fushën e marrëdhënieve me jashtë janë të moderuara.

4.31. Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes

Ka vazhduar **dialogu politik** i rregullt ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë për çështjet e politikës së jashtme dhe të sigurisë. *(Për sa i përket marrëdhënieve me vendet e tjera të zgjerimit dhe Shtetet Anëtare, shih Kriteri Politik 2.3 - Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare.)*

Për sa i përket **politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë** (PPJS), gjatë periudhës së raportimit Shqipëria u bashkua, kur u ftua, me të 70 deklaratat e BE-së dhe vendimet e Këshillit (100% harmonizim). *(Për sa i përket Gjykatës Ndërkombëtare Penale, shih Kriteri Politik 2.3 Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare.)*

Shqipëria zbatoi **masat kufizuese** të BE-së për vendet e treta, të paraqitura në Vendimet e Këshillit.

Nuk mund të raportohen zhvillime shtesë në lidhje me **parandalimin e konflikteve**.

Në fushën e **mospërhapjes**, Shqipëria ka vazhduar zbatimin e planit të veprimit për asgjësimin e armatimeve të tepërta dhe ka harmonizuar qëndrimet e saj me BE-në dhe organizatat e tjera ndërkombëtare. Për sa i përket armëve të vogla dhe të lehta, nuk mund të raportohet përparim për përfundimin e regjistrimit elektronik të armëve dhe municioneve nën drejtimin e Policisë së Shtetit.

Vendi është angazhuar aktivisht në **bashkëpunimet me organizatat ndërkombëtare** (OKB, OSBE, Këshilli i Europës, etj.). Që nga data 23 maj, Shqipëria mban kryesimin e radhës së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës.

Për sa i përket **masave të sigurimit**, është ende në pritje marrëveshja e sigurimit me BE-në për shkëmbimet dhe mbrojtjen e ndërsjellë e informacionit të klasifikuar.

Shqipëria ka dëshmuar një angazhim në rritje për të marrë pjesë në operacione të **administrimit të krizave civile dhe ushtarake** sipas **politikës së përbashkët e sigurisë dhe e mbrojtjes (CSDP)**. Shqipëria nënshkroi, në qershor, Marrëveshjen Kuadër “Për pjesëmarrje në operacionet e administrimit të krizave të BE-së” dhe ka vazhduar të marrë pjesë në misionin EUFOR Althea në Bosnje-Hercegovinë (një anëtar personeli i përgjithshëm dhe një skuadër prej pesë personash për asgjësimin e armatimeve dhe eksplozivëve). Gjatë periudhës së raportimit, Shqipëria angazhoi një kontingjent prej pesë punonjësish të policisë në Afganistan për të punuar si trajnues si pjesë e misionit të EUPOL-it në mbështetje të shtetit të së drejtës. Shqipëria ka kontribuar dy oficerë të marinës në operacionin EU NAVFOR Atalanta në Somali. Shqipëria ka bashkëpunuar gjithashtu me NATO-n në operacionet në Libi.

Përfundim

Shqipëria ka vazhduar të harmonizojë legjislacionin me *acquis* në fushën e politikës së jashtme, të sigurisë dhe mbrojtjes dhe ka treguar angazhim politik të vazhduar për pjesëmarrjen në operacionet e administrimit të krizave civile dhe ushtarake. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme për të përfunduar regjistrin elektronik të armëve dhe municioneve nën drejtimin e Policisë së Shtetit. Në tërësi, përgatitjet në këtë fushë mbeten në rrugën e duhur.

4.32. Kapitulli 32: Kontrolli financiar

Mund të raportohen disa përpjekje në fushën e **kontrollit financiar publik të brendshëm**. Drejtoria e Inspektimit të Financim Publik (DIFP) është ngritur pranë Ministrisë së Financës, por ka ende nevojë që të plotësohet me personelin e mjaftueshëm. Ka përfunduar rekrutimi i inspektorëve buxhetorë në administratë. Trajnimi është në vazhdim. Kjo duhet të kontribuojë në ndarjen e auditimit të brendshëm nga inspektimi dhe sqarojë rolin e auditimit të brendshëm si mbështetje për administrimin. Megjithatë, ndërkohë që kuadri ligjor parësor për inspektimin e centralizuar të buxhetit është krijuar, mbetet ende duke u përgatitur legjislacioni zbatues për procedurat e kryerjes së inspektimeve financiare.

Për sa i përket menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK), duhet të rishqyrtohen rregullat e MFK-së brenda ministrive të linjës për të shmangur mospërputhjet ndërmjet ligjit organik për buxhetin, ligjit të MFK-së dhe Vendimet e Qeverisë për Standardet dhe Procedurat për Organizimin e Brendshëm të Institucioneve të Administratës Publike. Është i nevojshëm trajnimi i mëtejshëm për implikimet e plota të ligjit për MFK-në. Në lidhje me auditin e brendshëm, Këshilli i Ministrave miratoi në prill të 2012-ës vendimin për kriteret e ngritjes së njësive të auditimit të brendshëm në institucionet publike. Njësia Qendrore e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka filluar të shqyrtojë programin e trajnimit për audituesit e brendshëm. Në tërësi, duhet të përmirësohet ende cilësia e auditimeve të brendshme.

Ka pasur përpjekje në fushën e **auditimit të jashtëm**. Kryetari i ri i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) u emërua nga Kuvendi në dhjetor të 2011-tës. Pas disa vitesh në pezullim, janë përgatitur dhe janë dërguar për procedurën e miratimit projekt ndryshimet e ligjit të SAI-t për ta sjell në përputhje të plotë me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Kontrollit të Lartë (INTOSAI). KLSH kryen të gjitha llojet kryesore të auditimeve, por auditimet e llojit të inspektimit të rregullsisë/përputhshmërisë përbëjnë ende shumicën dërrmuese të auditimeve të tij (afërsisht 90% në 2011-ën). Trajnimi i audituesve të KLSH-së gjatë vitit 2011 ka qenë i kufizuar. Ndonëse ka dëshmi për pranim më të madh të rekomandimeve të KLSH-së nga të audituarit, duhet të përmirësohet efikasiteti i vijimësisë së parlamentit bazuar në raportet e auditimit të KLSH-së.

Është bërë përpjekje për paketën për **mbrojtjen e interesave financiare të BE-së**. Është në vazhdim rekrutimi i personelit për DIFP-në, e cila shërben si një pikë kontakti me Komisionin Europian dhe Zyrën Europiane kundër Mashtrimit (OLAF). Megjithatë, duhet të ndërtohet kapaciteti administrativ në këtë fushë.

Mund të raportohet përpjekje në **mbrojtjen e euros kundër falsifikimit**. Shqipëria vazhdon të marrë pjesë aktivisht në programin Pericles. Në ndjekje të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për të ngritur Qendrën Kombëtare të Analizës, u punësua në shkurt të vitit 2012 një ekspert për shqyrtimin dhe hetimin e kartëmonedhave të falsifikuara.

Përfundim

Ka pasur përpjekje të kufizuara në fushën e kontrollit financiar. Duhet bërë ende përpjekje të mëdha për t'iu përgjigjur mangësive ekzistuese në zbatimin e kuadrit ligjor të KFPB-së, parimit të përgjegjësisë drejtuese dhe harmonizimit të auditimit të jashtëm me standardet e INTOSAI-t. Në tërësi, përgatitjet nuk janë ende shumë të përparura.

4.33. Kapitulli 33 Dispozitat financiare dhe buxhetore

Nuk ka pasur zhvillime të rëndësishme për **burimet vetjake tradicionale, burimet e TVSH-së dhe burimet e AKB-së**. Për përpjekje në fushat e politikave themelore, *shih kapitujt 16 - Tatimet, 18 - Statistikat, 29 - Bashkimi Doganor dhe 32 - Kontrolli Financiar*.

Shqipëria ka tashmë **infrastrukturën administrative** kryesore për fushat e politikave themelore që ndikojnë jo drejtpërdrejtë në sistemin e burimeve vetjake. Duhet të emërohen në kohën e duhur institucionet dhe organet

koordinuese përgjegjëse për përgatitjen e kushteve administrative për zbatimin e rregullave të burimeve vetjake.

Veç kësaj, duhet të zhvillohen më tej mjete të efektshme në luftën kundër evazion tatimor dhe mashtrimit dhe zvogëlimin e ekonomisë informale.

Përfundim

Nuk është bërë përparim i veçantë në rregullat e administrimit e sistemit të burimeve tyre vetjake, duke përfshirë AKB-në dhe TVSH-në dhe burimet e tyre vetjake tradicionale. Në tërësi, përgatitjet për dispozitat financiare dhe buxhetore janë në një fazë të hershme.